



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Regji Filmi
&Televizioni”**

ofruar nga

Universiteti i Arteve

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As.Dr. Zhuljeta DAJA

Prof.As.Dr. Florenca STAFA

Nëntor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Regji Filmi&Televizioni” ofruar nga Universiteti i Arteve Tiranë

1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Regji, Regji Filmi dhe Televizioni
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Regji Filmi & Televizioni”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 5356 datë 22.08.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 76, datë 12.02.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për here të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i Studimit
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2024-2025 12 PAE / 6 PAK 2023-2024 12 PAE / 7 PAK 2022-2023 12 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2024-2025 8 studentë 2023-2024 8 studentë 2022-2023 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Regji Filmi&Televizioni” është një prej programeve të studimit i ciklit të parë (BSC) i cili ofrohet nga departamenti Regji, Regji Filmi dhe Televizioni (DRRFTV), pjesë e Fakultetit të Artit Skenik (FAS) në Universitetin e Arteve (UART).

Duke vërejtur dokumentacionin na bie në sy se Universiteti i Arteve ka patur disa emërtesa gjatë viteve. Në themelimin e tij më 1966 ai quhej Instituti i Lartë i Arteve (ILA), pas viteve '90 “Akademia e Arteve” dhe në vitin 2011 mori emërtimin përfundimtar Universiteti i Arteve (UART). Programet e studimit në tërësinë e tyre janë vazhdim i një tradite të krijuar prej vitesh dhe që pasurohet e rifreskohet me elemente bashkëkohorë duke u mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, V.K.M. dhe Udhëzimet përkatëse.

Programi i Studimit Bachelor në “Regji Filmi &Televizioni” bazohet në Programin e Studimit Regji hapur në vitin 1982, në ILA.

UART është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë me profil artistik në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i UART është të ofrojë një arsim të lartë tejet cilësor në lëmin artistic dhe kulturor. Njëkohësisht bën përpjekje për të ofruar veprimtari krijuese artistike dhe kërkimore shkencore në fushën e artit. Të gjitha këto synon t'i arrijë nëpërmjet një mësimdhënieje cilësore dhe veprimtarive artistike që kryen brënda e jashtë vendit. UART ka dhe një mision të rëndësishëm që lidhet me studimet kërkimore në fushën e artit dhe të kulturës. Vëndi ynë ka një trashëgimi të pasur kulturore të cilën duhet që nëpërmjet studimeve ta evidentojë. Veç kësaj duke qenë se është i vetmi institucion i Arsimit të Lartë në fushën e artit ka për detyrë që të kryejë trajnime të vazhdueshme të specialistëve në fushën e artit. Veç përgatitjes shkencore në kontekstin artistic ky institucion duhet të ndihmojë në edukimin e studentëve si pjesëtarë të një shoqërie demokratike.

Parë në tërësinë e tij Programi i Studimit Bachelor në Regji Filmi & Televizioni i cili ofrohet nga RRFTV/FAS është në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Qëllimi kryesor i tij është të përgatisë regjisorë të pavarur të filmit e Televizionit, artistë dhe intelektualë që janë në gjendje të krijojnë art në bazë të tekstit që ofrohet. Programi synon të pajisë studentët me njohuritë bazë, t'i aftësojë në pikëpamje akademike dhe praktike, mbi regjinë skenike të filmit e televizionit. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike. Programi ofron kualifikim të Nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit në të, për të përvijuar studimet në programe të ciklit të dytë.

Departamenti i Regjisë Regjisë së Filmit e Televizionit ka në filozofinë e tij të mësuarit me kompetenca dhe studenti në qendër. Veprimtaria e departamentit, procesi mësimor, metodologjitë e mësimdhënies, shërbimet, aktivitetet dhe mjetet didaktiko/artistike janë në shërbim të edukimit të studentit.

Gajtë vizitës në institucion dhe në takimet më pedagogë dhe student, GVJ vuri re një përkushtim të stafit akademik për realizimin cilësor të programit, duke bashkëpunuar me studentët, duke i njohur mirë ata dhe duke synuar në aftësimin e tyre akademik e praktik.

Stafi është i kualifikuar. Ai ndërthur ndërthur teorinë me praktikën, përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe përfshirjes në veprimtari artistike. Studentëve ju ofrohen ambiente të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al

ndryshme funksionale që mundësojnë veprimtari të larmishme mësimore, artistike dhe shkencore. Krahas konsolidimit të gjithë procesit formues regjisorial, studentit i ofrohet material njohës mbi punën e regjisorit në Teatrin Eksperimental, Teatri Kombëtar e Operës dhe Baletit, në Teatrin e Kukullave, në Televizion Shqiptar dhe Televizione të tjera, në Qendrën e Kombëtare të Kinematografisë, etj. për regjinë e spektaklit, regjinë televizive dhe atë të filmit. Vizita apo edhe praktikat në këto institucione ndikojnë pozitivisht në formimin akademik e praktik të studentëve. Po ashtu studenti fiton njohuri mbi personalitetin regjisorial si drejtues i gjithë veprimtarisë së institucionit teatror si dhe udhëheqës i punës kualifikuese të komunitetit artistik. Gjatë takimeve me studentët të organizuar nga GVJ u konstatua se studentët vlerësojnë aktivizimin në veprimtari artistike nga pedagogët e Departamentit, të cilët janë të përkushtuar në mësimdhënie në auditore por edhe jashtë tyre.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Për Akreditimin e IAL një vend të rëndësishëm zë Raporti i vlerësimit të jashtëm, i cili është një dokument i hartuar nga një grup i caktuar për vlerësimin në tërësi të cilësisë, në institucionin e Arsimit të Lartë. Ky raport është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Regji Filmi & Televizioni”, ofruar nga Departamenti i Regjisë, Regjisë së Filmit dhe Televizionit, Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve Tiranë. Akreditimi është mjaft i rëndësishëm pasi ai çertifikon cilësinë e IAL dhe veçanërisht të Programeve të Studimit. Metodologjia e punës për vlerësimin e jashtëm të Programit Regji të DRRFTV, është bazuar mbi kritere tejet të studiuar. Më së pari bazohet në studimin e raportit (RVB) të paraqitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të departamentit, si edhe vizita e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) në Departament. Kjo vizitë bëhet për verifikimin e të gjitha gjetjeve në raportin e vlerësimit të brendshëm. Raporti i hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm përmbledh të gjithë procedurën e zhvilluar gjatë procesit të vlerësimit të standarteve dhe kritereve për ciklin e parë Bachelor në “Regji Filmi dhe Televizioni”. Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit të miratuar nga ASCAL/BA. Për të shkruar raportin jemi mbështetur në vlerësimin e RVB, gjetjeve nga vizita në Departament si dhe shqyrtimi i të gjithë dokumentacioni mbështetës për hartimin e RVB. Ky dokumentacion është vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha fazat e vlerësimit të procesit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga **Prof. As. Zhuljeta Daja, Prof.As. Florenca Stafa** dhe Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proces vlerësimi është **Msc. Arbri Ndreka**. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

1. Marrja e raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe dokumentacionin mbështetës të raportit nga ASCAL. DVV përmban gjithshka që nevojitet për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit. ASCAL ka qenë i gatshëm për të na dhënë çdo informacion i nevojshëm gjatë procesit të vlerësimit.
2. Hap i dytë i rëndësishëm i procesit ka qenë studimi i dosjes së VV dhe gjithë dokumentacionit. Nëpërmjet kësaj dosje ne njohëm strukturën e programit,



përmbajtjen e tij, punën e stafit që bëhej në këtë institucion. Ky dokumentacion është baza për njohjen dhe vlerësimin e Deapartamentit, mënyrën e funksionimit të tij;

3. Pasi u shqyrtua raporti i paraqitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni u përgatit dosja me pyetje, diskutime dhe problematika të ndryshme, mbi bazën e të cilave u hartua një raport i shkurtër që do të paraprinte vizitën në UART. Në këtë fazë u përgatit edhe agjenda e vizitës, lista e pyetjeve, problemet për t'u diskutuar sipas takimeve respektive, me dekanin, përgjegjësën e departamentit, pedagogët, stafin mbështetës, studentët etj;
4. Vizita e GVJ në DRRFTV e zhvilluar në datat 29-30 prill 2025. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit;
Në përfundim është dorëzuar raporti përfundimtar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i cili përmban gjithshka të realizuar në departamentin e Regjisë, Regjisë së Filmit dhe Televizionit.

IAL është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.23/34 Prot, datë 27.10.2025. IAL njofton në ASCAL më datë 10.11.2025, me anë të shkresës me Nr.1922 Prot, datë 07.11.2025 "Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Regji Filmi & Tv”

I. OFRIMI PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UART është institucion public në Shqipëri që ofron edukimin në fushën e arteve. Sipas RVB dhe dokumentacionit në tërësi, Programi i studimit “Regji Filmi&Televizioni” që ofrohet nga Fakulteti i Artit skenik, në Universitetin e Arteve, është në përputhje me interesat kombëtare dhe kërkesat gjithnjë në rritje për specialistë regjizorë të Filmit e Televizionit. Historia e UART që e ofron këtë program studimi për akreditim është e gjatë. Gjatë gjithë periudhës të ekzistencës së tij ka krijuar një trashëgimi e përvojë të pasur që pa dyshim vlerësohet nga institucioni. UART është themeluar në vitin 1966, me emërtimin Instituti i Lartë i Arteve. Ai qe produkt i bashkimit të Konservatorit, Shkollës së Lartë për Aktorë dhe Shkollës së Arteve të Bukura. Mbi këtë përvojë më datë 18.11.1965 me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës u hap Kursi një vjeçar për përgatitjen e regjizorëve, pranë Shkollës së Lartë për aktorë “A.Moisiu”. Rritja e aktiviteteve artistike bënte të domosdoshme hapjen e programit të Regjisë. Në vitin 1982 u hap dega e Regjisë në Institutin e Arteve. Hapja e kursit të Regjisë ndikoi në rritjen e cilësisë së veprimtarive artistike. Pikërisht mbi bazën e këtij programi u hap më pas regjia e filmit dhe televizionit. Krahas rritjes së trupave teatrore u rrit edhe prodhimi i filmit shqiptar e dokumentari, u rrit metrazhi i filmave gjithashtu edhe emisioneve televizive. Kjo gjë diktoi në rritjen e numrit të studentëve dhe të pedagogëve. Në këto kushte u bë i domosdoshëm kalimi nga kurs në fakultet me të njejtin karakter. Si përfundim më 1990 u krijua Fakulteti i Artit Skenik, si njësi, fakultet i pavarur. Po në këtë kohë Instituti i Lartë i Arteve u ngrit në nivel Universiteti nga Institut që ishte dhe u emërtua Akademia e Arteve, me po të njejtën strukturë. Në vitin 2011 Akademia e Arteve u organizua në Universitetin e Arteve. Fakulteti i Artit skenik ishte si më parë. Në vitin 2005 u hap programi Bsc në Regji Filmi e Televizioni. Ngritja në këtë status konsolidon më shumë vlerat akademike. Departamenti i RRFTV që ofron programin bachelor në Regji Filmi dhe Televizioni, ka bërë studimin e tregut dhe vëren se jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por përkundrazi me përmbajtjen e kurrikulave synon në edukimin e vlerave dhe aftësive akademike dhe kulturore. Njëkohësisht synon në promovimin e vlerave kombëtare. Këto përfundime, lidhur me hapjen e programit Regji Filmi dhe Televizioni, dalin nga dokumentacioni i

	<p>ofruar nga GVB i departamentit dhe vizita e bërë nga GVJ në departament dhe biseda me kolegët e departamentit.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 1.10 Themelimi i Institutit të Lartë të Arteve</i></p> <p><i>Evidenca 1.11VKM hapja e kursit të parë të regjisoreve.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.12Vendimi Nr.414, datë 12.11.1991 për krijimin e Akademisë së Arteve.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.13 Krijimi UART me VKM Nr. 234 datë 23.03.2011.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.14 Regjistrimi i formës së diplomave UART 2011.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi u njoh me dokumentacionin në RVB dhe bisedës në departamentin e RRFTV, konstaton se programi i Studimit ofruar në bachelor “Regji Filmi&Televizioni” është plotësisht në përputhje me objektivat dhe misionin e përcaktuar nga UART. DRRFTV synon në përgatitjen sa më të mirë dhe cilësore të studentëve të programit Regji Filmi dhe Televizioni. Universiteti i Arteve është person juridik public dhe i njohur me ligj si i tillë. Si i vetmi institucion që përgatit në fushën e arteve, ka si objektivi përgatitjen e specialistëve në fusha të ndryshme të artit. Për të përmbushur këtë qëllim departamenti ofron një arsim cilësor, që ka si objektivi formimin me kompetenca akademike dhe praktike të studentëve. Për të përmbushur qëllimin Departamenti ofron mësimdhënie cilësore të bazuar në procesin e të menduarit kritik dhe aftësimin me kompetenca. Në këtë departament i kushtohet vëmendje jo vetëm përgatitjes së specialistëve, por edhe të kërkuesve shkencorë. Në këtë kontekst departamenti synon jo vetëm përgatitjen e specialistëve të mirë të artit, por dhe rritjen cilësore të aktiviteteve artistike brenda e jashtë vendit.</p> <p>Nëpërmjet edukimit tek ky departament dhe në tërësi tek Universiteti i Arteve, studentët japin ndihmesë në edukimin me norma të demokracisë për qytetarët. Studentët të aftësohen që nëpërmjet artit të edukojnë brezin e ri me norma të moralit dhe demokracisë. Në përfundim, qëllimi i këtij program është që të përgatisë specialistë me nivel të lartë shkencor dhe akademik si dhe aftësi e kompetenca praktike. Stafi akademik ka qënë i qartë që në fillim lidhur me objektivat dhe qëllimet që do arrijë me këtë program e në vazhdimësi.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca: 1.5. Statuti i uart urdhër ministri nr.319 për miratimin e statutit të UART dhe statutit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Nga RVB dhe dokumentacioni i ofruar nga Departamenti dhe diskutimet me pedagogët e tij, GVJ arrin në përfundimin se: Programi i studimit bachelor në “Regji Filmi &Televizioni” është në përputhje me planin strategjik të universitetit për vitin 2018-2025, miratuar nga Bordi i Administrimit nr.15/1 datë 24.10.2017. Duke pasur parasysh edhe statusin e veçantë që ka ky institucion, ne shikojmë që të gjitha programet e UART, krahas veprimtarisë akademike dhe artistike</p>




zhvillojnë edhe veprimtarinë kërkimore shkencore. Kërkesat mbështeten në ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015. Në të gjithë veprimtarinë e tij UART mbështetet në një sërë ligjesh e rregullore, për më tepër këtë ia dikton edhe Statusi i Veçantë që ai ka marrë në 10.03.2021. E gjithë veprimtaria më pas është e rregulluar me ligj dhe e materializuar në rregullore të veçanta.

Gjithashtu departamenti i RRFTV synon të ofrojë programe cilësore, konkruese në rajon e më gjerë. Ky pikësynim më së paku mbështetet në faktin se UART është në vazhdimësi një konkruer dinjitoz në tregun rajonal pse jo dhe atë botëror. Koha dhe shembujt konkretë e kanë treguar këtë. FAS dhe DRRFTV ka si objektiva kryesore: formimin akademik, përgatitja për kërkimin shkencor si dhe aftësimi për produksionin dhe menaxhimin artistik.

Në të gjithë programet e tij UART zhvillon tërë veprimtarinë e tij kërkimore shkencore në përputhje me ligjin e Arsimin të Lartë nr.80/2015. Gjithashtu mbështetet edhe në VKM nr.145 datë 10.03.2021: "Për dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimin të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë". Mbi këtë status dhe VKM institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh nëpërmjet të cilave funksionon i gjithë aktiviteti në UART të cilat janë: Statuti i UART, Rregullore e UART, Rregullore e FAS, Rregulloret e cikleve të studimit si dhe një sërë rregulloresh të tjera të cilat përbëjnë bazin ligjore të funksionimit e mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore, kërkimore artistike shkencore dhe administrative të FAS/UART. Synimi i departamentit është të ketë një program konkruer pse jo dhe të integrohet në rajon e më gjerë. Këtë synim ata e mbështetin së pari në traditën e Universitetit të Arteve, që është një nga konkruerit në tregun vendas, rajonal, europian dhe atë botëror. Koha e ka treguar këtë. Fakulteti i Artit Skenik ku bën pjesë edhe programi i studimit "Regji Filmi & Televizioni" ka si synim realizimin dhe plotësimin e tri objektivave kryesore: Edukimi akademik, kërkimi shkencor dhe produksioni e menaxhimi artistik. Konkurimi në treg është në fund vlerësimi që i bëhet programit të studimit. Konkurimi dhe vlerësimi ka impakt pasi i shërben institucionit, vendit dhe studentëve që duan të studiojnë brenda vendit në këtë program. Në këtë kontekst departamenti bën përpjekje të vazhdueshme për të rritur cilësinë e programit. Gjithashtu ka përpjekje për t'ju përgjigjur sfidave të tregut me specialist. Pjesëmarrja në aktivitete artistike, përfshirja në punën kërkimore dhe rritja e cilësisë së mësimdhënies janë çelsi i suksesit për ta. Në përfundim ata synojnë të përgatisin regjizorë të aftë për filmin e televizionin.

Dokumentacioni:

Evidenca iVr l. 19 Mbi miratimin e Planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.

Evidenca 1.4 Per dhenien e Statusit te vecante UARTV)

	<p><i>Evidenca 1.5 Statuti i UART.</i> <i>Evidenca 1.20 Rregullorja e UART</i> <i>Evidenca 1.16 Rregullorja FAS</i> <i>Evidenca 1.15 Rregullorja e Ciklit të Parë të Sludimeve Bachelor në UART</i> <i>Evidenca 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "RegjiFilmi &Televizioni"</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ pasi u njoh me RVB dhe vizita në departament arriti në përfundimin se ky institucion ka përvojën dhe kapacitetet akademike për të realizuar programin e Regjisë së Filmit &Televizionit. Hapja e një programi të tillë specifik ishte i domosdoshëm edhe për faktin e rritjes së numrit të televizioneve dhe kërkesave për të tillë profesionistë. UART ka si pikësynim që me hapjen e këtij programi, por edhe të tjerëve jo vetëm përgatitjen e specialistëve të fushës, por edhe formimin e studentëve si qytetarë të denjë për një vend demokrtaik. Veprimtarinë mësimore e realizojnë brenda dhe jashtë ambienteve të UART dhe FAS. Gjithashtu për një cilësi edhe më të mirë kanë marrëdhënie me institucione të ngjajshme jashtë vendit, në vendet fqinjë apo në Evropë.</p> <p>Vendosja e këtyre marrëdhënieve të bashkëpunimit ndikon njëherazi jo vetëm në rritjen e cilësisë, por edhe ndërkombëtarizimin e programit. Ky veprim rrit konkurrencën dhe ndikon në rritjen e cilësisë dhe performancës.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.19 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf.</i> <i>Evidenca, 1.21 Marrëveshjet me partnerët UART.pdf.</i> <i>Evidenca, 1.27 Lista emërore me titujt e gradat e pedagoqeve</i> <i>Evidenca, 3.4 Dosja e Titujve Akademikë të Personelit</i></p>
<p>Kriteri 5.Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në DRRFTV, GVJ arrin në përfundimin se përmbajtja në tërësi e këtij programi dhe ajo specifike janë në përputhje me përmbajtjen e njësisë bazë që është përgjegjëse për programin në fjalë.</p> <p>Në një qasje krahasuese del se programi që vlerësohet ka si object kryesor artet e aplikuara (0215), edhe njësia kryesore FAS (021) ka si object po artet. Sigurisht në aspekte të veçanta ka dallime dhe specifika të veçanta. Gjithsesi, fusha e përgjithshme është në përputhje me fushën akademike dhe atë të kërkimit të njësisë kryesore/bazë. Në se vërejmë të gjitha programet e FAS, ato të profilit skenik dhe të televizionit janë padyshim pjesë e programeve Regji, Regji Filmi&Televizioni.</p> <p>Kjo shpreh qartë ndërthurjen, përputhshmërinë por edhe veçantitë. Në këtë kontekst njësia kryesore dhe bazë janë përgjegjëse për kodifikimin e programit (programeve) conform direktivave dhe udhëzimeve evropiane. Përmbajtja e përgjithshme që ndikon në</p>




	<p>formimin e përgjithshëm të studentëve është në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. (ASCAL). Kodi është një përmbledhje e standarteve shtetërore të cilësisë, për programin Bachelor, Manuali për Proçedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë (MPAVC) në kuadër të akreditimit të IAL dhe programeve të studimit; si dhe Udhëzuesit dhe Standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Standards and Guidelines ESG 2015) Në përfundim mund të pohojmë se ka përputhshmëri në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor të njësisë bazë.</p> <p>Nga ana tjetër, fusha e përgjithshme që njëkohësisht, ndikon në formimin bazë të studentëve e këtij programi është në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL), përmbledhje e standarteve shtetërore të cilësisë, për programin Bachelor, Manualit Për Proçedurat dhe Afatet Për Vlerësimin e Cilësisë (MPAVC) në kuadër të akreditimit të IAL dhe programeve të studimit; si dhe Udhëzuesit dhe Standardet Për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Standards and Guidelines ESG 2015)</p> <p>Në aspektin e cilësisë kemi përputhshërinë e fushës akademike me atë kërkimore në të njëjtën fushë duke pasur ekspertizën e duhur.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca: 1.22.1 emaile procesi kodifikimi i programeve 2024.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 1.22.2 Shkresa e Zv. Rektorit dt 22.01.2025 Mbi kodifikimin përfundimtar të programeve të studimit në UART, përcjellje e shkresës së MAS Njoftim mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 1.22.3 Kthim përgjigje për kodifikimet dhe regjistrimi i formës së diplomës.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca: 1.23 SPECIFIKIMET DHE PERMBAJTJET E KODIFIKIMIT TE PROGRAMEVE TE STUDIMIT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 1.24 European Standards and Guidelines-ESG 2015.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në REGJI FILMI E TELEVIZIONI është plotësisht në përputhje me synimin për të cilin është hapur, nevoja për përgatitjen e specialistëve në fushën e përcaktuar. Gjithashtu programi është në përputhje me interesat kombëtare, jo vetëm për përgatitjen e specialistëve, të cilët do të ndikojnë në edukimin qytetar me vlerat e demokracisë. Programi është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe përvojat ndërkombëtare. Departmenti që ofron programin ka përvojën, kapacitetet, infrastrukturën, burimet logjistike të nevojshme, laboratorë, bibliotekë etj. Për të realizuar veprimtarinë akademike. Statusi i veçantë që ka marrë në vitin 2021 i ka dhënë hapësirë dhe mundësi për të pasur programe që kërkon tregu dhe të rrisin cilësinë e tyre. Në këtë program është një ekip pedagogësh mjaft i kualifikuar dhe me përvojën e duhur si në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Të gjitha këto ndihmojnë për cilësinë sa më të</i></p>




	<i>mirë të programit dhe konkurimin në treg me dinjtet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ pasi vlerësoi dokumentacionin dhe RVB si dhe gjatë takimit në departament konstatoi se, bashkëpunimi midis kolegëve në departament ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë dhe ecurinë positive të programit Regji Filmi & Televizioni. Në këtë departament ka një ndarje të detyrave midis personelit akademik dhe atij administrativ. Secili ka detyrën dhe merr përgjegjësinë për ta kryer atë sa më mirë. Departamenti nga ana e tij ka detyrën e krijimit të një klime bashkëpunimi dhe një mjedisi sa më pozitiv. Ky departament në vazhdimësi bën analiza për vlerësimin e punës së secilit, por dhe të departamentit në përgjithësi. Statusi i veçantë i UART dhënë me VKM Nr. 145, DATË 10.03.2021: Për dhënien e statusit të veçantë UART, si institucioni i vetëm public i Arsimit të Lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë, iu jep një status të veçantë edhe personelit akademik të këtij institucioni. Është tashmë në edukatën e punës së këtij departamenti, që në çdo fillim viti të ri akademik të diskutohen në departament të gjitha problemet që nga ato mësimore, sekretaria e deri tek biblioteka etj. Ishte rregull në FAS ku bën pjesë edhe programi Bsc në “Regji Filmi & Televizioni” që në çdo fillim viti shkollor të diskutohen të gjitha problemet e dala, që nga ato mësimore, të sekretarive, bibliotekës etj. Nisur nga problemet e dala gjatë diskutimeve fakulteti përcakton detyrat për mbarëvajtjen e programit të studimit duke bashkërenduar sa më mirë punën midis personelit akademik dhe strukturave mbështetëse si, biblioteka, sekretaria, Këshillimi i Karrierës, sektori juridik, arkivi, protokollit etj. Ky bashkërendim i punës bëhet në kuadër të Universitetit të Arteve. Gjatë tërë vitit akademik ky bashkëpunim monitorohet në forma nga më të ndryshme, që nga kontrollet, relacionet nga Dekanati, opinionet nga studentët, takimet me titullarët etj.</p> <p>Nga diskutimet dhe problemet e dala hartohen plane pune për vitin e ri akademik, në kontekstin e zgjidhjes dhe detyrave për çdo problem. I rëndësishëm është edhe bashkëpunimi midis zyrave të ndryshme, i cili monitorohet nga dekanati. Në kontekstin e ruajtjes së cilësisë DRFTV përpiqet që të zgjedhë kandidatura sa më të kualifikuara, edhe të</p>

	<p>dalluara në këtë fushë, me qëllim që të ketë cilësi në vazhdimësi. Madje për të ruajtur, por edhe për ta çuar përpara cilësinë, edhe personeli akademik me kohë të pjesshme zgjidhet në bazë të kriterëve dhe pa i shkelur ato.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.4. vkm nr 145 datë 10. 3. 2021 statusi i veçantë.pdf.</i> <i>Evidenca: 1.5. statuti i uart urdhër ministri nr.319 për miratimin e statutit të UART dhe statuti.pdf.</i> <i>Evidenca: 1.25 raportet e vlerësimit te performancës vjetore për tre vite.pdf.</i> <i>Evidenca: 1.26. organigrama-UART.pdf.</i> <i>evidenca: 1.27 tabelat e stafit akademik fas.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i raportit të vlerësimit të brendshëm dhe vizita në Departament arriti në përfundimin se, FAS ku është edhe DRRFTV kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Për të rritur cilësinë e përgatitjes së studentëve, krahas punës në auditore institucioni promovon edhe veprimtari të tjera të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë.</p> <p>Një prej tyre është edhe vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione të të njëjtit profil brenda e jashtë vendit. Bashkëpunimi konsiston jo vetëm në fushën akademike, këmbimin e përvojave në mësimdhënie, por edhe në kërkimin shkencor dhe veprimtari të përbashkëta. Studentët, por pse jo dhe pedagogët marrin eksperiencë të reja, mbase edhe më të përparuar. Nga dokumentacioni shohim se institucionet me të cilat kanë vendosur bashkëpunim janë të shumtë, nga të cilët përmendim: Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet UART dhe Festivalit të Filmit Shkup CINEDAYS; Memorandum Mirëkuptimi midis Zhejiang Normal University in Jinhua, Zhejiang, China; Protokoll i Bashkëpunimit të UART të Bukura "Mimar Sinan" dhe UART; Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës; Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër; Shkollën kombëtare artistike "Jordan Misja". Universitetit Aldo Moro - Bari Universiteti Tor Vergata - Romë etj.</p> <p>Edhe programi Erasmus ka një impakt mjaft pozitiv në këmbimin e përvojave të studentëve dhe pedagogëve si dhe mobilitetit të tyre. Në tërësinë e tyre këto veprimtari kanë ndikim në realizimin e objektivave mësimore për këtë departament e fakultet. Dhe më kryesorja në programin e studimit "Regji Filmi & Televizioni".</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.28 UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus+.pdf.</i> <i>Evidenca 1. 29 Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit,</p>	<p>GVJ pas njohjes me RVB dhe takimit me pedagogët e departamentit, arrin në përfundimin që FAS si pjesë e UART bën përpjekje</p>




<p>institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>maksimale për realizimin me cilësi të programit të studimit. Krahas veprimtarisë akademike vëmendje i kushtohet edhe praktikave mësimore profesionale.</p> <p>Personeli akademik i FAS e ka të qartë se për vetë specifikat e programeve që mbulon, nuk mund t'i realizojë me efektivitet nëse përqëndrohet vetëm në punën brenda auditorit. Auditori është një gjë, por bashkëpunimi me institucione të të njejtit profil dhe sidomos në aspektin e praktikave dhe atë kërkimor, mundëson realizimin me sukses dhe cilësi të programit. Këto bashkëpunime janë sidomos të domosdoshme për praktikatat profesionale, stazhet etj.</p> <p>Institucione me një trashëgimi dhe përvopjее të pasur në këtë drejtim si, Radio Televizioni Shqiptar, Teatri i Operas dhe Baletit, Televizione kombëtare apo apo lokale, Qendra Kombëtare e Filmit etj. Ndihojnë studentët në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave. Edhe pakti për Universitetin 2018 krijoi hapësira të mëdha për lidhjen e këtyre marrëveshjeve. Të gjitha praktikatat apo veprimtaritë kryhen nën survejimin e profesionistëve dhe pedagogëve të lëndëve.</p> <p>Këto marrëveshje duhej të ishin shprehur më qartë në kontekstin e aktiviteteve dhe impaktin tek studentët e në tërësi tek Programi i Studimit.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.28 UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus+.pdf.</i> <i>Evidenca 1. 29 Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ pas njohjes me RVB, takimi me Stafin akademik të DRRFTV arritën në përfundimin se njësia përgjegjëse (DRFTV) i vlerëson mjaft bashkëpunimet me institucione jashtë FAS. Këto bashkëpunime sipas tyre ndikojnë në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Departamenti ndjek me vëmendje të gjitha marrëveshjet dhe për këtë harton raporte në të cilat jepen përfitimet nga këto marrëveshje.</p> <p>UART ka lidhje me institucione brënda e jashtë vendit, por në dokumentacion nuk është pasqyruar një gjë e tillë. Pra, cilat janë përfitimet nga këto marrëveshje, çfarë problemesh kanë dalë. Sigurisht jepen me foto aktivitete të ndryshme, por jo analiza. Do ishte mirë që të kishte protokolle të këtyre analizave në departament për të parë e vlerësuar problematikat</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në përfundim të procesit të vlerësimit të këtij standarti arrin në përfundimin se, DRRFTV ka bërë një punë shumë të mirë për përbushjen e standartit, në mënyrë cilësore. Realizimi me cilësi i programit mësimor ishte prioritet i këtij standarti. Në këtë kontekst departamenti karahas punës në auditor i kushtonte vëmendje punës jashtë tij. Vendosija e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me institucione të tjera ishte prioritet. Ky bashkëpunim kishte si qëllim pjesëmarrjen e studentëve në projekte artistike dhe në kërkimin</i></p>





	<p><i>shkencor.</i></p> <p><i>Në tërësinë e tyre këto marrëveshje ndikojnë në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve dhe mobilitetit të studentëve e pedagogëve brënda e jashtë vendit.</i></p> <p><i>Gjithsesi, në këtë pikë duhet bërë më shumë në kontekstin e analizës së marrëveshjeve dhe impaktit të tyre në peformancën e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ vlerësoi gjatë njohjes me RVB dhe arriti në përfundimin se, Programi i Studimit Bachelor në “Regji Filmi &Televizioni” ka një strukturë të mirëorganizuar. Objektivi i programit është të përgatisë specialistë të aftë për regji të Televizionit dhe Filmit. Brënda këtij niveli studimi Bachelor, studenti merr njohuri të mjaftueshme, me të cilat del në treg apo vazhdon më tej. E tërë përmbajtja e programit është e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, në përputhje me udhëzimet e MAS dhe atë Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Lëndët e këtij programi janë grupuar në kategoritë:</p> <p>A - Lëndë Bazë-- (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme);</p> <p>B - Lëndë Karakterizuese--(përgatitje Për disiplinën shkencore - artistike);</p> <p>C - Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese--(nën-disiplina dhe profile);</p> <p>D - Lëndë Plotësuese--(grup-lëndë me zgjedhje, gjuhë e huaj, praktika profesionale);</p> <p>E - Detyrime Përmbyllëse--(Diploma, Tema Teorike dhe Projekti Artistik). Kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 180 ECTS në të tri vitet e studimit.</p>




	<p>Metodologjia e grupimit të lëndëve është mjaft e studiuar dhe ndikon në formimin cilësor të studentëve.</p> <p><i>Dokumentacioni</i> <i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit dhe RVB që konsultoi arriti në përfundimin, se ky program është hapur pikërisht për të plotësuar nevojat që ka tregu për regjizorë, veçanërisht për regjizorë filmi dhe televizionit. Programi i Studimit nëpërmjet mësimdhënies që bazohet mbi të menduarin kritik synon pajisjen e studentëve me kompetenca akademike dhe praktike në fushën e regjisë së Filmit e Televizionit. Studentët të pajisur me këto kompetenca janë të aftë e në gjendje jo vetëm të përballojnë sfidat e profesionit, por t'i japin përgjigje edhe situatave të vështira e të zgjidhin probleme që dalin gjatë rrugës së regjisë së filmit e televizionit.</p> <p>Personeli akademik është i angazhuar në një mësimdhënie cilësore që bazohet mbi të menduarin kritik e krijues. Kjo mënyrë ndikon në pajisjen e studentëve me aftësi e kompetenca në fushën e regjizurës së Filmit e Televizionit. Në përfundim të kursit programi ka për qëllim përgatitjen e specialistëve të regjisë së filmit e televizionit. Gjithashtu studentët duhet të jenë veçanërisht të aftë për të vazhduar më tej studimet. Për të motivuar sa më shumë studentët, pedagogët përdorin metoda interactive, duke i bërë studentët pjesë të procesit, dhe pjesë të zgjidhjes së problemeve. Bashkëpunimi pedagog-student është i padiskutueshëm edhe për vetë natyrën e Programit të Studimit. Bashkëpunimi është në auditor dhe jashtë tij, në praktikë apo terren.</p> <p><i>Dokumentacioni:</i> <i>Evidencë2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji 2024 - 2025 -LËNDË NDËRDISIPLINORE INTERGRUESE.pdf.</i> <i>Evidencë2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji 2024 - 2025 - LËNDË BAZË.pdf.</i> <i>Evidencë2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji 2024 -2025 - LËNDË ME ZGJEDHJE DHE LËNDË PLOTËSUESE.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ pasi studioi Raportin e Vlerësimit të Brendshëm arriti në përfundimin se: Programi i Studimit e ka të shprehur qartë objektivin që do të arrijë në përfundim të studimeve. Personeli akademik në përputhje me synimet ka studiuar mirë lëndët e të gjitha kategorive që duhet të jenë pjesë e kurrikulës, të cilat ndikojnë në formimin e studentëve të programit Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”. Pedagogët kanë bërë një punë tepër serioze dhe profesionale për përcaktimin e lëndëve bazë apo ato të specialitetit, duke ndarë edhe orët apo kreditet për secilën.</p> <p>Programi i Studimit Bachelor në “Regji Filmi&Televizioni”, është organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite, sipas udhëzimeve të MAS, në përputhje me sistemin Evropian të Transferimit dhe</p>




	<p>Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Lëndët e këtij programi janë të grupuara sipas kategorive:</p> <p>A - Lëndë Bazë - (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme);</p> <p>B - Lëndë Karakterizuese - (përgatitje Për disiplinën shkencore - artistike);</p> <p>C - Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese - (nën-disiplina dhe profile);</p> <p>D - Lëndë Plotësuese - (grup-lëndë me zgjedhje, gjuhë e huaj, praktika profesionale);</p> <p>E - Detyrime Përmbyllëse- (Diploma, Tema Teorike dhe Projekti Artistik). Kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 180 ECTS në të tri vitet e studimit.</p> <p>Kreditet janë të përcaktuara sipas legjislacionit, bazuar në rëndësinë e lëndës, vendi që ze në program dhe orët e studimit.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ pas njohjes me RVB dhe vizitës në DRRFTV arrin në përfundimin se, se lëndët që përfshihen në kurrikulën e programit të studimit Bsc në “Regji Filmi & Televizioni” janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me raportet specifike të përcaktuara në Shtojcën I të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL” i ndryshuar. Konkretisht në këtë program studimi studenti merr 36 kredite, për Lëndët Bazë, kategoria A, 99 kredite për Lëndët Karakterizuese, kategoria B, 12 kredite për Lëndët Ndërdisciplinore, kategoria C, 23 kredite për Lëndët Plotësuese, Kategoria D, dhe 10 kredite për kategorinë përmbyllëse. (provim, diplomë) Një kredit është 25 orë mësimore e studentit e përbërë nga orët në auditor, leksione, seminare, detyra etj, dhe orë individuale. Një vit akademik ka 60 kredite.</p> <p>Në Programin “Regji Filmi & Televizioni” praktika merr rëndësi të veçantë për vetë natyrën e programit. Praktika nga vetë specifikat e saj zhvillohet në ambjentet e institucionit apo jashtë saj në bazë të marrëveshjeve. Praktika zhvillohet në të tri vitet, e ndarë nga 30 orë për çdo vit, pra 90 orë në total. Në fund të çdo viti akademik studenti vlerësohet me notë, kjo referuar edhe Rregullores së programit të studimit. Në përgjithësi pedagogët e praktikës janë ata të lëndëve kryesore profesionale. Praktika i vlerësohet me 6 kredite për 3 vjet, 2 kredite në vit. GVJ konstaton se ngarkesa me kredite për praktikën profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse është përcaktuar sipas ligjit.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 1.2.VKM Nr 41 -2018-01-24 përditësuar.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.4 VKM NR 145 datë 10_3_2021 Statusi i Veçantë.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i</p>	<p>GVJ duke analizuar RVB arrin në përfundimin se UART si institucion ka status të veçantë, status që i është dhënë në përputhje me ligjin e</p>




<p>studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Arsimit të Lartë dhe veçorive specifike që ai ka. UART është i vetmi institucion publik i Arsimit të Lartë në fushën e Arteve në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu GVJ konstaton se programet e hapura janë organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e dala nga MAS, si dhe standartet ndërkombëtare. Kjo me qëllim që studentët të konkurojnë denjësisht brenda e jashtë vendit. Të gjithë programet e Fakultetit Skenik, janë në përputhje me synimet dhe specifikat që ka institucioni. Për veçoritë që ka nuk organizon programe me kohë të pjesshme. Politikat e pranimit të studentëve për shkak të specifikave të tij janë disi më ndryshe në raport me programet në Universitete të tjera. Kriteret përcaktohen nga UART, me rregullore të veçantë, të cilat miratohen nga Senati e më pas nga MAS. Numri i pranimit të studentëve dhe tarifat përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Kjo lidhet gjithashtu edhe me faktin se jo kushdo mund të shkojë të studiojë në këtë institucion. Pikërisht nisur nga ky fakt institucioni zbaton politika mbështetëse për studentët. Sipas ligjeve studentët mund të përfitojnë nga 50 deri në 100% bursë. Edhe komuniteti rom apo ai egjiptian gjejnë mbështetje dhe përkrahje. Por ndryshe nga programet e tjera në këtë institucion nuk mund të mbështeten student me aftësi ndryshe (difekte në shqisa të veçanta), e kjo lidhet me specifikat e përmbajtjes së programit. E kundërta do të ndikonte në përvetësimin e programit.</p> <p><i>Dokumentacioni:</i> <i>Evidenca 1.4 VKM nr 145 datë 10_3_2021 statusi i Veçantë.pdf</i> <i>Evidenca 1.5 Statuti i UART urdhër ministri nr.319 per miratimin e statutit të UART dhe statuti.pdf.</i> <i>Evidenca 1.15 Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i> <i>Evidenca 1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.pdf.</i> <i>Evidenca 1.20 VSA_nr.20_dt.07.10.2021, miratimi i rregullores së UART.pdf</i> <i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i> <i>Evidenca 2.3 VSA nr 15 2023 Miratimi i rregullores se konkursit 2024 - 2025.pdf.</i> <i>Evidenca 2.4 VKM 251 27.03.2020 Përjashtimi nga tarifa te studenteve Rome-Ballkano-Egjiptian.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në</p>	<p>GVJ pasi u njoh me dokumentacionin arrin në përfundimin se, në vendin tonë nuk ofrohen programe të njejta studimi me programin Bsc në “Regji Filmi e Televizioni”. Prania e programeve të tilla do të ndikonte pozitivisht dhe do të rriste konkurrencën midis tyre apo të ngjajshmëve. Madje edhe vetë UART nuk ka ofruar ndonjë program të tillë në institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Në këtë aspekt</p>

nivel, së paku 70 për qind.	mbase kanë ndikuar faktorë të cilat më së paku lidhen me tregun, apo edhe cilësitë e studentëve që konkurojnë		
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ pas njohjes me raportin dhe vizitën në departament arrin në përfundimin se Programi i Studimit në Regji Filmi & Televizioni shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së Studimit dhe Klasifikimeve të bëra publike me anë të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022: “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”. Programi i Studimit të ciklit të parë në Regji Filmi e Televizioni sipas pikës 2, gërma c), është Bachelor, jo më pak se 180 ECTS me kodin 63 BA. Fusha e gjere e Programit të Studimit është ajo 02 - Arte dhe Shkenca Humane. Fusha e ngushtë e Programit të Studimit është: 021 - Arte. Fusha e detajuar e Programit të Studimit është: 0215 - Arte Muzikore dhe Performimi. Gjuha në të cilën ofrohet Programi i Studimit është shqip (S). Këto të dhëna janë pjesë e RVB dhe u konfirmuan nga pedagogët e DRRFTV. Dokumentacioni: <i>Evidenca 2.5_VKM 310 11.5.2022- specifikimet dhe përmbajtjet e kodifikimit të programeve të studimit.pdf</i>		
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	GVJ pas njohjes me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjatë takimit në DRRFTV konstaton se, UART, FAS, DRRFTV nuk ofrojnë programe të ciklit të parë të Ciklit të Parë Bachelor në Institucione brënda apo jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi me të njejtën emërtesë apo të përaftërt në emërtesë. Madje nuk kanë as programe të përbashkëta me institucione brenda apo jashtë vendit. Në se do të kishte, do të ndikonte pozitivisht në konkurrencë e për pasojë në cilësinë e programit e performancën e tij.		
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit arrin në përfundimin se, programi i Studimit Bsc në REGJI FILMI & TELEVISIONI është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe rregulloret e dala nga MAS. Përmbajtja e programit është në përputhje me synimet e institucionit. Gjithashtu elementët e tij janë në një linjë me Sistemin Evropian të grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve. Kjo përputhje dhe përshatje krijon mundësinë e transferimit të studentëve brenda e jashtë vendit. Në përputhje me specifikat e programit është bërë një punë e mirë nga departamenti për të përcaktuar lëndët me raportet e tyre, të cilat ndikojnë në formimin e studentëve. Këto lëndë janë të formimit bazë apo specific. Pranimi i studentëve në përputhje me specifikat e institucionit ka kritere të cilat janë përcaktuar nga institucioni në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kodifikimi i programit është bërë, tashmë duhet të kryhet kodifikimi i lëndëve, pas vendimit të ardhur nga MAS.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ pasi u njoh me dokumentacionin arriti në përfundimin se UART është një institucio i konsoliduar në veprimtarinë akademike. DRRFTV që është njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin Regji Filmi dhe Televizioni, është një institucion me një traditë të pasur dhe të konsoliduar në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij. Gjithashtu UART pjesë e të cilit është DRRFTV ka një strukturë të konsoliduar në veprimtarinë akademike. Njësia kryesore së bashku me njësitë bazë që ofrojnë programin, akademike dhe administrative funksionojnë duke u mbështetur në legjislacionin për Arsimin e Lartë. Konkretisht ajo vepron duke u mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 25 pika 4, për Departamentin dhe përbërjen e tij. Për të funksionuar sa më mirë njësia kryesore UART ka në përbërje të tij njësi bazë akademike dhe administrative të cilat ushtrojnë funksionet e tyre. Institucionet janë të organizuara vertikalisht dhe horizontalisht. Në këtë kontekst struktura akademike dhe administrative është e qëndrueshme.</p> <p>FAS që është pjesë e UART ofron programe, të cilat përmbushin objektivat akademike dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve nr.6. FAS organizohet nga tri njësi bazë(departamente):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti Aktrim dhe Teori (A&T); - Departamenti Regji, Regji Filmi dhe TV; - Departamenti Skenografi-Koreografi <p>Për FAS numri i personelit Akademik me kohë të plotë dhe me kontratë, për 3 vitet e fundit akademike, është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="622 1422 1268 1904"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të FAS</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> <th colspan="2">2024-2025</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>13</td> <td>2</td> <td>12</td> <td>2</td> <td>11</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>15</td> <td>2</td> <td>14</td> <td>2</td> <td>14</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr. proc</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>8</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>4</td> <td>19</td> <td>5</td> <td>24</td> <td>5</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>45</td> <td>27</td> <td>44</td> <td>32</td> <td>44</td> <td>26</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit akademik të FAS	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	13	2	12	2	11	2	Prof. Asoc.	15	2	14	2	14	3	Dr/Phd	6	4	6	4	6	3	Dr. proc	7	-	7	-	8	2	Msc.	4	19	5	24	5	16	Gjithsej	45	27	44	32	44	26
Kualifikimi i stafit akademik të FAS	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof. Dr	13	2	12	2	11	2																																																		
Prof. Asoc.	15	2	14	2	14	3																																																		
Dr/Phd	6	4	6	4	6	3																																																		
Dr. proc	7	-	7	-	8	2																																																		
Msc.	4	19	5	24	5	16																																																		
Gjithsej	45	27	44	32	44	26																																																		




	<p>Stafi akademik i DRRFTV dhe kualifikimet e tyre për 3 vitet e fundit akademike, paraqiten si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="622 336 1268 817"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të FAS</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> <th colspan="2">2024-2025</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr. proc</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>3</td> <td>8</td> <td>3</td> <td>7</td> <td>4</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>18</td> <td>9</td> <td>18</td> <td>8</td> <td>20</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca, 3.4 Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencore të stafit RRFTV.pdf.</i> <i>Tabelat 1, dhe 2.1, 2.2, 2.3 aneks tabelat përmbledhëse</i></p>	Kualifikimi i stafit akademik të FAS	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	6	1	6	1	6	1	Prof. Asoc.	4	-	4	-	4	1	Dr/Phd	5	-	5	-	5	-	Dr. proc	-	-	-	-	1	-	Msc.	3	8	3	7	4	7	Gjithsej	18	9	18	8	20	9
Kualifikimi i stafit akademik të FAS	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof. Dr	6	1	6	1	6	1																																																		
Prof. Asoc.	4	-	4	-	4	1																																																		
Dr/Phd	5	-	5	-	5	-																																																		
Dr. proc	-	-	-	-	1	-																																																		
Msc.	3	8	3	7	4	7																																																		
Gjithsej	18	9	18	8	20	9																																																		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>GVJ pas njohjes me dokumentacionin konstaton se, Universiteti i Arteve është i formësuar dhe strukturuar qoftë në aspektin akademik apo edhe administrativ. Por edhe njësia kryesore/bazë që ndjek Programin e Studimit, DRRFTV, është i angazhuar në plotësimin e të gjitha detyrimeve që përmban programi. Në këtë angazhim të departamentit është përfshirë edhe personeli joakademik, ndihmës akademik. Në këtë kontekst bashkëpunimi është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që më pas është përfshirë në rregullore të veçantë të njësisë kryesore.</p> <p>Angazhimi i personelit ndihmës akademik është i domosdoshëm. Ai ndahet në ndihmës akademik me karakter mësimor, artistik shkencor dhe administrativ. Personeli ndihmës akademik mësimor ndihmon në realizimin e e programit mësimor në tërë dimensionet e tij. Ky personel bën pjesë në departament. Këtu hynë laborantët dhe teknikët. Preferohet që ky personel të jetë i fushës së arteve, sa më pranë përmbajtjes së programit të studimit. Madje ai shpesh përzgjidhet nga ish studentët e atij profile. Procesi mësimor dhe veprimtaritë artistike kanë nevojë gjithashtu për mbështetje në aspektin administrative. Pra pikërisht për këtë nevojitet. Detyrat e tij janë të përcaktuara me rregullore. Personeli administrative ndihmon duke vënë në dispozicion infrastrukturën e duhur për veprimtaritë apo orët e ndryshme mësimore. Edhe sekretaria është pjesë e procesit mësimor. Ajo ndjek të gjithë procedurën e veprimtarisë mësimore.</p> <p>Pranë departamentit të RRFTV në FAS është i atashuar dhe Specialisti i Regjisë së Filmit e Televizionit, si dhe bashkëngjitet kurdo që është e</p>																																																							




	<p>nevojshme edhe Kryetari i Degës Mësimore në FAS përgjatë aktivitetit të përditshëm mësimor dhe në mënyrë të pandërprerë edhe përgjatë periudhës së provimeve. Struktura administrative dhe ndihmës akademike në FAS përbëhet si më poshtë vijon: Struktura ndihmës akademike me karakter administrative janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sekretaria e FAS 2. Kryesekretarja e FAS 3. Specialisti për kurrikulën dhe informimin e Studentëve 4. Kryetari i degës së FAS 5. Sekretaria mësimore 6. Punonjësit e shërbimit 7. Struktura ndihmës akademike me karakter akademik: 8. Specialistët (laborantët) e FAS. <p>Ky shpjegim është në RVB dhe u konfirmua edhe nga dokumentacioni referues si dhe biseda në departament. Ky kriter është përmbushur.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1. 16 Rregullorja e FAS. Neni 14, 15.</i> <i>Evidenca 1.5 Statuti i UART. Neni nr. 69, 70, 71.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit shoqërues paraqitur në RVB, GVJ konstaton se, programet e studimit që mbulon DRRFTV janë të organizuar në grupe mësimore. Departamenti për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor cakton një coordinator të programit të studimit Bachelor, për ndjekjen e ecurisë së procesit mësimor. Kordinatori ndjek procesin mësimor apo praktikat profesionale, aq të domosdoshme për realizimin e objektivave. Rolin e koordinorit të Programit të Studimit e luan pedagogu që është edhe kryetar i grupit mësimor për këtë program studimi.</p> <p>Qëllimi i tyre është realizimi i objektivave. Koordinatori caktohet me vendim të dekanit të FAS.</p> <p>DRRFTV ka dy programe studimi ai Bsc në “Regji” dhe Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”. Këto dy programe përbëjnë 2 grupe mësimore (grupi i studimit është i përbashkët si për ciklin e parë ashtu edhe për ciklin e dytë). Këtë mënyrë funksionimi të grupeve apo koordinatorëve e kushtëzon edhe specifika e programit të Studimit. Kjo mënyrë organizimi dhe funksionimi ka për qëllim formimin e studentëve me kompetenca akademike dhe praktike.</p> <p><i>Dokumentacioni:</i> <i>Evidenca 1. 17 Rregullorja e Departamentit RRFTV Neni nr.9.10.</i> <i>Evidenca 2. 6 Drejtuesit e grupeve mësimore në FAS</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pas vlerësimit të dokumentacioni arrin në përfundimin se Fakulteti i Artit Skenik në përgjithësi dhe Departamenti i Regjisë, Regjisë së Filmit dhe Televizionit në veçanti, të gjithë veprimtarinë mësimore e ka në përputhje me ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë. Prioritet i departamentit ka qenë rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar. Struktura akademike e Programit të Studimit është e</i></p>




	<i>qëndrueshme. Me qëllim funksionimin sa më mirë të programit, departamenti cakton koordinatore për secilin program. Kjo i shërben cilësisë së tij. Ka një organizim të qëndrueshëm. Personeli akademik dhe ndihmës akademik bashkëpunonin në të mirë të studentëve dhe të rritjes së cilësisë së programit. Në përfundim njësia përmbush kërkesat ligjore dhe standartet për stafin akademik, ndihmës akademik dhe ecurinë e programeve dhe praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>GVJ pas njohjes me RVB dhe dokumentacionin shoqërues, arriti në përfundimin se DRRFTV është njësia bazë dhe pjesë përbërëse e Fakultetit të Artit Skenik. Kjo njësi është përgjegjëse për ecurinë e programit të Studimit. Për të pasur programe të standartizuara dhe në përputhje me përmbajtjen e programit zbaton udhëzimet e MASR si dhe VKM-së nr.145 datë 10.03.2021, për dhëniein e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë. Mbi bazën e këtyre udhëzimeve DRRFTV që është përgjegjës për programet Bsc në “Regji” dhe Bsc në “Regji Filmi e Televizioni”, harton rregulloret për secilin program. Programi është i strukturuar mirë, në bazë të Planit mësimor, programet lëndore, rregulloret specifike për programin e studimit. Plani mësimor është dokumenti i parë me të cilin prezantohet Programi i Studimit. <i>Në të bëjnë pjesë: emërtimi i programit, kohëzgjatja si dhe kompetencat formuese akademike dhe praktike.</i> Veprimtaria mësimore ndahet në vite e semestra. Në to bëjnë pjesë veprimtaritë akademike dhe praktike. Në ndarje kihet parasysht edhe ndarja në leksione, seminare, veprimtari artistike etj. Programet mësimore të lëndëve hartohen në bazë të VKM nr 145. Në përmbajtjen e tyre programet kanë lëndë të cilat kanë njouri të domosdoshme për formimin akademik e praktik të studentëve. Vitet akademike kanë lëndë të ndryshme, ka përpjekje për të shmangur përsëritjen. DRRFTV ka kapacitetet e nevojshme akademike dhe infrastrukture për zhvillimin e këtij programi studimi.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.4 VKM nr_145 date 10_3_2021 Statusi i Veçantë.pdf.</i> <i>Evidenca 1.17 Rregullore e veprimtarise se pergjithshme e dep. rrfv.pdf.</i> <i>Evidenca 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.pdf.</i></p>




	<p><i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i> <i>Evidenca 2.7 Vendim i BA te ASCAL për Akreditimin Institucional te UART.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ pasi analizoi dokumentacionin dhe takimi në departament arriti në përfundimin se, Programi i Studimit në “Regji Filmi e Televizioni” është organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite. Ky veprim është bazuar në VKM 41/2018 dhe gjithë legjislacionin dhe udhëzimet e MASR. Përveç legjislacionit vendas organizimi i lëndëve është bazuar edhe në sistemin Evropian të Grumbullimit dhe transferimit të Krediteve. Baza e Programit të Studimit Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni” ka në bazë të tij Planin mësimor, i cili ka të gjithë materialin e nevojshëm që përmban ky program. Kryesorja që ka është struktura akdemike, lëndët që zhvillohen në tri vite e simenstra, ngarkesën mësimore për çdo lëndë, brenda apo jashtë auditorit. Plani mësimor i propozuar nga DRRFTV është miratuar në Senatin Akademik të UART. Plani mësimor gjithashtu përmban objektivat dhe synimet që do të arrijë student në përfundim të studimeve Bachelor. Plani mësimor mbështetet nga një kurrikul e detajuar që përmbledh objektivat, kompetencat të cilat janë konkretizuar në syllabuset lëndore. Tërësia e lëndëve që është përzgjedhur për të qenë pjesë e programit Bs në “Regji Filmi & Televizioni”, elementë të profilit dhe përmbajtjes, të cilat ndikojnë në formimin e përgjithshëm dhe edukimin special. Gjithashtu është vlerësuar që këto lëndë të ndikojnë në aftësimin me kompetenca akademike dhe praktike.</p> <p>Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese ndahen si më poshtë:</p> <p>A. Lëndë bazë të Programit të Studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;</p> <p>B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veqoritë e Programit të Studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese dhe profile të programit;</p> <p>D. Grup-lëndë me zgjedhje, lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike (telekomunikim dhe informatikë), aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale;</p> <p>E. Detyrime përmbjllëse, që lidhen me provimin përfundimtar</p> <p>Veprimtaritë formuese mund të jenë: të detyrueshme; të zgjedhura nga vete studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të Programit të Studimit. Departamenti ka vlerësuar drejt përmbajtjen e lëndëve dhe ndikimi që ato kanë në formimin</p>




	<p>professional të studentëve.</p> <p>Lënda Karakterizuese e këtij programi është Regjia e Filmit që shtrihet në tri vite studimi me një total prej 66 ECTS. Ngarkesa në auditor e studentëve është 240 orë vjetore dhe ajo e përgatitjes individuale jashtë auditorit është midis 300 dhe 360 orë vjetore në varësi të vitit të studimit. Programi i studimit realizohet në tri vite studimi ose 6 semestra. Rëndësi ka edhe përgatitja për lëndët Skenar Filmi dhe Aktori para Kamerës, përkatësisht me 12 dhe 4 kredite. Në përfundim vlerësohet metodologjia për zgjedhjen e lëndëve dhe ngarkesës së tyre.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.2VKM Nr 41 -2018-01-24_përditësuar.pdf</i> <i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga biseda me pedagogët në DRRFTV dhe vlerësimi i RVB, GVJ, arrin në përfundimin se në Programin e Studimit Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”, që është pjesë e DRRFTV, përmban të gjitha njohuritë e nevojshme për studentët të cilët duan të studiojnë në Programin e Studimit Bsc në “Regji Filmi e Televizioni”. Gjëja e parë që mësojnë lidhet me mënyrën e pranimit në këtë Program. Kriteri i parë i pranimit është zotërimi nga kandidati për student i diplomës së shkollës së mesme dhe pastaj i nënshtrimit konkurrimit. Pranimi përmes konkurrimit bëhet sipas meritës, aftësive dhe talentit. Ky program përjashton mezataren e notës. Programi Bachelor ofron 180 kredite referuar nivelit 6 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohëzgjatje normale jo më pak se tri vite akademike.</p> <p>DRRFTV që mbulon këtë program studimi, ka parasysh që ai të zhvillohet me cilësi të lartë. Në këtë kontekst veç informacionit të nevojshëm ata (pedagogët) parashetrojnë edhe numrin e kuotave të pranimit. Këtë e argumentojnë me personelin akademik në dispozicion, infrastrukturën, hapësirat e institucionit, personelin akademik mbështetës etj. Ata kanë parasysh edhe raportin pedagog-student që në këtë program është 1 me 8. Vlerësohet gjithashtu edhe literatura e aksesueshme në bibliotekë apo on-line. Ju mundësohet studentëve informacioni për transferimin e krediteve, mundësitë e mobilitetit në programe të ndryshme tj. Për transferimin e krediteve brenda apo jashtë institucionit të UART ngrihet një komision i posaçëm që vlerëson në detaje procesin. Në përfundim të procesit i dërgohet një raport me të gjitha gjetjet Dekanit të FAS i cili merr vendimin përfundimtar për transferimin ose jot ë studimeve.</p> <p>Në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomë universitare “Bachelor”. E rëndësishme është që studentët marrin njohuritë bazë, aftësitë akademike dhe kompetencat praktike mbi regjinë e filmit, të televizionit, por edhe të zhanreve të tjera skenike.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.4_VKM nr. 145 datë 10_3_2021 statusi i veçantë.pdf</i></p>




	<p><i>Evidenca 1.17 rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e dep. RRFTV.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.8 manual i transferimit të studimeve në UART .pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ duke parë programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Bsc në “Regji Filmi&Televizioni” për secilën lëndë apo praktikë, arrin në përfundimin se, në përmbajtje kanë të gjithë elementët që ndikojnë në formimin dhe aftësimin me kompetenca akademike dhe praktike të studentëve. Realizimi i programit kryhet brenda e jashtë auditorit. Stafit akademik që është marrë me përgatitjen e Planit mësimor, është njohës i mirë i përmbajtjes së Programit Mësimor, synimeve dhe objektivave të tij. Komponentët përbërës të programit mësimor janë: leksionet, seminarët, veprimtaritë artistike, veprimtaritë praktike, projektet artistike, puna kërkimore etj. Të gjitha këto zhvillohen jashtë apo brenda institucionit me partnerë të specializuar të fushës, në përputhje me formatin e miratuar. Këto të gjitha referuar VKM 41, dt. 24/01/2018, i ndryshuar. Informacioni i përmendur është i pasqyruar në Planin Mësimor të Programit të Studimit. Me interes është që të theksojmë se programet përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme. Ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda e jashtë auditorit me qëllim pasurimin e aktivitetëve.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.29 Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi dhe Tv 2024 - 2025 - LËNDË KARAKTERIZUESE.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji 2024 - 2025 -LËNDË NDËRDISIPLINORE INTERGRUESE.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji 2024 - 2025 - LËNDË BAZË.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji filmi dhe tv 2024 -2025 - LËNDË ME ZGJEDHJE DHE LËNDË PLOTËSUESE.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga RVB, dokumentet shoqëruese, por edhe nga biseda në DRRFTV GVJ, arrin në përfundimin se ka përpjekje për të përmirësuar përmbajtjen e programit të Studimit. Përmirësimi i përmbajtjes së programit bëhet duke marrë në konsideratë mendimet e pedagogëve me përvojë, sugjerimet e studentëve, sidomos ata që janë të përfshirë në punë, partnerët brenda e jashtë vendit si dhe institucionet ku bëjnë praktikat studentët. Kjo bëhet për të përmirësuar programin e më së pari studentët të njihen me të rejtat e shkencës dhe t'i përgjigjen kërkesave të tregut. Programet duhet të përcjellin ide të reja bashkëkohore. Bazë për ndryshimin apo përmirësimin shërben VKM Nr. 185, datë 25/03/2021, zhvillimet e vazhdueshme në fushën e</p>




	<p>pedagogjisë, në fushën sociale, në fushën e arteve, të cilat evidentohen në realitet. Jo vetëm programet, por kishte përpjekje edhe për përditësimin e literaturës. Ndryshimet në programet Lëndore, apo edhe në Programin e studimit bëhen të argumentuara dhe në fillim të vitit të ri akademik. Të gjitha diskutimet dhe ndryshimet janë pjesë e dosjes dhe ruhen në arkivë. Ndryshimet, përditësimet janë të diskutuara në departament, por duhet të ruhen më mirë.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.15 Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor ne UART.pdf</i> <i>Evidenca 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji Filmi dhe Tv.pdf.</i> <i>Evidenca 2.9_Rishikimi i Programeve të Studimit në vitet 2022-2024.pdf.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizita në Departament, GVJ gjykon se stafi i DRRFTV ka bërë një punë të mirë lidhur me organizimin e Programit të Studimit. Struktura dhe përmbajtja e programit është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe orientimet e MAS. Në tërësi përmbajtja e programit realizon objektivat e përcaktuara, të cilat lidhen me formimin akademik dhe aftësimin praktik të studentëve, me formimin e kompetencave. Në të gjitha programet lëndore janë vendosur informacionet e nevojshme. Në këto programe gjen jo vetëm temat, literaturën, orët, numrin e krediteve, të cilat janë në përputhje me realizimin e objektivave për formimin e studentëve. Metodologjia për përcaktimin e elementeve të programit është tejet shkencore, dhe e bazuar pikërisht në mundësinë e aftësimit të studentëve. Më shumë duhet bërë për përditësimin e tyre.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin	Nga dokumentacioni GVJ kostaton se emërtimi i programit të Studimit Bachelor në “Regji Filmi e Televizioni” dhe në tërësi përmbajtja e tij dhe e veprimtarive që formojnë studentët, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në vite e semestra bëhen sipas një metodologjie të caktuar. Metodologjia e ndarjes së koncepteve konsiston në dhënien e tyre nga më e thjeshta tek më e vështira. Kriteri bazë lidhet me përvetësimin e koncepteve bazë të fillimit, e më




<p>e studentëve.</p>	<p>pas njohuritë e tjera më të avancuara. Pas njohurive bazë, koncepteve, aftësitë teorike dhe praktike mbi regjinë skenike, krijohet mundësia që më pas të thellohen njohuritë akademike e aftësitë praktike. Këto njohuri dhe kronologjia e tyre janë të përcaktuara në Planin mësimor të Programit të Studimit. Thellimi i më tejshëm e më i specializuar bëhet në studiet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve. Veç kësaj, edhe punësimi i studentëve sidomos në pozicionin e regjizorit të teatrit krijon mundësi për thellimin e njohurive e aftësive. Lëndët e këtij programi janë përzgjedhur në atë mënyrë që studentët të zhvillojnë aftësi edhe në fushën e kërkimit artistiko - shkencor. Gjithsesi qëllimi kryesor është pajisja e studentëve me aftësi akademike dhe praktike të kërkuara në tregun e punës. Në këtë mënyrë rritet përfshirja e tyre në tregun e punës. Në fushën e regjisë së filmit dhe televizionit FAS dhe DRRFTV është i vetmi institucion që përgatit konsiderat dhe ofrojnë mundësi punësimi në këtë fushë.</p> <p>Aktualisht 91% e pedagogëve me kohë të plotë të DRRFTV janë formuar në auditorët e FAS. Zhvillimi i orëve mësimore në auditor gërsheton aftësimin akademik me atë praktik dhe kjo zhvillohet në konkretizimit artistik/regjizorial. Shpërndarja e lëndëve është bërë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, por edhe duke pasur në konsideratë specifikat e lëndëve që ndihmojnë në thellimin e njohurive profesionale.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.2 VKM Nr 41 -2018-01-24_përditësuar.pdf.</i> <i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i> <i>Evidenca 1.27 Tabelat e stafit akademik FAS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ pasi vlerësoi raportin dhe dokumentacionin shoqërues arrin në përfundimin se, e gjithë përmbajtja e programit është në përputhje të plotë me objektivat që institucioni ka pasur si qëllim. Lëndët, modulet shpërndarja e tyre në vite bëhet e studiuar. Po kështu edhe ndarja e lëndëve në orë mësimore bëhet e studiuar, në bazë të ngarkesës dhe rëndësisë që ka në formimin e studentëve. Objektivi kryesor i programit synon në formimin e studentëve më kompetenca akademike e praktike. Këto objektiva janë rezultate të pritshme të të nxënit. Në kontekstin e të nxënit, krahas verpimtarisë mësimore, të mësimdhënies e mësimdhënies ndikon edhe kërkimi shkencor.</p> <p>Metodologjia e ndjekur në DRRFTV për ndarjen e lëndëve në simestra, orë mësimore është parë e vlerësuar në tërë programin e studimit. Në këtë mënyrë kjo shpërndarje mundëson formimin sa më të mirë të studentëve në profesion dhe në kërkimin artistiko-shkencor, pra realizimin e objektivave. Pra ky program me tërë përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve synon t'i përgatisë studentët për tregun e punës, por edhe t'i përgatisë me bazat e nevojshme të njohurive për të vazhduar studimet në nivele të tjera, si master apo doktoraturë. Programi lëndor i organizuar në lëndë e module ka ka si objektiv</p>




	<p>kryesor:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dhënien e njohurive dhe koncepteve bazë teorike dhe praktike, në regji, regji filmi e Televizioni, por edhe zhanre të tjera. 2. Aftësimin akademik e praktik të studentëve për nivele të ndryshme punësimi si në atë të regjisë së teatrit, të regjisë së televizionit, regjisë së filmit. 3. Gjithashtu i mëson studentët që nëpërmjet metodave interactive apo teknikave të kërkimit shkencor të bëjnë punë dhe kërkim të pavarur në aspektë që kanë të bëjnë me regjinë kryesisht, por pse jo edhe me teatrin, filmin, televizionin, dramaturgjinë, kritikën dhe stilet e ndryshme të krijimit regjizorial. <p>Në përfundim të viteve të studimit studentët hyjnë të përgatitur në tregun e punës apo për të vazhduar më tej.</p> <p>Dokumentacioni: Evidenca 2.1 <i>Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ sipas bisedës në departament dhe veçanërisht nga RVB, konstaton se, në programin e Studimit Bsc në “Regji Filmi & Televizioni” ka një strukturë që ruan mirë raportet teori praktikë dhe që mundëson formimin e studentëve në aspektin teorik dhe praktik. Struktura dhe përmbajtja e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit. Pra lëndët dhe praktika që zhvillohet në këtë program formon dhe përgatit regjisorë të filmit dhe televizionit. Pas studimit të nivelit të parë, studentët mund të thellojnë njohuritë e tyre, pasi kanë marrë njohuritë bazë në nivelin Bachelor. Nga dokumentacioni mësojmë se lëndët e formimit profesional kanë përputhje dhe ngjashmëri me programe të ngjajshme ndërkombëtare. Kjo duket edhe nga programi Erasmus ku ky departament është bërë pjesë. Programi realizohet në tri vite akademike dhe vlerësohet me 180 kredite (ECT). Ndarja në orë dhe kredite është bërë në përputhje me rëndësinë që ka lënda në formimin e studentëve. Viti akademik ka 60 kredite. Bachelori zhvillohet në tri vite të ndara me nga dy semestra. 60 kredite i takojnë një studenti në vit. Kjo ndarje dhe ngarkesë është e ngjajshme me programe ndërkombëtare zbatuese të Kartës së Bolonjës. Një tjetër aspekt i rëndësishëm në përmbajtje të programit është raporti teori-praktikë. Në këtë drejtim mendojmë se është përcaktuar një raport i drejtë që ndikon më së mirë në aftësimin me kompetenca të studentëve. Për të strukturuar mirë programin me lëndë, orë mësimore, kredite, raportin teori-praktikë janë konsultuar përvojat më të mirë ndërkombëtare të institucioneve të ngjajshme që zbatojnë Kartën e Bolonjës</p> <p>Kurikula e programit të studimit është hartuar me kujdes, me qëllim që sigurojë një formim cilësor të studentëve dhe një raport të drejtë në ndarjen e lëndëve në vite dhe midis teorisë dhe praktikës.</p> <p>Dokumentacioni:</p>




	<p><i>Evidencë 2.1 _plani mësimor për tre vitet e fundit me vsa.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2-kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe Tv 2024 - 2025 - lëndë karakterizuese.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2-kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 - 2025 -lëndë ndërdisiplinore intergruese.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2-kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 - 2025 - lëndë bazë.pdf.</i></p> <hr/> <p><i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 -2025 - lëndë me zgjedhje dhe lëndë plotësuese.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga studimi i dokumentacionit dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, GVJ konstaton se, kriteri kryesor mbi të cilin është mbështetur ndarja e veprimtarive formuese të programit të Studimit Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”, është ndarja e veprimtarive formuese sipas një metodologjie të studiuar. Në këtë kontekst është përcaktuar një raport i drejtë në këto veprimtari, por edhe lëndët apo gruplëndët nga një vit akademik në tjetrin.Në këtë mënyrë arrihet formimin i studentëve, realizimi i objektivave.</p> <p>Lëndët janë ndarë të organizuara në 5 kategori, nga A-ja deri te E-ja (referuar VKM Nr.41, datë 24/01/2018 i ndryshuar). Lëndët janë të studiuara mirë në konceptin e ndarjes midis veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik. Madje këto raporte janë përcaktuar mirë edhe brënda një lënde, leksione seminare, detyra dhe veprimtari praktike. Këto raporte e këto zgjidhje kanë ndikim në formimin e studentëve pse jo dhe të transferimit të studimeve. Studentët pwrkatiten për tregun e punës si dhe për të qenë pjesë e programit Erasmus. Gjithashtu programimi i mirë i lëndëve, gruplëndëve, orëve raporti teori praktikë ndihmon në afrimin e programit të studimit me të ngjajshmit në vendet fqinjë apo dhe BE. Njëkohësisht ndihmon në bashkëpunime për veprimtari të përbashkëta me vende të ndryshme. UART e ka këtë pikësynim, të ketë veprimtari sa më shumë me partner të huaj që të mund të krijojnë kushte edhe punësimi të studentëve.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca1.2 VKM Nr 41 -2018-01-24 _përditësuar.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë karakterizuese.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 – 2025 –lëndë ndërdisiplinore intergruese.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë bazë.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 -2025 – lëndë me zgjedhje dhe lëndë plotësuese.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë2.1 _Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë1.28 _UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të</i></p>




	<i>projektit Erasmus dhe Erasmus+.pdf</i>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ në departamentin e RRFTV me pedagogët arrijnë në përfundimin se, programet lëndore (syllabuset) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me literaturën e pesë viteve të fundit. Përditësimi është i domosdoshëm për faktin se njohuritë ecin me ritme të shpejta. Në radhë të parë përditësimi është i domosdoshëm edhe për marrjen e njohurive dhe kompetencave të reja në përputhje me tregun. Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet e VKM 41 datë 24. 01. 2018 i ndryshuar. Krahas programeve lëndore (syllabuseve) rëndësi në këtë departament i kushtohet edhe përditësimit të literaturës së rekomanduar për seminare, projekte, detyra kursi, apo veprimtari artistike, e cila lidhet me të rejat për specialitetin e Programit të studimit. Këto pasqyrohen edhe në dokumentacion. Në dokumentacion përfshihen syllabuset e tri viteve të fundit.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca1.2 VKM Nr 41 -2018-01-24_përditësuar.pdf.</i> <i>Evidenca2.1_Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i> <i>Evidencë2.2_kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë karakterizuese.pdf.</i> <i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 – 2025 –lëndë ndërdisiplinore intergruese.pdf.</i> <i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë bazë.pdf.</i> <i>Evidencë2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në regji filmi dhe tv 2024 -2025 – lëndë me zgjedhje dhe lëndë plotësuese.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbytja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ pas njohjes me RVB dhe diskutimi në departament arrijnë në përfundimin se, përmbytja e programit të Studimit në tërësinë e tij, garanton formimin dhe kompetenca akademike dhe praktike. Së bashku me programin edhe kurrikula në mënyrë të veçantë ndihmon në përfitimin e dijeve dhe kompetencave. Metodologjia e përcaktimit të lëndëve brenda programit të studimit është teje shkencore dhe e studiuar. Cilat janë lëndët me të domosdoshme për këtë program, çfarë konceptesh ka njëra apo tjetra lëndë, cilat janë lëndët e formimit të përgjithshëm, po ato të specialitetit etj. Përmbytjet e lëndëve kanë ndihmuar e plotësuar njëra tjetrën në formimin e kompetencave. Lëndët janë në koherencë me njëra tjetrën dhe të gjitha së bashku shkojnë drejt synimeve dhe objektivave të programit.</p> <p>Qëllimi kryesor i përmbytjes së kurrikulës është aftësimi teorik dhe praktik i studentëve Bsc në “regji filmi dhe televizioni”. E veçanta e këtij programi është se i motivon studentët të marrin pjesë në projekte kërkimore-shkencore dhe ta realizojnë atë me sukses.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca1.5 statuti i UART urdhër ministri nr.319 për miratimin e</i></p>




	<p><i>statutit të UART dhe statuti.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca1.15 rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve bachelor në UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 _plani mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJI filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë karakterizuese.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJI filmi dhe tv 2024 – 2025 –lëndë ndërdisiplinore intergruese.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJi filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë bazë.pdf.</i></p> <hr/> <p><i>Evidenca2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJI filmi dhe tv 2024 -2025 – lëndë me zgjedhje dhe lëndë plotësuese.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në DRRFTV dhe njohjes me dokumentacionin arrin në përfundimin se, përmbajtja e programit në tërësi dhe e programeve lëndore në veçanti iu krijon mundësi studentëve për t’u formuar në aspektin akademik dhe praktik. Ky program ju jep njohuritë bazë dhe të mjaftueshme me të cilat studentët mund të konkurojnë në tregun e punës. Studentët e FAS/UART dhe konkretisht të programit Regji Filmi &Televizioni, për vetë natyrën e programit të studimit mund të përfshihen në tregun e punës, sidomos në televizione kombëtare apo lokale, në qendrën kinematografike, në teatër apo institucione të tjera të artit e kulturës, platform televizive etj. Këtë e vërteton fakti që shumë student janë punësuar. Këta studentë sjellin frymën e bashkëpunimit dhe kjo lidhet me natyrën e programit të studimit.</p> <p>Në kontekstin e përmbajtjes, Programi i studimit ju krijon mundësi dhe hapësira studentëve të ndjekin studimet e mëtejshme, master e doktoraturë.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca1.5 Statuti i UART urdhër ministri nr.319 për miratimin e statutit të UART dhe statuti.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca1.15 Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve bachelor në UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJI filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë karakterizuese.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJI filmi dhe tv 2024 – 2025 –lëndë ndërdisiplinore intergruese.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 _kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJi filmi dhe tv 2024 – 2025 – lëndë bazë.pdf.</i></p> <hr/> <p><i>Evidenca2.2 kurrikula e programit të studimit bachelor në REGJI filmi dhe tv 2024 -2025 – lëndë me zgjedhje dhe lëndë plotësuese.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se Programi i Studimit Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni” është në përputhje me synimet dhe objektivat që ka pasur DRRFTV. Në analizë të tij ky program është cilësor, me strukturë të qëndrueshme kjo është e dukshme në përmbajtjen e kurrikulës. Kjo</p>




	<p><i>kurrikul përgatit dhe aftëson studentët në pikëpamje akademike dhe praktike. Për vetë specifikën e Programit të Studimit vihet re një ndërthurje e natyrshme midis teorisë dhe praktikës. Pikërisht ky fakt ndikon pozitivisht në përgatitjen e studentëve dhe i bën të gatshëm për tregun e punës. Njëkohësisht ky program nëpërmjet sistemit të krediteve (ESTC) i lejon studentët të transferojnë studimet e tyre brenda e jashtë vendit. Diploma e marrë dhe sidomos aftësitë e krijuara gjatë studimit nga një kurrikul cilësore me parametrat dhe standartet evropiane ju krijojnë mundësinë jo vetëm të punësimit brenda apo jashtë vendit, por edhe ndjekjen e cikleve të tjera të studimit. Ky program studimi i përgatit studentët jo vetëm për tregun e punës, por edhe studime të mëtejme në nivele të tjera.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ pas njohjes me dokumentacionin konstaton se DRRFTV në procesin e përmirësimit të programit ka përpjekje të vazhdueshme për këtë proces. Përmbajtja e programit jo vetëm që përmirësohet, por përshtaten sa më mirë me tregun. Krahas cilësisë përshtatja me tregun është pikësynimi i departamentit. Për të realizuar sa më mirë këtë kërkesë janë konsultuar brenda e jashtë njësive bazë, me institucione partnere etj. Që të përmirësosh programin më së pari duhet ta ngresh në pikëpamje cilësore dhe për këtë duhet të përmirësosh vazhdimisht kurrikulën. Brënda punës së UART edhe DRRFTV synon në reformimin dhe përfshirjen e diplomave që institucioni i tyre lëshon në profesionet e rregulluara. Kjo gjë rrit cilësinë e përfshirjes në tregun e punës. (P.sh. në ciklin e dytë kjo është realizuar vetëm për pjesën e mësuesisë të diplomave tona). Në fund, ky departament synon reformën kurrikulare me qëllim që programet: Të jenë konkurruese në arenën kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare; 2. Të pajisin studentët me dijet dhe aftësitë e duhura për fushën ku ata studiojnë; 3. Të mundësojnë që studentët të jenë sa më konkurrues në tregun e punës pas diplomimit të tyre; 4. Të ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për zhvillime në të ardhmen dhe për të bërë përshtatje në përputhje me ndryshimin e kushteve; 5. T'u mundësojnë studentëve vazhdimësi studimi gjatë gjithë jetës.</p> <p>Në këtë drejtim DRRFTV merr në konsideratë edhe mendimin e studentëve për përmirësimin e programeve, përmes pyetësorëve të</p>




	<p>realizuar nga NJSBC në përfundim të secilit semestër. Këta pyetësorë synojnë të mbledhin sa më shumë informacione mbi temat, lëndët, metodologjinë e mësimdhënies, veprimtarinë praktike, seminarët, literaturën e ofruar, marrëdhëniet student-pedagog dhe angazhimin e stafit në këshillimin akademik. Megjithatë këta pyetësorë janë të përgjithshëm dhe mbase nuk arrijnë atje ku duhet me përgjigjet e tyre.</p> <p><i>Dokumentacioni mungon, edhe pyetësorët janë shumë të përgjithshëm dhe jo programi Bsc në “regji filmi apo televizioni”, apo impakti në ndryshim në ndonjë syllabus!!!!</i></p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 3.7 të dhëna nga pyetësoret e studentëve në FAS.pdf</i> <i>Evidenca .1.5 Statuti i UART urdhër ministri nr.319 për miratimin e Statutit të UART dhe Statuti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ pas njohjes me programin konstaton se, DRRFTV ka si qëllim që në përpjekjet për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e programit të përfshijë në diskutime dhe konsultime edhe studentët e diplomuar më parë. Këtë veprim e lidh më së pari me faktin se ata janë në profesion dhe mund të japin sugjerime për probleme me të cilat janë ndeshur gjatë punës. Këta student me eksperiencat e tyre brënda e jashtë vendit mund të japin ide të mira për përmirësimin e programeve. Sigurisht që stafi i merr në konsideratë të gjitha sugjerimet dhe i reflektojnë gjatë përmirësimit të programeve dhe kurrikulave. Vlersimi i sugjerimeve të studentëve lidhet edhe me faktin se FAS ka një numër të kosiderueshëm studentësh që punojnë me dinjitet brënda e jashtë vendit, kështu që mendimet e tyre janë të vlefshme.</p> <p>Eksperienca dhe sugjerimet e tyre vlerësohen. Qoftë si Departament apo edhe në mënyrë individuale pedagogët mbajnë lidhje me këta studentë dhe sugjerimet e tyre i kanë kurdoherë në konsideratë. Shpesh herë këta student janë pjesë e stafit akademik me kohë të pjesshme. Eksperienca e studentëve të mirë në programin Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”, merret në konsideratë dhe vlerësohet e trajtohet në programet lëndore ku është e mundur e duhur dhe reale. Kjo doli nga vlerësimi i RVB nga GVJ. Bashkëpunimi me ALUMNI duhet të pasqyrohet me mirë.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 2.10 Dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve të FAS, studentëve aktuale dhe ish studentëve.pdf</i> <i>Evidenca 2.11 Cmime, vlersësime dhe dëshmi të ish studentëve FAS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në</p>	<p>GVJ konfirmon se gjithmonë në kontekstin e përmirësimit të programit, me qëllim për t’u bërë konkures, qoftë edhe brënda UART, më së paku dhe, më së shumti në tregun e punës brënda e jashtë vendit, FAS dhe DRRFTV për vetë veçoritë specifike që ka i ka dhënë rëndësi të madhe bashkëpunimit me institucione të tjera të</p>

Leore!

[Signature]

<p>fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>ngjajshme më të, ose të përafërta. Ky bashkëpunim ofrohet me programe të caktuara dhe të mirëmenduara. Ai ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Departamenti synon në përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen me tregun. Gjithashtu merr në konsideratë edhe propozimet apo sugjerimet e profesionistëve të shquar të fushës.</p> <p>Nisur nga këto synime FAS dhe konkretisht DRRFTV kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione si: Këshilli i Qarkut Tiranë, Radio Televizioni Shqiptar, Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, Universiteti i Tiranës, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës; Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër etj. Qendra Kombëtare e Filmit. Këto marrëveshje janë arritur veçanërisht pas publikimit të "Paktit për Universitetin" dhjetor 2018. I pare me imtesi ky document permban vetëm marreveshje qofte te UART apo edhe FAS, por asgje të konkretizuar.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.29_Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brënda dhe jashtë vendit.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pas njohjes me dokumentacionin arrin në përfundimin se DRRFTV ka bërë një punë të mirë për hartimin e programit të studimit Bsc në "Regji Filmi e Televizioni". Ky program i përgjigjet mirë kërkesave të tregut për specialistë të fushës së regjisurës së Filmit e Televizionit. Ky Departament është përpjekur që të reflektojë kërkesat e institucioneve për këta specialistë. GVJ konstaton se pyetësorët janë të përgjithshëm dhe nuk janë të përshtatur për programin Bsc në "Regji Filmi e Televizioni", gjë që kufizon ndikimin e tyre në rishikimin konkret të programeve dhe përmbajtjes së syllabuseve. Nuk reflektohet qartë bashkëpunimi me Alumni. Ai ka marrë në konsideratë kërkesat e institucioneve për specialistë të profilit Regji në Film e Televizion, por këtu duhej të ishte bërë më shumë në lidhje me kontaktet me palët e treta. Gjithsesi edhe ato kërkesa që kanë qenë janë pasqyruar në përmbajtjen e programeve lëndore. Ka një përpjekje për të përditësuar programet e literaturën me qëllim që studentët e programit Bsc në "Regji Filmi & Televizioni" të përballojnë me sukses sfidat e tregut të punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për të patur një mësimdhënie efektive sigurisht që duhet të përdoren metoda e mjete efektive. GVJ gjatë njohjes me RVB dhe vizitës në DRRFTV konstatoi se në këtë departament nga pedagogët ka përpjekje të vazhdueshme për të rritur cilësinë dhe për këtë përdorin metoda e mjete të ndryshme. Këto forma janë nga leksioni, seminarët, detyra kursi, praktikat në institucione, orët e hapura dhe sidomos pjesëmarrje në projekte artistike. Në mënyrë të veçantë tek lëndët e grupit B apo speciale që ata i quajnë, pedagogu përfshihej jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht. Në këto forma interactive ata përfshinin edhe studentët. Pedagogët në këtë rast janë partnerë me studentët. Projektet artistike janë metoda më e pranishme në mësimnxënie në këtë departament. Projektet shihen si forma për zhvillimin e aftësive qoftë akademike dhe aplikative. Projektet shihen si forma për zhvillimin e aftësive qoftë akademike dhe aplikative. Studentët shfaqin në këto projekte formimin akademik dhe aftësinë e kompetencave. Është gjithashtu një formë që prezantohet hapur e vlerësohet nga të gjithë. Aty zhvillohet mendimi krijues e kritik i studentëve. Nëpërmjet kësaj forme, projektit dhe formave të tjera të hapura, studentët shohin dhe vlerësojnë veten dhe kolegët.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca, 1.4 "VKMNr. 145. datë 1003.2021, "Për dhënien e Statusit të vecantë UART"</i> <i>Evidenca 1. 18 Rregullorja e Programit Studimi/ Regji filmi dhe tv</i> <i>Evidenca 1. 15 Rregullorja e ciklit I-rë të studimit</i> <i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit Studimit Bachelor në Regji filmi dhe tv</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Një mësimdhënie mësimnxënie quhet e suksesshme kur ka një bashkëpunim pedagog-student dhe student është pjesëmarrës aktiv në orën e mësimin. Në këtë kontekst pedagogët duhet të përgjigjen për çdo kërkesë të studentëve. Ata duhet të jenë të hapur ndaj kërkesave të tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për metodat e strategjitë e mësimdhënies.</p> <p>Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe bisedës në DRRFTV, GVJ konstaton se, pedagogët e këtij departamenti bëjnë përpjekje serioze për të rritur nivelin e mësimdhënies. Gjithashtu mësojmë se pedagogët respektojnë dhe ju përgjigjen kërkesave të studentëve, në mënyrë të veçantë me metodat e reja të mësimdhënies, që në fund të</p>

Leoni

[Signature]

	<p>kenë arritur cilësi dhe nivel të lartë në realizimin e objektivave. Nga ana tjetër vetë stafi akademik merr pjesë në trajnime për të përditësuar metodat e reja të mësimdhënies. Për të pasur orë të suksesshme në mësimdhënie pedagogët ftojnë personalitete të fushave të ndryshme të cilët ndajnë eksperiencën dhe ofrojnë modele të sukseshme të tyre. Pjesë e Strategjisë së mësimdhënies është edhe vendosja e marrëdhënieve të ngushta ndërmjet mësimdhënies, studimit, zhvillimit dhe kërkimit artistiko-shkencor; zhvillimi tek studentët i frymës etike edukative dhe profesionale. Përfshirja në projekte është objektiv që po realizohet gjithnjë e më shumë në këtë departament. Këto projekte mundësojnë që ata të tregojnë formimin e tyre akademik, por edhe aftësitë praktike, aftësimin me kompetenca të tyre. Studentët motivohen të marrin pjesë në projekte artistike, madje së bashku me pedagogët e tyre të FAS, në aktivitete si: fjala artistike, variete, koncerte etj. Pikërisht kjo pjesëmarrje nxjerr në pah nivelin e formimit të tyre. Çdo pjesëmarrje është një punë konkrete një formësim dhe materializim konkret i dijeve dhe njohurive. Pjesëmarrja në projekte është motivim për studentët, të cilët shohin dhe vlerësojnë vehten deri ku kanë arritur.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 1.5 Statuti i UART urdher ministri nr.319 per miratimin e statutit të UART dhe statuti.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 1.15 Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1 Takimi me figura të skenës dhe ish pedagogë dhe Alumni.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 2.10 Dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve të FAS, studentëve aktuale dhe ish studentëve.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe biseda në DRRFTV mësuam se pedagogët e Programit Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”, bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të rritur cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet përmirësimit të aftësive dhe kompetencave didaktike. Gjatë viteve, përveç titujve dhe gradave që kanë marrë, janë përfshirë edhe në kualifikime të ndryshme, apo në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. Personeli akademik priret që krahas metodave tradicionale të mësimdhënies të përdorë edhe merodat bashkëkohore në fushën e edukimit të artit dhe regjisë. Në këtë proces ata kanë gjetur mbështetjen e institucionit, i cili gjithashtu është i interesuar për të rritur cilësinë pedagogjike dhe didaktike të personelit akademik.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 1.5 Statuti i UART neni 68</i></p> <p><i>Evidenca 3.2 Aktivitete te Erasmus/Erasmus+ 2022 2024</i></p>




	<p><i>Evidenca 3.3 Aktivitete të workshopeve/masterklasave 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 3.4 Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencor të stafit RRFTV"</i></p> <p><i>Evidenca 3.5 e studentëve aktualë të doktoraturës nga stgfi RRFTV</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UART ku bën pjesë edhe FAS e DRRFTV ka një histori të gjatë të krijimit të tij. Në këtë kontekst ai ka formuar një traditë të pasur në shumë fusha, midis të cilave përmendim edhe atë të mësimdhënies. Pedagogët në breza kanë krijuar trashëgiminë e tyre, të cilën brezat më të rinj e kanë pasuruar më tej. GVJ duke konsultuar RVB dhe takimi në DRRFTV arriti në përfundimin se, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”, është i kualifikuar dhe kompetent në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>Vlerësuam gjithashtu se përdornin metoda bashkëkohore interactive gjatë mësimdhënies për të rritur cilësinë e saj. Qëllimi i përdorimit të këtyre metodave është që, të përfshijnë studentët gjatë procesit të mësimdhënies, pra ai të jetë aktiv. Njëkohësisht synojnë që të përdorin me efektivitet të menduarin Kritik nëpërmjet Leximit dhe shkrimit si një mundësi për kreativitet. Vlerësojmë faktin se një pjesë e konsiderueshme e pedagogëve kishin tituj dhe grada. Ata gjithashtu bëjnë përpjekje për të rritur nivelin e mësimdhënies duke u përditësuar me të rejat në fushën e metodologjisë. Pozitiv është edhe fakti se me personelin e brendshëm ata mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të orëve mësimore të programit. Në këtë program që është i DRRFTV rreth 70% e personelit është me kohë të plotë që mbulon 88% të ngarkesës mësimore në auditor.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 3.4 Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencore të stafit RRFTV.pdf</i> <i>Evidenca 3.6.Lista e realizimeve artistike të stafit RRFTV 2022-2024.pdf f.59-77</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i RRFTV kur ka propozuar hapjen e programit të Studimit Bsc në “Regji Filmi e Televizioni”, ka pasur parasysh faktin se ajo ka kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për këtë program. Nga RVB, dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi në departament konstatoam se njësia bazë nuk është mjaftuar me ato kapacitete që ka pasur në fillim, përkundrazi. Në vazhdimësi kjo strukturë ka vlerësuar procesin e mësimdhënies dhe ka bërë vazhdimisht përpjekje për të mbështetur stafin në përpjekjet e tyre për të përmirësuar vazhdimisht metodat e mësimdhënies. Ata gjithmonë marrin parasysh edhe kërkesat e studentëve e pedagogëve. Departamenti i RRFTV i cili përgjigjet për cilësinë e programit në të gjitha aspektet i kushton vëmendje vazhdimisht rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Ata vlerësojnë procesin e mësimdhënies, metodat e përdorura, vlerësimin e vazhdueshëm, përfshirjen e studentëve në</p>




	<p>leksion apo seminare. Gjatë tërë procesit mësimor stafi pedagogjik asistohet nga stafi ndihmës mbështetës në mënyra e forma të ndryshme, nga të cilat mund të përmendim, regjistrimet e veprimtarive, përgatitja e skenave, pjesëmarrja në paraqitjen e diplomave kur janë paraqitjet skenike, mbajtja mirë dhe kujdesja për teknikën, laboratorët etj etj. Të gjitha këto problematika janë pjesë e diskutimeve dhe zgjidhjeve në Departament.</p> <p>Materiali dokumentar paraqit vetem objektivat atë që është bërë. Jo analiza të mirëfillta departamenti apo dekanati lidhur me problematikat e dala gjatë viteve akademike.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca, 1.25, Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ gjatë njohjes me dokumentacionin arrin në përfundimin se DRRFTV ka qenë tejet i angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, duke e vlerësuar si elementin kryesor të rritjes së cilësisë.</p> <p>Kjo kërkesë nuk mbetet thjesht dëshirë, por institucioni ka ngritur struktura për këtë element. Këto struktura e shikojnë mësimdhënies si proces dhe për këtë arsye ndjekja e saj është në vazhdimësi.</p> <p>Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies ka qenë pikësynimi në departament si njësi bazë dhe gjithë strukturat e tjera.</p> <p>Në këtë aspekt kjo njësi mbështetet nga strukturat e Universitetit si Sektori Mësimor, i Kurrikulës, Këshillimi i Karrierës, Alumni, Sekretariatë etj.</p> <p>Për ta kryer sa më mirë këtë veprimtari institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik. Këto politika dhe inisiativa konsistojnë në mbështetjen e personelit akademik. Në bazë të saj e, sidomos të mobiliteteve, personeli akademik fiton eksperiencën të reja për të përmirësuar mësimdhënien në aspektin metodologjik.</p> <p>Një ndihmesë të madhe në këtë drejtim ju jep edhe organizimi i veprimtarive të përbashkëta me studentët, të cilat ju ndihmojnë për të përmirësuar metodologjinë, pasi i shohin direkt në skenë, apo për skenën. Në veprimtarinë e tij DRRFTV nuk vepron vetë, përkundrazi ai bashkëpunon me departamente të tjera brënda FAS e më gjerë. Ky bashkëpunim shërben për të ndarë eksperiencën në aspektin metodologjik.</p> <p>Personeli akademik për të rritur kualifikimin dhe performancën e tij është pjesë e projekteve artistike e kërkimit shkencor etj.</p> <p>Bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Sociale është një tjetër mundësi për trajnime në drejtim të përmirësimit të eksperiencës didaktike. Këto i vërejtëm në raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe nga biseda me kolegët e DRRFTV.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca, 1.5 Statuti i UART urdhër ministri nr.319 për miratimin e</i></p>




	<p>statutit të UART dhe statuti.pdf.</p> <p>Evidenca, 3.2 Aktivitete të Erasmus, Erasmus+.pdf.</p> <p>Evidenca, 3.8 Pjesëmarrja e as. lektorëve FAS në trajnime pedagogjike.pdf.</p> <p>Evidenca, 3.5 Dosja Studentëve aktualë të Doktoraturës nga stafi RRFVT.pdf.</p> <p>Evidenca, 3. 7Të dhëna nga pyetësoret e studentëve në FAS.pdf.</p>			
Konkluzione	<p>GVJ në përfundim të vlerësimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm konstaton se FAS dhe DRRFTV bëjnë një punë serioze për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në këtë objektiv njësia kryesore ka ngritur struktura ndihmëse, të cilat ndihmojnë procesin. Përmirësimin e mësimdhënies e kanë parë të lidhur ngushtë me rritjen e cilësisë së përgatitjes së studentëve. Studentët me mendimet dhe sugjerimet e tyre bëhen pjesë e procesit. Për këtë arsye, njësia bazë dhe ajo kryesore bëjnë përpjekje dhe ndihmojnë në trainimin e pedagogëve. Pedagogët inkurajohen dhe ndihmohen që të jenë pjesë e projekteve. Ata gjithashtu përfshihen në punë kërkimore. Marrëdhëniet me fakultetin e Shkencave Sociale ndihmojnë në përmirësimin e performancës didaktikë pedagogëve. Marrëdhëniet midis studentëve dhe pedagogëve janë tejet të mira kjo edhe për vetë natyrën e profilit të Programit të studimit. Respekti është baza mbi të cilën ngrihen marrëdhënie pedagog -student.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në programin Bsc në “Regji Filmi &Televizioni”, është paksa i veçantë në raport me programet e tjera. Nga RVB dhe takimi me pedagogët e DRRFTV mësuam se një nga momentet e rëndësishme në mësimdhënie është edhe procesi i vlerësimit të njohurive të studentëve. Vlerësimi në këtë programi edhe pse ka disa veçori specifike, gjithsesi është brënda kuadrit ligjor dhe rregullores së Institucionit. Vlerësimi bëhet me notë nga 1 tek 10 që është edhe vlerësimi maksimal për njohuritë. Gjithsesi vlerësimi është proces, që do të thotë se ai është pjesë e pa ndarë e mësimdhënies dhe nuk lihet vetëm në testimin përfundimtar. Vlerësimi në këtë departament është i vazhduar. Vlerësimi bëhet në seminare, detyra, projekte. Ky vlerësim synon në radhë të parë të nxitë studentët të mësojnë në mënyrë sistematike. Vlerësimi i vazhduar i jep mundësi pedagogut të jetë objektiv dhe transparent në vlerësim. Në këtë</p>

	<p>departament që në fillim bashkë me njohjen e programit të lëndëve bëhet present edhe mënyra e testimit e kontrollit të dijeve. Studentët njihen edhe me rregulloren e provimit dhe vlerësimit të njohurive. Gjithsesi, provimi i fundit është momenti përmbyllësi lëndës. Provimi në FAS zhvillohet sipas këtij programi: provimi i lëndëve speciale, projekt artistik; provim me shkrim e gojë apo vetëm me shkrim për një grup lëndësh të caktuara, dhe provimi në grup sidomos për vlerësimin e veprave të ndryshme artistike, regjia e tyre, cilësia regjizoriale. Format e vlerësimit që përfshijnë edhe pjesëmarrje në leksione e seminare janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve. Kjo e bën edhe më transparent procesin.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f.18 – 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji filmi dhe tv.pdf</i> <i>Evidencë 2.2 kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni 2024 - 2025 - LËNDË KARAKTERIZUESE.pdf (për të gjitha grupet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ pas njohjes me raportin dhe vizitës në departament vlerëson faktin se studenti njihet që në fillim me disa specifika të vlerësimit të njohurive. Duke pasur parasysh specifikat e vetë programit të studimit, në çdo program lëndor sqarohet mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Që në çdo fillim viti apo semestri pedagogët informojnë mbi programet lëndore, përmbajtjen e tyre, literaturën, kreditet, orët që zhvillohen, raporti lek/sem etj. Njëkohësisht paraqiten kompetencat akademike dhe praktike që fiton studenti.</p> <p>Krahas kësaj ata ju tregojnë edhe për mënyrën e vlerësimit dhe testimeve të ndryshme që bëjnë gjatë vitit. Në të gjitha programet lëndore (syllabuset) krahas temave, leksioneve, seminareve, literaturës, përcaktohen edhe mënyrat e vlerësimit e testimit, detyrat e kursit, diplomimi etj. Gjithashtu tregohem edhe kushtet për të marrë pjesë në vlerësimin e secilit element. Studentëve ju shpjegohet rëndësia e pjesëmarrjes në leksione e seminare si dhe aktivizimi në to apo aktivitete të tjera, projekte artistike për të fituar njohuri dhe vlerësim. Të gjitha këto janë pjesë e procesit të mësimdhënies si dhe procesit të vlerësimit. Edhe format e modelet e testimeve shpjegohen nga ana e pedagogëve.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.15.rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i> <i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i> <i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 - 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji filmi dhe tv.pdf</i> <i>Evidencë 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji</i></p>




	<i>Filmi e Televizioni 2024-2025 Lëndë Karakterizuese pdf. (për të gjitha grupet e lëndëve)</i>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me pedagogët e DRRFTV, GVJ mësoi për mënyrat e vlerësimit të njohurive akademike dhe aftësive apo kompetencave profesionale. Procesi i vlerësimit të njohurive është po aq i ndryshëm sa edhe procesi i mësimdhënies. Pikërisht për t’iu dhënë mundësi studentëve të shpalosin dijet dhe njohuritë e tyre pedagogët përdorin forma të larmishme. Ajo që spikat në vlerësim është fakti se përdoren më së shumti forma ku ndërthuren njohuritë teorike me ato praktike. Gjithçka materializohet në praktikë, në emisione apo veprimtari të ndryshme. Njohuritë teorike testohen me shkrim e gojë. Por, për vetë specifikat e programit testimi për kompetencat praktike të fituara vlerësohen kryesisht në detyra projekte, me pjesëmarrje në programe të ndryshme. Pedagogët gjejnë mënyra për t’i kombinuar ato.</p> <p>Në fund ky testim duhet jo vetëm për të matur dijet dhe aftësitë, por edhe për të mësuar nga gabimet dhe pedagogët të dinë çfarë të rregullojnë më pas. Zakonisht testimet bëhen me gojë, shkrim të kombinuara dhe performim në aktivitete artistike si dhe me detyra kursi në lëndë të ndryshme. Projektet janë detyra që po aplikohen shumë, sidomos në aktivitete artistike. Pedagogët ishin të interesuar për gjetjen e sa më shumë formave të testimit me qëllim që studentët të kishin mundësi të demonstrosin dijet dhe aftësitë praktike.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.15. rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i> <i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i> <i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 – 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji filmi dhe tv.pdf</i> <i>Evidencë 2.2 Evidencë 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni 2024-2025 Lëndë Karakterizuese pdf. (për të gjitha grupet e lëndëve (për të gjitha grupet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ pas vlerësimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, konstatoi se, përmirësimi i metodave të mësimdhënies është një nga prioritetet e DRRFTV. Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies ndikon në cilësinë e mësimnxënies.</p> <p>Në RVB dhe nga takimi me anëtarët e Departamentit të Regjisë, regjisë së Filmit e Televizionit, mësuam gjithashtu se struktura që monitoron cilësinë e mësimdhënies në UART është njësia bazë. Departamenti ndjek në çdo hap problemet që lidhen me mësimdhënien, frekuentimin, cilësinë dhe çdo element tjetër që lidhet me procesin mësimor. Departamenti problemin e mësimdhënies e ndjek në çdo hap të veprimtarisë së tij. Duke bashkëpunuar me zyrën e cilësisë, bashkërendojnë veprimtaritë në këtë drejtim. Është në planin e</p>




	<p>punë së departamentit që, në çdo fund viti akademik apo fillim të vitit të ri akademik, bëhet analiza e punës mësimore. Çdo pedagog raporton për punën e bërë, qoftë në atë mësimore, shkencore e problemet e dala. Gjatë diskutimeve jepen mendime lidhur me përmirësimin e punës apo zgjidhjen e problemeve të dala. Vëmendja gjatë diskutimit i kushtohet veçanërisht përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, përmbajtjes së programeve, përditësimit të tyre, me qëllim rritjes së cilësisë së formimit të studentëve. Diploma e tyre ata kërkojnë që të jenë konkurrese.</p> <p>Gjithashtu pedagogët marrin në shqyrtim edhe problemet e dala nga anketimet e studentëve të programit të Regjisë së Filmit e Televizionit. Këto anketime bëhen nga sekretaria për probleme të ndryshme që lidhen me mësimdhënien, kontrollin e njohurive, detyrat, leksionet, diplomat etj., të gjitha problemet e dala në anketime reflektohen në zgjidhje për vitin pasardhës. Në bashkëpunim me stafin mbështetës përpiqen të përmirësojnë shërbimet në cilësinë e projekteve artistike, detyrave të kursit, diplomave etj. Ata janë të angazhuar t'i ndihmojnë personelin akademik dhe studentët në çdo drejtim.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 1.25_ Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite.pdf.</i> <i>Evidenca 3.7 Të dhëna nga pyetësoret e studentëve në FAS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>RVB dhe biseda me pedagogët e DRRFTV na bindën që institucioni ka bërë përpjekje për krijimin e hapësirave dhe mundësive për përdorimin e metodave të shumta e të përshtatshme për realizimin e objektivave.</p> <p>Institucioni ka status të veçantë për vetë përmbajtjen e programeve. Në këtë kontekst, trupa akademike duhet të mundësojnë gjetjen dhe përdorimin e metodave sa më bashkëkohore për mësimdhënien. Në aspektin metodik ata duhet të jenë fleksibël në përzgjedhjen e tyre. Nëpërmjet trajnimeve, veçanërisht me programet Erasmus dhe Erasmus+, pedagogët marrin njohuri dhe aftësohen me kompetenca të reja në mësimdhënie. Edhe shkëmbimet e përvojave me institucione të tjera të ngjajshëm, brenda apo jashtë vendit krijon mundësi në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të metodologjive të shumëllojshme të mësimdhënies. Një gjë e tillë sjell një qasje të re me studentët dhe krijon mundësi të reja marrëdhënieje, bashkëpunimi, duke gjetur tek ata mbështetje dhe respekt të ndërsjellë. Kjo mundësi dhe qasje e re në metodat e mësimdhënies gjen zbatim që në dhënien e leksioneve, me një komunikim të ri, duke e bërë studentin aktivë edhe në këtë fazë, apo demonstrimin e shembujve praktikë gjatë leksioneve etj. Pra, student nuk është pasiv gjatë leksioneve, përkundrazi. E rëndësishme ka qenë gjithashtu edhe rishikimi i leksioneve në të cilat janë futur autorë klasikë dhe trajtime konceptuale të problemeve. Në përfundim përdorimi i metodave të shumëllojshme e ve studentin në qendër të</p>




	<p>procesit dhe e bën atë të aftë për tregun e punës, në Shqipëri e kudo tjetër.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 3.4 Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencore të stafit RRFTV.pdf.</i> <i>Evidenca 3.8 Pjesëmarrja e as. lektorëve FAS në trajnime pedagogjike.pdf.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Pasi ka studiuar të gjithë raportin për standartin III.2 GVJ ka arritur në përfundimin se Institucioni vazhdimisht ka bërë përpjekje rritjen e cilësisë së Programit të Studimit. Vëmendje i ka kushtuar përmirësimit të metodave të mësimdhënies, madje e ka pasur prioritetet këtë. UART duke pasur status të veçantë krijon hapësira për fleksibilitet në përdorimin e metodave të mësimdhënies. Nga personeli akademik testimi dhe vlerësimi i njohurive konsiderohet si proces, që do të thotë se ai është i vazhdueshëm.</i></p> <p><i>Mësimdhënia cilësore mundëson krijimin e standarteve sa më të mira për të vlerësuar studentët. Vlerësimi me tërë komponentët e tij, ka në fokus pikërisht faktin që studentit të japë më të mirën, të nxjerrë në pah qoftë kompetencat akademike, por edhe ato praktike. Format e kontrollit të njohurive janë nga më të ndryshmet, që nga testimet me shkrim, me gojë, projektet etj. Ato në përmbajtjen e tyre janë gjithëpërfshirëse.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ arriti në përfundimin se stafi akademik i DRRFTV ishte i qartë për procesin e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Vlerësimi i studentëve shihet si proces dhe në këtë kontekst ai është pjesë e pandarë e procesit mësimor në auditor e jashtë tij. Ai zhvillohet në çdo orë mësimi, leksion, seminar, detyre, veprimtari praktike etj. Të gjithë komponentët e orës së mësimit dhe lëndës në përgjithësi janë pjesë e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është pjesë e programit lëndor. Me këtë procedurë student njohet që në fillim të lëndës nga titullari i saj. Elementët e vlerësimit të njohurive kanë një raport të caktuar.</p> <p>Konkretisht: Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10%; Puna e pavarur krijuese: 20%; Detyrat e kursit: 20% Projektet e kursit: 20% Provimi përfundimtar: 30%. Kjo ndarje i jep rëndësi dhe peshë thujtase</p>


	<p>çdo pjese të procesit.</p> <p>Provimet që janë edhe vlerësimi përfundimtar i lëndës zhvillohen në sezonin e dimrit, të verës, vjeshtës dhe një sezon veçantë për provimet e mbartura. Studenti në provim hyn pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet, të cilat ai i di që në fillim të vitit akademik.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca: 1.15.rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 - 20.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji filmi dhe tv.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 2.2 kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni 2024 - 2025 - LËNDË KARAKTERIZUESE.pdf. (për të gjitha grupet e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Dixhitalizimi i procesit të vlerësimit të studentëve ka avantazhe, por gjatë bisedës me pedagogët e DRRFTV,(për programin Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”) dhe nga RVB mësuam se në këtë program, për vetë natyrën specifike të tij dhe gjithë programeve në FAS/UART, përdorimi i sistemit elektronik në të gjitha lëndët është pak i vështirë.</p> <p>Lëndët e specialiteteve përgjithësisht janë me aktivitete apo projekte që zhvillohen në një mjedis të hapur e në bashkëpunim. Janë disa lëndë që kërkojnë organizimin e filmave apo shfaqjeve të ndryshme ku duket puna e regjizorit, përgatitja e tij, studentit. Kjo është e dukshme në projekte të kësaj natyre. Sigurisht lëndët me karakter teorik zhvillohen me shkrim, të sekretuar nga sekretaria për të shmangur çdo dyshim dhe për të qenë sa më transparentë me studentët.</p> <p>Gjatë pandemisë së Corona Virusit funksionoi sistemi Microsoft Teams, i zbatuar dhe administruar nga Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit në UART. Stafit akademik dhe studentët u ndergjëgjësuan për situatën dhe bashkëpunimi i tyre ishte mjaft premtues. E veçanta e kësaj forme të mësimdhënies ishte fakti se jo vetëm për mësimin, por edhe për provimin studentët u përfshinë lehtësisht duke bashkëpunuar me njëri tjetrin nën drejtimin e stafit akademik i dhanë ato me sukses. Ajo që të bie në sy lidhet me faktin se personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për të gjetur forma të larmishme për të testuar studentët në provime. Kryesorja është të vlerësojnë mirë njohuritë dhe aftësitë e të jenë sa më transparentë me studentët.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 – 20.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni pdf</i></p> <p><i>Evidenca 3.9_Manuali i Programit Online Microsoft Teams.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 3.10_Manuali i mësimdhënies.pdf.</i></p>




<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në RVB përcaktohej qartë se në përfundim të ciklit Bachelor, vlerësimi përfundimtar është ai që tregon formimin e studentit me kompetenca akademike dhe praktike.</p> <p>Vizita në DRRFTV dhe biseda më stafin akademik na tregoi se vlerësimi përfundimtar bëhej konform rregullave të përcaktuara në rregulloren e provimeve dhe të paraqitura në programet lëndore.</p> <p>Studentët njiheshin që në fillim të semestrit me mënyrën e vlerësimit përfundimtar të lëndës, bazën ligjore për të. UART dhe FAS kishin rregullore për provimet e në veçanti provimin përfundimtar. Pedagogu në vlerësimin përfundimtar kishte në konsideratë frekuentimin, detyrat, pjesëmarrjen në seminare dhe në fund provimin përfundimtar të lëndës. Të gjitha këto ishin të përfshira në rregulloren e provimeve. Provimi bëhet me shkrim, gojë apo dhe projekt apo paraqitje të një performance të një shfaqje apo veprimtarie tjetër skenike. Provimi përfundimtar i lëndës zë 30% të vlerësimit të përgjithshëm.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca: 1.15.rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 – 20.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 2.2 kurríkula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni 2024 - 2025 - LËNDË KARAKTERIZUESE.pdf (për të gjitha grupet e lëndëve)</i></p> <p><i>Evidenca 3.11 Pasqyrat e ngarkesave.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ nga biseda në DRRFTV dhe njohja me RVB arrin në përfundimin se stafi akademik i këtij departamenti e vlerësojnë procesin e vlerësimit të njohurive të studentëve. Në FAS për vetë specifikën e përmbajtjes së formimit të studentëve, më së shumti zenë vend elementet e formimit të aftësive dhe kompetencave praktike të studentëve. Nisur nga kjo është e domosdoshme që gjatë vlerësimit të njohurive në provime, seminare, detyra a projekte vlerësimi të shoqërohet me feedback. Nga sa pamë në RVB dhe vizita në DRRFTV ky element përdorej nga pedagogët në provime dhe gjatë vlerësimit të vazhduar. Bërja e komenteve të cilat shoqërohen sigurisht me feedback është mjaft i domosdoshëm pasi evidenton mangësitë, por njëkohësisht motivon studentët për të punuar më shumë.</p> <p>Në fund të çdo sezoni provimesh, departamenti bën analiza për problematika që mund të jenë konstatuar nëpër provime. Gjithashtu në këto analiza shtrohen detyra për provimet e radhës duke i lidhur me procesin e të nxënimit. Këto analiza shërbejnë për të rritur cilësinë e provimeve dhe sigurisht procesin e të nxënimit.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca: 1.15.rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.pdf.</i></p>




	<p><i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 - 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi e Televizioni pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ pasi njihet me dokumentacionin në tërësi dhe bisedën me stafin akademik, arrin në përfundimin se, stafi akademik i DRRFTV që jep mësim tek programi i studimit Bsc në “Regji Filmi e Televizioni”, është i angazhuar për të mos lejuar kopjimin nëpër provime, apo plagjiatura në detyra a punime diploma. Ky veprim më së pari lidhet me faktin se, Departamenti është mjaft i angazhuar në këtë drejtim. Jo vetëm duke dhënë porosi, por më së pari duke e quajtur detyrim të pedagogëve për të mos lejuar kopje. Nga ama tjetër edhe vetë Programi i Studimit duke qenë se ka veçori specifike të cilat në një masë të konsiderueshme e shmangin, pra nuk lejojnë kopjen apo plagjiaturën. Në se ka program ku pedagogët kanë lidhje me studentët është pikërisht UART, në këtë kontekst komunikimi është i pranishëm. Gjatë këtij komunikimi bëhet vlerësimi në çdo detyrë apo paraqitje. Ky komunikim shmang në një farë mënyre kopjen apo plagjiaturën. Veç kësaj edhe pse ka veçori specifike ky institucion, përsëri provimet kryhen brënda rregullave të përcaktuara në rregullore, të cilat janë të njohura nga pedagogët e studentët. Një nga rregullat e pa negociushme është mbajtja e celularëve apo mjeteve të tjera elektronike. Një tjetër kërkesë e rregullores është edhe mos lejimi i të huajve në sallën e provimit. Personeli administrativ mund të hyjë në sallë për probleme të organizimit. Gjithashtu në provim mund të hynë persona të autorizuar nga Dekani apo të tjerë për të vëzhguar procesin. Në rastet e provimeve për lëndë specifike me leje të dekanit, provimi kryhet në mjedise të hapura. Kjo mënrë shmang edhe më shumë kopjen apo plagjiaturën. Në përfundim mund të pohojmë se njësitë përgjegjëse përdor të gjitha mundësitë për të penguar kopjen apo plagjiaturën.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.15.rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni pdf.</i> <i>Evidenca 3.12 Rregullore e Këshillit të Etikës - VSA 23 DT. 06.03. 2020.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ duke u njohur me RVB arrin në përfundimin se, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të programit Bsc në “Regji Filmi e Televizioni”, janë të bazuara mbi meritën dhe kontrollin rigoroz të studentëve. Në këtë drejtim vlen të përmendet edhe fakti se rezultatet hidhen në sistem pasi janë ballafaquar me studentët. Në Universitetin e Arteve, nga data 30 shtator 2021, përdoret sistemi PITAGORA. Sistemi është mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) dhe administrohet nga Sektori i IT në bashkëpunim me RASH, si edhe në koordinim me Sekretariatë</p>




	<p>Mësimore në Fakultete dhe strukturat përkatëse në Rektorat. Ky sistem plotësohet me të dhëna nga sekretaritetë mesimore dhe kryen funksione administrative. Pedagogët këtu hedhin notat e më pas printojnë process-verbalet dhe pasi i firmosin i depozitojnë në sekretari. Pra vlerësimet ruhen elektronikisht por edhe manualisht. Gjithashtu sistemi perdoret edhe nga studentët të cilët marrin informacionet e duhura, sidomos për provimet e sezoneve. Edhe administrata e rektoratit e përdor për të marrë informacionet e duhura dhe përpunime statistikore.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca: 1.15.rregullore mësimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 – 20.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi e Televizioni pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 3.13_ Screenshot nga Sistemi Pitagora.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ Nga biseda në DRRFTV dhe njohja me RVB konstaton se, institucioni vlerëson të drejtat e studentëve, dhe sidomos të drejtën për t'u informuar për vlerësimin si dhe të drejtën e ankimit për vlerësimin institucion kishte rregullore të qarta mbi të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimet dhe të drejtën e rivlerësimit të provimeve. Përgjigja e provimit duhet të jepet brenda 5 ditëve. Në ndonjë rast me firmë të dekanit mund të shtyhej ky afat. Në se ka ankimim ngrihet Komisioni i ripovimit që është i detyruar të sqarojë studentin për rezultatin e marrë.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidenca: 1.15.rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 - 20.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni pdf.</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga RVB dhe biseda në DRRFTV, GVJ arrin në përfundimin se, në këtë institucion, me rregullore, studenti ka të drejtë të ankimohet jo vetëm për rezultatin, por edhe në se gjatë provimit janë shkelur rregullat e procedurat e zhvillimit të provimit. Ankimimi bëhet pranë zyrës së Dekanit, brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit. Pasi shqyrtohet ankesa bëhet ballafaqimi midis palëve, një nga të cilët është edhe komisioni. Në se nga ballafaqimi zgjidhet problemi jepet përgjigja, në të kundërt ngrihet komision për të vlerësuar rastin. Në se komisioni e vlerëson si të drejtë ankesën i referon dekanit, i cili e shpall të pavlefshëm vlerësimin e parë dhe vendos që student të rijapë provimin me të njëjtin komision ose tjetër.</p>




	<p>Kjo procedurë vlerësohet si mjaft transparente. Data për provimin caktohet jo më shumë se pesë ditë para, nga përfundimi i sezonit. Tek programi Bsc në “Regji Filmi e Televizioni” është rasti i studentes M. D., e cila ka pretenduar përmirësim note në lëndën Skenari. Kërkesa e saj është pranuar nga përgjegjësi i departamentit dhe ka vazhduar procedura. Kjo procedure është parashtruar në RVB dhe na u konfirmua në takimin e GVJ në departament.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.15.rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i> <i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 – 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni pdf.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ pasi u njoh me raportin dhe takimet në departament, arrin në përfundimin se, në departamentin e Regjisë, Regjisë së Filmit e Televizionit, vlerësimi i studentëve është i bazuar në ligj dhe rregullore. Pedagogët udhëhiqen nga filozofia se vlerësimi i studentëve është process që bëhet brënda e jashtë auditorit. Kjo gjë lidhet në radhë të parë me specifikat e Programit të Studimit. Vlerësimi dhe mënyra e tij është pjesë e programit lëndor. Vlerësimi shoqërohet gjithmonë me komente dhe kjo kushtëzohet edhe për veçoritë specifike të programit. Departamenti bën përpjekje që të shmangë gjatë provimeve, detyrave apo projekteve plagjiaturën dhe kopjen. Në këtë program veç aftësimin akademik i kushtohet vëmendje edhe formimit të kompetencave. Procesi i vlerësimit është i vazhduar. Departamenti ngre struktura të veçanta për ta monitoruar. Gjithsesi, pedagogët, procesin e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive si dhe metodologjive të mësimdhënies nuk i shikonin asnjëherë të ndara nga njëra tjetra.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ pasi u njoh me përmbajtjen e RVB dhe të programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Regji Filmi & Televizioni”, konstaton se programi jep njohuri të mjaftueshme akademike akademike dhe praktike studentëve. Në bazë të këtyre njohurive që student merr në nivelin e parë të studimeve Bachelor, u krijon mundësi për të vazhduar më tej. Në këtë cilël studenti merr konceptet bazë të programit, të cilat i japin mundësi të thellojë njohuritë e tij. Njëkohësisht, këto njohuri




	<p>akademike e aftësojnë me kompetenca akademike e praktike në fushën e Regjisë së Filmit e Televizionit. Me këto njohuri dhe kompetenca student del në tregun e punës, por ai futet edhe në kërkimin shkencor. Programi Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”, realizohet me 180 kredite, me zgjatje kohë 3 vjet. Pas përfundimit të studimeve të këtij programi lëshohet diploma “Bachelor”. Më pas, këta studentë të pajisur me këtë diplomë kanë të drejtë të ndjekin studimet master, nivelin e dytë, e më pas edhe doktoraturë, cikli i tretë. Përparësi sigurisht që kanë ato të fushës së regjizurës së filmit dhe televizionit dhe në kërkimet artistiko-shkencore.</p> <p>Ky program studimi synon që studentët të njohin përmbajtjen dhe objektivin bazë të regjisë së filmit e Televizionit. Pra ç’përfaqëson në vetvete regjia e filmit dhe televizionit. Paralel me njohjen është edhe formimi akademik dhe aftësimi me kompetenca i studentëve.</p> <p>Këto janë njohuritë e para dhe të domosdoshme me të cilat ai mund të punësohet si regjizor i filmit dhe televizionit, në spektakle televizive, në emisione të ndryshme televizive apo edhe filmave televizivë. Fusha e punësimit është e gjerë. Këto janë elementet e parë dhe të domosdoshme për punësim e vazhdim më tej. Veç kësaj ky shkollim ju jep mundësinë për trajnime të mëtejshme dhe kërkim të pavarur në fushën e regjisë së filmit & televizionit, për kategori të ndryshme emisionesh. Ky program studimi me njohuritë e dhëna për studentët krijon njëkohësisht bazën e kërkimit shkencor, që fitohet nga detyrat e kursit, punimi i diplomës, projektet etj. Ju krijon njëkohësisht një bazë të qëndrueshme njohurish të cilat mundësojnë thellim të mëtejshëm të tyre. DRRFTV është i angazhuar që ky program studimi ta kryejë misionin e tij me cilësi deri në fund. Studentët me njohuritë dhe aftësitë e tyre të jenë konkurrenca kudo ku paraqitet rasti dhe nevoja.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.15.rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf.</i> <i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 - 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni pdf.</i> <i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni 2024 - 2025 - LËNDE BAZË.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ nga njohja me dokumentacionin arrin në përfundimin se, Programi i Studimit Bsc në “Regji Filmi e Televizioni” në fakt, nuk ka si qëllim zhvillimin e aftësive dixhitale. Por po nga ky dokumentacion (RVB) mësojmë se DRRFTV e vlerëson zhvillimin e aftësive dixhitale. Sidomos sot në kushtet e zhvillimit të inteligjencës artificiale që mund të gjejë përdorim sidomos në regjinë e filmit apo edhe televizionit. IA është sfidë dhe studentët duhet të përgatiten për këtë sfidë.</p> <p>Në këtë kontekst departamenti i Regjisë, Regjisë së Filmit e</p>




	<p>Televizionit, e ka vlerësuar duke e futur në kategorinë e Lëndëve me Zgjedhje. Njohja e teknologjisë ju krijon hapësira për të njohur të rejtat që ofrohen sot në botë, për probleme të regjisë. Specialistët e regjisë së filmit e televizionit kanë nevojë për kulturë të përgjithshme edhe në shkencat humane e sociale. Për këtë arsye këto lëndë gjejnë hapësirë në programin e studimit.</p> <p>Këto lëndë kanë ndikimin e tyre në formimin dhe artikulin e studentëve. Programi bachelor në “Regji Filmi & Televizion”, vlerëson si domosdoshmëri njohjen e një gjuhe të huaj, që ndihmon jo vetëm në njohjen e literaturës së huaj, por i ndihmon edhe në komunikim gjatë lëvizjeve në projekte apo programe të ndryshme. Shoqëria sot është në lëvizje, që do të thotë se formimin dhe artikulin e studentëve, komunikimi është i pashmangshëm. Njohja e gjuhës së huaj është prioritet dhe domosdoshmëri. Departamenti edhe në këtë aspekt ndihmon. Ai e sheh të domosdoshëm në mobilitetet dhe shkëmbimin e studentëve. Këto përfundime dolën pasi GVJ u njoh me RVB dhe gjatë vizitës në departament.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca: 1.15.rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.pdf.</i> <i>Evidenca 1.17 rregullorja e DRRFTV, f. 18 – 20.</i> <i>Evidenca 1.18 rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi e Televizioni pdf.</i> <i>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni 2024 - 2025 - LËNDË BAZË.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me pedagogët e DRRFTV, GVJ arrin në përfundimin se, në çdo program studimi e veçanërisht në ato lëndore (syllabuse) vendosen kompetencat akademike dhe praktike që fiton studenti në përfundim të lëndës, apo programit të studimit.</p> <p>Me objektivat dhe kompetencat që studenti fiton gjatë viteve të studimit njihet në fillim të çdo lënde, nga pedagogu përkatës.</p> <p>Këto ju bëhen me dije që në fillim të prezantimit të syllavbusit studentëve, por edhe gjatë leksionit dhe sidomos në seminare. Pedagogët venë theksin tek çështjet kryesore dhe të rëndësishme të leksionit. Në FAS, për vetë natyrën specifike të organizimit të mësimin në lëndët speciale, mbështetur në VKM Nr. 145, date 10.03.2021 "Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë", studentët këshillohen në përfundim të çdo ore mësimi se ku duhet të përqendrohen me qëllim përmirësimin e punës dhe arritjeve në fushën e Regjisë së Filmit e Televizionit. E rëndësishme është se në përfundim të çdo semestri pedagogët bëjnë analiza për çdo lëndë, duke nxjerrë në pah arritjet dhe mangësitë, më pas në Departament e më pas në Fakultet. Sigurisht kjo është një përvojë e mirë, pasi përfshin në analizë studentë e pedagogë. Pas diskutimeve</p>




	<p>dhe daljes së problemeve orientohen studentët për zbatimin e detyrave që dalin nga diskutimet.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidencë1.4 VKM NR_145 DATE 10_3_2021 Statusi i Veçantë.pdf.</i> <i>Evidencë 1.17 rregullore e veprimtarisë sëpergjithshme e dep. RRFTV.pdf.</i> <i>Evidencë1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi e Televizioni pdf.</i> <i>Evidencë1.15 Rregullore mesimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.pdf.</i> <i>Evidencë1.25 Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuaru kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ pasi njihet me dokumentacionin dhe kryen vizitën në DRRFTV arrin në përfundimin se, tek programi i studimit Bsc në “Regji Filmi&Televizioni”, vihet theksi tek aftësimi me kompetenca akademike e praktike. Kjo ju mundëson atyre të zhvillojnë njohuritë e marra në praktikat profesionale në televizione, qendrën Kombëtare të Kinematografisë apo dhe në institucione të tjera ku kërkohen regjizorë. Aftësimi me kompetenca arrihet duke përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p>Të menduarit kritik dhe krijues duket të jetë pjesë e mësimdhënies. Përmes dijeve akademike pedagogët duhet të synojnë më së shumti tek formimi i kompetencave, pasi ato janë që ndihmojnë në profesion. Pra, dijet akademike duhet me doemos të kthehen në kompetenca akademike dhe praktike. Kjo arrihet duke dhënë leksion me kompetencë dhe i aftë të përgjigjesh çdo kërkesë dhe pyetjeje të studentëve si dhe duke performuar praktikisht. Studentët nga ana tjetër duhet pa tjetër të bëjnë në institucione që njohuritë dhe kompetencat t'i përkthejnë në veprimtari. Në këtë departament për vetë natyrën specifike të programit përdoret puna me grupe, brënda institucionit (FAS) midis studentëve të departamenteve të ndryshme. Studentët këmbëjnë ide dhe përvoja, dhe kjo sigurisht ndikon pozitivisht në aftësimin e tyre. Të mësuarit dhe diskutimi në grup më së shumti ndikon në rritjen e bashkëpunimit të studentëve dhe mundësinë e mobilitetit të tyre, sipas kërkesave. Po kështu zhvillohen aftësitë intelektuale dhe prirjet artistike. Në përfundim mund të pohojmë se stafi akademik i DRRFTV synon të përdori teknika e strategji të ndryshme bashkëkohore për të realizuar të mësuarin me kompetenca, aq të domosdoshme për programin e studimit.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidencë 1.17 Rregullore e veprimtarisë së pergjithshme e dep. RRFTV.pdf.</i> <i>Evidencë 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji Filmi e Televizioni .pdf.</i> <i>Evidencë 1.15 Rregullore mesimore e ciklit të parë të studimeve</i></p>




	<i>Bachelor në UART.pdf</i> <i>Evidencë3.2 aktivitete të Erasmus, Erasmus+.pdf</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë Program Studimi GVJ konstatoi se e veçanta që vërehet është që, personeli akademik efektiv apo me kohë të pjesshme është i angazhuar në mësimdhënie efektive. Ata gjithashtu janë të angazhuar në përhapjen e përvojës së tyre positive me qëllim që të japin më të mirën e tyre. Veç kësaj ata bëjnë edhe orë të hapura vetë apo me të ftuar për të dhënë njohuri mbi zhvillimet e reja në lëndët që mbulojnë. Sipas dokumentacionet del se kjo përvojë nuk jepet vetëm nëpërmjet leksioneve apo seminareve, por edhe nëpërmjet shfaqjeve premiera, bisedave, shfaqje emisionesh etj. E rëndësishme është të ndahen përvoja pozitive dhe arritje të fundit të shkencës e teknologjisë brenda përmbajtjes së programit, por jashtë strukturës së tij. Këto veprimtari të pasura në formë dhe përmbajtje shërbenjnë për studentët në veçanti, por edhe për të gjithë artistët e tjerë për të përfitur nga përvoja dhe arritjet në art, kryesisht në fushën e Regjisë së Filmit e Televizionit. Kjo u konfirmua nga stafi akademik dhe RVB. Dokumentacioni: <i>Evidencë3.3 Aktivitete të ëorkshopeve, masterklasave 2022-2024.pdf</i> <i>Evidencë3.6 Lista e realizimeve artistike të stafit RRFTV 2022-2024.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pasi njihet dhe vlerëson të gjitha kriteret e këtij standardi arrin në përfundimin se institucioni ka bërë të gjitha përpjekjet për të rritur cilësinë e përgatitjes së studentëve. Për këtë arsye ai gjen mundësi të realizojë objektivin e tij. Ai ngre struktura të cilat ndjekin hap pas hapi mësimdhënien duke synuar në thellimin e njohurive. Studentët e ciklit Bachelor të përgatiten me njohuritë bazë, me aftësi e kompetenca akademike e praktike, të gatshëm për tregun e punës, por edhe për të vazhduar më tej ciklet e tjera të studimit. Vëmendje i kushtohet edhe përgatitjes dhe aftësimin dixhital, një kërkesë kjo e kohës, por edhe për vetë programin Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”. Ky institucion bën përpjekje gjithashtu për të promovuar idetë e reja inovative në forma të ndryshme, nga leksionet e haputa deri tek shfaqjet apo aktivitetet artistike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për	GVJ konstatoi se UART/FAS dhe sigurisht edhe DRRFTV, pjesë e të cilit është Programi i Studimit Bsc në “Regji Filmi & Televizioni”,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: ëëë.ascal.al




<p>provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>kanë rregullore të posaçme për ciklin Bachelor. Përmbajtja e provimit të përgjithshëm përfundimtar që është punimi i diplomës, është në përputhje të plotë me statusin që ky institucion ka. Edhe pse nota mesatare për shkak të statusit që ka ky institucion nuk merret në konsideratë, në fakt ka një rregullore, të pashkruar, që studentët më të mirë kanë një lloj zgjedhje disi më “ndryshe” në aspektin e provimit përfundimtar. Atyre u jepet pjesë më e vështirë për regji, apo udhëheqës kanë profesorët më specialist. Talentet dhe studentët cilësorë vlerësohen si dhe ecuria gjatë tre vjetëve e tyre. Studenti futet në provimin përfundimtar kur ka shlyer të gjitha detyrimet. Këto na u konfirmuan nga takimi me pedagogët e DRRFTV.</p> <p>Kjo duhet të përfshihet në rregulloren e diplomimit.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidencë1.4 VKM NR_145 DATE 10_3_2021 Statusi i Veçantë.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë1.15 Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë1.5 statuti i UART urdhër ministri nr.319 për miratimin e Statutit të UART dhe Statuti.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 1.17 rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e dep. RRFTV.pdf</i></p> <p><i>Evidencë1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji Filmi &Televizioni pdf.</i></p> <p><i>Evidencë1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ pas njohjes me dokumentacionin dhe takimi në DRRFTV arrin në përfundimin se, në FAS, në vazhdimësi ndiqen dhe asistohen studentët për probleme të mësimdhënies dhe probleme të tjera gjatë viteve të studimit. Në mënyrë të veçantë asistohen gjatë provimeve, e sidomos në provimet përmbyllëse. Në FAS njëkohësisht funksionon një strukturë e veçantë që asiston studentët për detyrimet përmbyllëse. Rëndësia e kësaj strukture qëndron në faktin se ju jep studentëve mbështetje veçanërisht në përmbyllje të studimeve. ajo asiston studentët për provimet e mbartura që kanë, dhe të gjitha detyrimet e tjera që duhet të shlyejnë deri në mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Zyrat e informacionit dhe asistencës për studentët janë: Sekretaria e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Informimii i studentëve bëhet në radhë të parë në faqen e Eëbb të UART. Edhe pedagogët janë mjaft të gatshëm për të informuar studentët, së pari për programet lëndore, ecurinë vjetore dhe detyrimet përmbyllëse. I rëndësishëm është bashkëpunimi veçanërisht gjatë përgatitjes së diplomës. Ajo mund të jetë ndarë në dy pjesë, në punimin teorik dhe atë artistic, të lidhura ndërmjet tyre. Ata janë të pranishëm në çdo fazë, që nga përcaktimi i temës, hartimi i strukturës, projekti artistic mbështetës, literature etj.</p>

	<p>Gjatë kohës së punimit të diplomës, sigurisht që, takimet dhe orientimet e pedagogëve janë të shpeshta. Në fund është pedagogu udhëheqës ai jep miratimin për mbrojtjen ose jo të diplomës. Studenti hyn në mbrojtje vetëm kur ka shlyer të gjitha detyrimet. Këto janë gjetje në RVB dhe nga takimi me pedagogët e DRRFTV.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidencë 1.17 rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e dep. RRFTV.pdf</i> <i>Evidencë 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi e Televizioni pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në përfundim të njohjes me RVB, GVJ mendon se në FAS provimi final është konceptuar si një testim i njohurive të marra në vite së bashku me një projekt artistik. Provimi final është vlerësimi i përfundimit të studimeve. Provimi përfundimtar administrohet më seriozitetin e duhur, nga strukturat përgjegjëse. Departamenti merret në mënyrë të drejtpërdrejtë me administrimin e tij.</p> <p>Për administrimin e provimit përfundimtar ngrihet një komision i posaçëm, i cili për të administruar provimin mbështetet në një rregullore të posaçme. Rregullorja është e UART dhe FAS. Kjo rregullore është miratuar nga Dekani dhe përmban tërë ecurinë e zhvillimit të provimit, rregullat që duhet të ndiqen. Në këtë provim përmbledhen tërë njohuritë e tri viteve të studimit. Punimi i diplomës është veprimtari e udhëhequr nga pedagogu i caktuar për këtë udhëheqje.</p> <p>Kriteri mbi të cilën përcaktohet përmbajtja e programit të provimit, lidhet me rëndësinë e çdo lëndë për gjatë tre viteve të studimit. Punimi i diplomës përmban kërkesa të cilat studenti duhet t'i zbatojë. Në përfundim të punës për kryerjen e diplomës studenti tregon aftësitë e tij akademike e praktike. E gjithë puna bazohet mbi të menduarin kritik, që do të thotë se brenda ka vlerësimin original për punimin. Kjo rregullore ishte e përfshirë në RVB.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidencë 1.17 rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e dep. RRFTV.pdf</i> <i>Evidencë 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji Filmi e Televizioni pdf.</i> <i>Evidencë 1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin</p>	<p>GVJ konstaton se në RVB punimi i Diplomës vlerësohet si një proces i rëndësishëm, që tregon formimin e studentëve në përfundim të studimeve Bachelor. Për studentët që do të kenë provim teorik dhe artistik ju jepet programi në fund të simestrit të parë në vitin e tretë. Njëkohësisht në fillim të simestrit të dytë fillon edhe puna për përgatitjen e diplomës. Semestri i dytë i vitit të tretë lehtësohet pak</p>




<p>në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>nga ngarkesa e gruplëndëve kryesore. Pas caktimit të udhëheqësit nga Departamenti, menjëherë fillon puna dhe bashkëpunimi me studentin. Pasi bëhet përcaktimi i temës, vazhdon struktura dhe përcaktimi i projektit artistic.</p> <p>Gjatë kësaj kohe ai bën takime periodike me pedagogun, i cili e orienton dhe këshillon për çdo problem të dalë gjatë punës. Udhëzimet për literaturën, mënyrën e të shkruarit janë udhëzime të rëndësishme. Takimet janë të vazhdueshme dhe kjo shpesh herë varet nga talenti dhe puna e studentit. Veç trajtimit teorik edhe ai artistik është pjesë e punimit të diplomës. Sigurisht konsultimet me pedagogun mundësojnë realizimin e punimit. Në përfundim të punimit, pedagogu udhëheqësi shpreh dakortësinë ose jo që tema (projekti artistik dhe teorik) të kalojë para komisionit të mbrojtjes. Kur ka pretendime nga ana e studentëve lidhur me këto probleme ndiqet rruga e ankimeve në instancat dhe kohën e përcaktuar nga FAS. Ndodh gjithashtu që për arsye të ndryshme objective studenti e shtyn mbrojtjen në sezonet e tjera. Kjo bëhet në mirëkuptim me pedagogun udhëheqës. Kjo procedure është pjesë e RVB si dhe rregulloreve të hartuara për këtë stad të studimeve dhe doli nga takimi në DRRFTV.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidencë 1.15 Rregullore mesimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 1.17 rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e dep. RRFTV.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi dhe Televizioni pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani Mësimor për tre vitet e fundit me VSA.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”, ka specifika të veçanta në kontekstin e mbështetjes së studentëve për kryerjen e matjeve apo analizave. Këtu bëhet fjalë për institucione ku studentët mund të asistohen për vëzhgime apo dhe pjesëmarrje në aktivitete apo programe të ndryshme. RVB konfirmon se DRRFTV ndjek dhe asiston të gjithë veprimtarinë e studentëve, gjë që lidhet edhe me burimet financiare që ka në dispozicion. Mbase nuk janë analiza apo matje në kuptimin klasik, por janë vëzhgime, veprimtari në institucione ku ka aktivitete për degën e tyre. Në RVB thuhet se ky institucion përjashtohet nga ky kriter. Në fakt është ndryshe, përjashtohet nga matjet apo analizat në degët shkencore, por jo nga të dhënat apo aktivitete për fushën e tyre të studimit. Ky kriter nuk bën fjalë thjesht për mbështetje analizash apo teste mjedisore. Për institucionin në fjalë flitet apo kërkohet asistencë për veprimtaritë artistike që kryen studenti. Kjo ndodh gjatë punimit të diplomës apo edhe veprimtari të ndryshme të cilat institucioni, FAS she DRRFTV duhet t'i mbështesin. Sipas raportit, DRRFTV i mbështet studentët vetëm për infrastrukturën. Kjo u konfirmua edhe nga pedagogët gjatë</p>




	<p>vizitës në departament. Nga ana tjetër mësojmë që UART veç strukturave të brendshme që janë në funksion të zhvillimit të mësimin, ka bërë përpjekje me partnerë lokalë dhe kombëtarë që për të realizuar programin të verë në funksion të studentëve, salla shfaqjeje, provash, garderobë, audio, teknikën, logjistikën e duhur etj. GVJ vlerëson se e gjithë procedura është një mbështetje shumë e madhe për studentët duke ju krijuar kushte optimale për të mësuar dhe realizuar punët e tyre, diplomën dhe veprimtaritë artistike pa kosto. Këto veprimtari asistohen.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidenca 3.16_Korrespondenca me partnerët në shërbim të shfaqjeve të studentëve RRFTV.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar, apo mbrojtja e Diplomës sic quhet ndryshe, quhet i Dhënja e provimit përfundimtar apo mbrojtja e diplomës, është mbyllja e një procesi tre vjeçar të studimeve. Por procesi i provimit përfundimtar quhet i kryer kur student vlerësohet me notë. Në RVB dhe nga vizita e GVJ njihet me procesin e vlerësimit të studentit në përfundim të mbrojtjes së diplomës. Gjithashtu GVJ arrin në përfundimin se rregullorja është e studiuar dhe paraprin procesin. Para se të fillojë procesi i mbrojtjes së diplomës ngrihet komisioni i mbrojtjes së Diplomës. Pasi është bërë paraqitja e punimit, në përfundim të procesit mblidhet komisioni nga Kryetari i tij. Komisioni ka një numër të caktuar anëtarësh, të cilët pasi njihen me punimin e diplomës, nëpërmjet paraqitjes nga studenti, bëjnë vlerësimin me notë të tij. Më pas bëhet mezatarizimi i notës sipas vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Pasi është vednosur nota, nga Kryetari i komisionit, komunikohet vlerësimi (nota). Vlerësimi i anëtarëve pasqyrohet në Proces-Verbal, i cili i bashkangjitet process-verbalit përfundimtar. Ky dokumentacion dorëzohet në sekretarinë mësimore. Në rast se studenti vlerësohet negativisht apo nuk paraqitet, atëherë ai mund të bëjë mbrojtjen në tre sezonet pasardhëse.</p> <p>Dokumentacioni: <i>Evidencë1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.pdf.</i> <i>Evidencë1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit</p>	<p>Nga njohja me RVB dhe takimi në departament, GVJ arrin në përfundimin se, studenti pajiset me diplomë dhe suplementin pasi ka shlyer të gjitha detyrimet dhe ka mbrojtur provimin përfundimtar. Për marrjen e diplomës studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet që përmban plani mësimor. Diploma plotësohet në zbatim me Udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor". Së bashku me diplomën dhe suplementin studenti merr edhe programet lëndore, programin zyrtar të</p>




të zhvilluar.	<p>studimit të zhvilluar në tri vite.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidencë1.18 Rregullorja e programit të studimit Regji.Filmi dhe Televizioni.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë3.14 Udhëzimi Nr.25-datë-10112017 Regjistrimi i formave te Diplomave.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Pas njohjes me RVB dhe takimin në sekretari, GVJ arrin në përfundimin se Institucioni e vlerëson dokumentacionin si themelor për të treguar ecurinë e tij. Puna dhe ecuria e një institucioni tregohen pikërisht në këtë dokumentacion. Në këtë kontekst dokumentacioni është shumë i rëndësishëm, është vetë ekzistenca e tij përmirësimi në vite i tij. Takimi në departament, dhe sidomos në sekretari dhe zyrën e Arkivit e të Protokollit konfirmuam se këto zyra kishin të arkivuara të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë akademike ndër vite. Ky dokumentacion ruhet elektronikisht dhe i printuar e regjistër.</p> <p>Ky dokumentacion është për të gjithë vitin akademik. Dokumentacioni është i ndryshëm duke filluar nga programet lëndore, planet mësimore, rregulloret e ndryshme të FAS, komunikimi shkresor brenda institucionit. Një pjesë e dokumentacionit ruhet në zyrën e Arkivit, por edhe në sekretarinë mësimore. Pranë sekretarive qëndrojnë deri në tri vjet e më pas përcillen në arkivë, por janë edhe regjistrat e vlerësimeve, pranimeve apo diplomimit që janë të përjetshme. Veç kopjeve fizike edhe ato elektronike ruhet në CD të veçanta. Për këtë proces ka rregullore të veçantë.</p> <p>Dokumentacioni:</p> <p><i>Evidencë1.5 statuti i UART urdhër ministri nr.319 për miratimin e Statutit te UART dhe Statuti.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca 3.15_Pasqyrë për përdorimin e pajisjeve dhe shërbimeve të teknologjisë.pdf.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pasi u njoh me dokumentacionin e Standardit III.5 arrin në përfundimin se Institucioni ndjek me rigorozitet detyrimet përmbyllëse që studenti ka në përfundim të ciklit bachelor. Të gjithë veprimtarinë përmbyllëse e ka të bazuar në rregullore të veçantë, për këtë problem. Rregullorja parashikon qoftë provimin përmbyllës apo edhe punimin e diplomës dhe detyrimet që ka pedagogu për të udhëhequr procesin e punimit të diplomës. Bashkëpunimi student-pedagog është për t'u vlerësuar, kjo edhe për shkak të natyrës së programit. Rregullorja është e qartë dhe tejet transparente. Në përfundim të studimeve student pajiset me diplomë, suplementin dhe dokumentacionin tjetër zyrtar. Dokumentacioni është i ruajtur sipas rregulloreve të Institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Lealaj

[Signature]

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar RVB dhe materialeve në DVV si dhe takimeve me stafin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në Programin e Studimit Bachelor në “Regji filmi & TV”, GVJ konstaton se personeli i angazhuar i përmbahet kërkesave të parashikuara në Ligjin 80/2015, VKM Nr. 29, datë 10.09.2018, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, VKM, Nr. 145, datë 10.03.2021 dhe Kodit Punës. Nisur nga natyra e veçantë e programit të studimit, Departamenti i RRFTV vlerëson eksperiencën artistike shkencore të stafit akademik në përputhje me lëndët për të cilën ata angazhohen. Për vetë specifikën e FAS/UART si institucioni i vetëm arsimor publik në fushën e artit skenik, pjesa dërrmuese e personelit akademik me kohë të plotë dhe një pjesë e mirë e atyre me kontratë janë Alumni të FAS/UART. Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për personelin ndihmës akademik të Departamentit të RRFTV. Stafit akademik PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike është si më poshtë:					
	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE PAK
	Prof. Dr	-	-	-	1	- 1
	Prof. Asoc.	3	-	3	1	3 -
	Dr/Phd	2	2	1	-	1 -
	Dr. proc	2	-	2	-	2 -
	Msc.	5	8	6	5	6 5

	Gjithsej	12	6	12	7	12	6
	<p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.1 "Ligii i Arsimit të Lartë 80/2015 datë 10.9.2018</i></p> <p><i>Evidenca 1.6 "Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018</i></p> <p><i>Evidenca 4. 7. VKM Nr. 329, date 12.04.2017</i></p> <p><i>Evidenca 1.4 "VKM Nr, 145, date 10.03.2021</i></p> <p><i>Evidenca 1.27 "Tabelat e stafit akademik FAS</i></p> <p><i>Evidenca 4.5 "Lista e Stafit ndihmës akademik RRFTV"</i></p> <p><i>RVB tabelat 6.1, 6.2, 6.3 Aneks tabelat përmbledhëse</i></p>						
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në Programin e Studimit Bachelor në Regji filmi &TV mbulon ngarkesën e detyrueshme mësimore në përputhje me VKM Nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar. Gjithashtu, referuar VKM së mësipërme Pika II, Numër 1, stafi akademik në marrëveshje me drejtuesin e RRFTV dhe kur është e nevojshme, me miratimin e Dekanit të FAS, merr përsipër realizimin e orëve suplementare në auditor ose mbikqyrjen e praktikave mësimore/profesionale.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2024-2025 PAE - 87% të ngarkesës, PAK-13% të të ngarkesës</p> <p>Gjatë vitit akademik 2023-2024 PAE - 93% të ngarkesës, PAK -7 % të ngarkesës</p> <p>Gjatë vitit akademik 2022- 2023 PAE - 86 % të ngarkesës, PAK-14% të ngarkesës.</p> <p>Të dhënat tregojnë se stafi akademik me kohë të plotë mbulon pjesën më të madhe të ngarkesës gjë që ndikon në cilësinë e programit.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.6 "Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018</i></p> <p><i>Evidenca 2. 1 "Plani Mësimor Bachelor në Regji Filmi e Televizioni '</i></p> <p><i>Evidenca 3.11 Pasqyrat e Ngarkesave RRFTV 2022 -2024</i></p> <p><i>Evidenca 4.6 "Realizimi i Marrëveshjeve vjetore RRFTV"</i></p> <p><i>Evidenca Aneksi i tabelave 12.1, 12.2, 12.3.</i></p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi , të cilët kanë nënshkruar kontratat me UART, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personeli akademik për programin Bachelor në "Regji filmi &TV" për gjithë periudhën e parashikuar për akreditim (dhe jo vetëm), është i pandryshueshëm. Njëherazi edhe stafi akademik me kohë të pjesshme, nisur nga natyra specifike të këtij programi, përgjithësisht është po ashtu i pandryshueshëm për të gjitha vitet akademike të parashikuara në akreditim. UART paguan rregullisht të</p>						

	<p>giitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të stafit akademik.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.1 "Koha e fillimit të bashkëpunimit me personelin</i></p> <p><i>Evidenca 4.2 "Kontrata e purtes së stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme</i></p> <p><i>Evidenca 4.3 "Listë-pagesat e detyrimeve të stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UART ndjek procedura të hartuara me kujdes për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë. UART shpall thirrje publike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kriteret e angazhimit të stafit akademik me kohë të plotë hartohen nga burimet njerëzore dhe RRFTV. Në hartimin e kriterëve specifike, RRFTV parashikon specifitime nëpërputhje me: Lëndën për të cilat do të angazhohet stafi akademik dhe Kategorinë e stafit akademik të kërkuar.</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik, fillimisht, parashikohet nga Departamenti i RRFTV sipas nevojave. UART publikon kriteret e punësimit për çdo pozicion pune në departamentin e RRFTV. Pas hapjes së një vendi të lirë pune në njësinë bazë, përpilohet kërkesa dhe vendosen kriteret e pranimit të personelit akademik, nëpërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe kërkesat specifike të formuluar nga Përgjegjësi i Departamentit. Pas miratimit të kërkesës dhe kriterëve të pranimit, Rektori i Universitetit të Arteve, formulon dokumentin informues dhe shpall publikisht në median e shkruar apo elektronike, si dhe në vende të dukshme, kërkesën, kriteret dhe afatin për konkursin e punësimit të vendit vakant. Një komisionin ad hoc kryen vlerësimin e dosjeve të kandidatëve mbi bazën e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Statutit të Universitetit të Arteve dhe kriterëve të botuara. Ky komision, bën vlerësimin dhe renditjen e kandidaturave sipas rezultateve të vlerësimit. Kandidaturat e renditura sipas pikëve të fituara nga kriteret e përzgjedhjes, i dërgohen Rektorit i cili shpall fituesin sipas renditjes së tyre. Rektori vendos miratimin përfundimtar për të lidhur kontratën e punës me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.4 "Dosja e praktikës së punësimit në Departament</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në realizimin e suksesshëm të programit të studimit një rol luajnë edhe strukturat mbështetëse të përcaktuara në strukturën e UART, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, që ndihmojnë institucionin, njësitë kryesore dhe njësitë bazë në realizimin e veprimtarisë mësimdhënëse, artistike-kërkimore shkencore dhe ato administrative. Këto njësi janë njësi ndihmëse akademike me karakter mësimor, pjesë të njësive kryesore dhe njësi ndihmës akademike me karakter administrativ, në funksion të njësive bazë, njësive kryesore dhe në nivel institucional.</p> <p>Në UART, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës mësimor</p>




	<p>janë në mbështetje të zhvillimit të punëve të laboratorit në përputhje me programin e studimit, ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të diplomave etj. Për këtë synohet angazhimi i një personeli ndihmës akademik me kualifikim të lartë në fushën përkatëse. Stafi administrativ gjithashtu është trajnuar vazhdimisht për të qenë në koherencë me kërkesat e kohës. Struktura administrative dhe ndihmës akademike në FAS përbëhet si më poshtë vijon: Sekretaria e Fakultetit: Kryesekretarja; Sekretar/e/i (Specialisti/e) Për kurrikulën dhe informimin e studentëve; Kryetari i Degës së FAS: Specialistët (laborantët) e laboratoreve të Fakultetit; Punonjësit e shërbimit; Dokumentacioni <i>Evidenca 4.5 "Lista e stafit ndihmës akademik e Departamentit RRFTV"</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Drejtorja e Burimeve Njerëzore përditëson çdo vit të dhënat në dosjet e stafit akademik. Për më tepër, në përmbushje të detyrimeve për plotësimin e angazhimit vjetor prej 1536 orësh, sipas Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, stafi akademik me kohë të plotë në përfundim të çdo viti akademik, dorëzon pranë Departamentit veprimtaritë artistike/shkencore të realizuara në atë vit akademik, që përditësojnë drejtpërdrejt CV e stafit akademik. Stafi akademik me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar, si rregull aplikon çdo fillim viti akademik. Pjesë e dosjes së tyre është CV dhe dokumentacioni mbështetës si edhe vlerësimi nga departamenti. Dokumentacioni <i>Evidenca 1.6 "Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018"</i> <i>Evidenca 4.6 "Realizimi i Marrëveshjeve vjetore RRFTV"</i> <i>Evidenca 4.7 "VKM Nr. 329, datë 12.04.2017"</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Praktika profesionale është pjesë e rëndësishme e Programit Bachelor në "Regji filmi&TV", 6 (gjashtë) kredite të ndarë në të tre vitet akademike. Nisur nga veçantia e këtij programi drejtimi i praktikave profesionale bëhet nga personeli akademik i me kohë të plotë të departamentit, i parashikuar në marrëveshjet vjetore të kohës së punës dhe i pasqyruar edhe në pasqyrat e ngarkesave vjetore në auditor të pedagogëve tanë. Praktikant profesionale zhvillohen ose në ambientet e FAS/UART ose në ambientet e partnerëve të UART (kryesisht lokalë). Këtu përfshihen Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental, Metropol, Teatri i Kukullave, Cirku Kombëtar dhe gjithë televizionet e</p>

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>platformat televizive që operojnë në territorin e Tiranës. Në të gjitha rastet praktika profesionale mbikëqyret nga stafi akademik i DRRFTV. Punimi i diplomës, projekti artistik dhe Tema teorike, udhëhiqen e mbikqyrjen nga pedagogët e lëndëve karakterizuese të programit.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Regji Filmi e Televizioni"</i></p> <p><i>Evidenca 3.11 "Pasqyrat e Ngarkesave te Departamentit RRFTV 2022-2024"</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 "Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere në 3 vitet e fundit"</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>UART ka vendosur një sërë marrëveshjesh me institucione artistike dhe kulturore dhe kanë një përvojë të mirë dhe të sukseshme bashkëpunimi. Një pjesë e tyre datojnë që prej viteve 1960. Marrëveshjet janë sanksionuar sot edhe nën logon e Paktit për Universitetin. Studentët e UART, përfitojnë nga eksperiencat e personelit artistik (dhe jo vetëm) të institucioneve pritëse, duke qenë se edhe bashkëpunimi është i tillë që lejon ndërveprimin dhe harmonizimin e eksperiencave të fushës akademike dhe interpretimit skenik e më gjerë. Kjo është pjesë e strategjisë dhe konceptit mësimdhënës që Departamenti dhe stafi pedagogjik kanë për ofrimin e programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Regji Filmi & TV"</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 "Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere në 3 vitet e fundit"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Bachelor në Regji Filmi & TV ofrohet nga staf akademik me përgatitje specifike në fushë dhe me përvojë të spikatur artistike dhe janë aktivë në fushën e artit.</i></p> <p><i>Procedura që ndjek UART për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe ekspertizës për pozicionin e punës. IAL dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv.</i></p> <p><i>Në këtë program janë angazhuar lektorë me kohë të plotë dhe personel akademik me kohë të pjesshme, të cilët kanë nënshkruar një kontratë pune me afat të caktuar dhe me kohë të pjesshme sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe verifikimet në institucion rezulton se personeli akademik është i qëndrueshëm dhe kontribuon në funksionimin e këtij programi. Rekrutimi i stafit të ri bëhet mbi kriteret që shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.</i></p> <p><i>Zyra e burimeve njerëzore ka listën e plotë të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative për çdo semestër që pasurohet çdo vit akademik me të dhëna të përditësuara për të gjithë elementët që</i></p>




	<i>kërkohen nga rregulloret përkatëse.</i>			
	<i>Praktika profesionale mbikqyret nga pedagogë efektiv dhe kryhet në FAS ose në institucionet më të cilat UART ka lidhur marrëveshje, duke ju krijuar studentëve mundësi optimale për zbatimin dhe zhvillimin e komprencave të tyre artistike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi mjediset ku zhvillon mësimin programi Bachelor në “Regji Filmi & TV” dhe konstaton që godina e UART është funksionale për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe artistike.</p> <p>UART si një IAL me specifikë të veçantë, ofron njësi infrastrukturore që rrisin inovacionin e mësimdhënies, me staf administrativ ndihmës-mësimor në funksion dhe në shërbim të procesit mësimor. Infrastruktura e UART është e përshtatshme për përmbushjen e nevojave të mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike, kërkimore - shkencore. Për vetë natyrën specifike të Programit të Studimit Bachelor në “Regji Filmi dhe TV” sikurse dhe mënyrën e organizimit të mësimit në FAS, mjediset e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të përshtatshme për praninë e individëve nga 2 deri në 200.</p> <p>Mjediset e punës janë të përshtatshme për realizimin e programit. Një vend të veçantë zë këtu Salla e performancave Black-Box, me dy mjedise, për 40 dhe 200 vende spektatorësh dhe me hapësira të bollshme skenike, e pajisur me infrastrukturë kompjuterike dhe audio-vizuale dhe sallën e kontrollit në shërbim të sistemit audio dhe projekcion multimedial.</p> <p>Gjithsesi për lëndët të cilat zhvillohen së bashku me studentët e programeve të tjera të studimit, të cilat kërkojnë hapësira skenike më të mëdha institucioni vë në dispozicion edhe mjedise të tjera të përbashkëta me kapacitete të shtuara. Salla e Madhe e Koncerteve, si ambienti qendror i shfaqjeve artistike në UART ka një kapacitet prej 600 vende spektatorësh me hapësira dhe teknikë skenike të një niveli rajonal dhe evropian. Ajo është e pajisur me infrastrukturë dhe pajisje kompjuterike në të dy kabinat e kontrollit të ndriqimit dhe të fonisë.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të</i></p>

	<i>përbashkëta</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Një pjesë e auditorëve ku realizohet ngarkesa mësimore për Programin e Studimit Bsc në “Regji Filmi & TV” janë pajisur me aparaturat e teknologjisë së informacionit, të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Për zhvillimin e të gjitha lëndëve (sidomos atyre speciale) që kanë veçanti pune individuale pedagog student nuk përdoren mjetet e teknologjisë së informacionit. Në caktimin e mjediseve të mësimi dekanati i FAS dhe departamenti RRFTV marrin parasysh veçoritë e lëndëve.</p> <p>Mjediset mbështetëse të programit të FAS, dhe pajisjet që disponojnë, janë gjithmonë në shërbim të realizimit jo vetëm të procesit mësimor, por edhe të projekteve artistike-kërkimore-shkencore të cilat e kanë nismën nga trupa pedagogjike, studentët, apo grupe te përbashkëta pedagogësh dhe studentështë UART si një strukturë e përbashkët.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta</i> <i>Evidenca 4.9 "Lista e pajisjeve në shërbim të Departamentit RRFTV"</i></p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Studiot dhe laboratorët e FAS/UART janë të pajisura me aparaturat e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave të Programit të Studimit Bachelor në “Regji Filmi & TV”. Aparaturat e studiove përmbushin të gjitha kriteret për formimin teorik dhe materializimin praktik të objektivave të lëndëve në programin e studimit. Për vetë specifikën e programit të studimit pajisjet dhe aparaturat që përdoren në Departamentin e RRFTV/FAS janë në shërbim të realizimit të programeve speciale . Gjithashtu Departamenti i RRFTV në plotësim të kërkesave të tregut të punës u ofron studentëve mundësinë të njihen, prekin e përdorin, teknologjinë më të përparuar në specifikën përkatëse dhe që përdoren në IAL me të përparuar në fushën e artit skenik në Europë</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve tëpërbashkëta</i> <i>Evidenca 4.9 "Lista e pajisjeve në shërbim të Departamentit RRFTV"</i></p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>Departamenti i RRFTV, përveç shfrytëzimit të sallës së Bibliotekës Shkencore të UART, të pajisur me PC dhe programe profesionale, zotëron në mjediset e tij laboratorë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale. Të tillë janë laboratorët e Programit të Studimit Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”, program ky po në varësi te RRFTV. Këta laboratorë janë të pajisur me infrastrukturë moderne e cila herë pas here rifreskohet dhe kanë edhe programe te avancuar editimi jo linear për audio, video dhe 3D; efekte speciale digjitale (CGI) manipulim fotosh dhe të tjera detyra bazike si shkrim dhe editim teksti. Por për vetë specifikën e programit, përtej anës</p>




	utilitare (për realizimin e dokumenteve bazike) si dhe ofrimin të mundësisë studentëve për të pasur njohuri të përgjithshme mbi TI, këto pajisje nuk lidhen drejt për drejt me realizimin e qëllimeve dhe objektivave të programit në fjalë, por për pajisjen e studentëve me njohuri plotësuese dhe kompetenca të rëndësishme në tregun e punës.			
Konkluzione	<p><i>Mjediset ku zhvillon mësimin programi Bachelor në "Regji Filmi & TV" është funksionale për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe artistike dhe të përshtashme për realizimin e programit.</i></p> <p><i>Një pjesë e auditorëve ku realizohet ngarkesa mësimore për Programin e Studimit Bsc në "Regji Filmi dhe Tv", janë pajisur me aparaturat e teknologjisë së informacionit, të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Mjediset mbështetëse të programit të FAS, dhe pajisjet që disponojnë, janë gjithmonë në shërbim të realizimit jo vetëm të procesit mësimor, por edhe të projekteve artistike-kërkimore-shkencore të cilat zhvillohen nga trupa pedagogjike, studentët, apo grupe të përbashkëta pedagogësh</i></p> <p><i>Studios dhe laboratorët e FAS/UART janë të pajisura me aparaturat e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave të Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi & TV. Aparaturat e studiove përmbushin të gjitha kriteret për formimin teorik dhe materializimin praktik të objektivave të lëndëve në programin e studimit.</i></p> <p><i>Në FAS ka laboratorë të pajisur me infrastrukturë moderne dhe programe të përparuar editimi që ju ofrojnë studentëve mundësinë për të pasur njohuri të përgjithshme mbi TI, dhe njohuri plotësuese dhe kompetenca të rëndësishme në tregun e punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Programi Bachelor në "Regji Filmi & TV" për vetë specifikën e tij kërkon një angazhim të madh të studentëve në një punë kërkimore kryesisht analitike dhe praktike, por edhe njohjen e literaturës që vjen kryesisht nga klasikët e skenës apo edhe nga autorët modernë e bashkëkohorë që mundësohen nëpërmjet teknologjisë.</p> <p>Në çdo lëndë të Programit të Studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV", parashikohet literature bazë dhe ndihmëse në përputhje me Rregulloren e FAS. Studentëve u mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara: Fizikisht në Bibliotekën e</p>

	<p>UART; Të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), në rastin e leksioneve të hartuara (nëse e parashikon specifika e lëndës); Nëpërmjet paraqitjes së linkut ku mund të gjendet materiali i parashikuar (akses në ueb).</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në AKTRIM")</i></p> <p><i>Evidenca 4.10 "Lista e literaturës Departamenti RRFTV në Bibliotekën e UART")</i></p> <p><i>Evidenca 4.11 "Linku i leksioneve të Teknikave të Produksionit skenik"</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i RRFTV, në fillim të çdo viti akademik, bën rishikimin e programeve të lëndëve (syllabuset). Nga takimet me stafin akademik rezulton se ky rishikim bëhet kryesisht për literaturën bazë dhe asaj ndihmëse, sipas mundësive që paraqiten. Për vetë specifikën e programit, duke qenë se nuk bëhet fjalë për teknologji dhe kërkime në fusha teknike/teknologjike, botimet më të fundit nuk zotërojnë detyrimisht risi dhe kapërcime marramendëse kufijsh në praktikat teorike dhe artistike. Teoricienët më të mëdhenj dhe propozuesit e rrymave të reja të teatrit e patën valën e tyre kryesisht në dy dekadat para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Botimet aktuale ofrojnë më së shumti qasje personale drejt një psikologjie të caktuar artistike të cilën programi ua ofron si mundësi njohjeje studentëve por, në respekt të lirisë artistike dhe krijuese, jo detyrimisht duhet të përqafohet nga studenti.</p> <p>Lista e literaturës së detyrueshme është e përcaktuar qartë në Syllabuset e lëndës. Pjesa më e madhe e botimeve të reja ka të bëjë me revista e buletine artistike të vendeve kryesore Evropiane si dhe tituj veprash dramatike të cilat janë edhe elementi më i kërkuar nga pedagogët dhe studentët e Departamentit Regji Filmi & TV/FAS.</p> <p>Në mungesë të botimeve të mirëfillta artistike/pedagogjike në gjuhën shqipe, literatura është në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht, italisht dhe frëngjisht.</p> <p>GVJ u informua gjatë takimit se pedagogët e Departamenti RRFTV janë bërë pjesë e përkthimeve të kolanave të klasikëve të mendimit teorik dhe praktik të skenës.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca, 4.10 "Lista e literaturës Departamenti RRFTV në Bibliotekën e UART"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ vizitoi dhe u njoh me punën në bibliotekë dhe shërbimet që ajo ofron për studentët. Ajo është njësia kryesore e ofrimit të literaturës shkencore dhe artistike dhe krijon mundësi të barabarta për të gjithë studentët e të gjithë programeve. Ka dy salla, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library", të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje</p>




<p>programit të studimit.</p>	<p>kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve. Gjithashtu në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART. Shërbimet elektronike të Bibliotekës së Universitetit ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve, të cilat janë: Sistemi i menaxhimit të integruar dhe sistemi i arkivit digjital përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike. FAS/UART, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimise së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet depozitimit në Bibliotekën e UART të materialeve të krijuara ndër vite. Dokumentacioni <i>Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale"</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit të Arteve i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si: Salla me Fond të hapur, e cila ofron: Koleksionet e arteve pamore, materialet referenciale për të tria fakultetet, kompjuter dhe fotokopje. Fondi i hapur i librave i jep mundësinë përdorueseve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar vetëm disa faqe që ju intereson. Ka literaturë referenciale për të gjithë programet e studimit të UART. Salla me Fond të mbyllur ofron: Literaturë muzikore , Literaturën e artit dramatik, Literaturën e artit figurativ , Revista dhe gazeta (koleksionet e viteve të kaluara, në gjuhë shqipe dhe të huaj) ; Literaturë të përgjithshme . Dokumentacioni <i>Evidenca 4.13 "Lista gjithëpërfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART"</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka Shkencore e UART krijon mundësi të barabarta për të gjithë studentët e institucionit. Salla multimediale e Bibliotekës të UART, e pajisur me teknologji të re, ofron kushte komode, është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, dhe studiuesve të artit, terësisht pa pagesë. Statistika për përdorimin e kompjuterëve të sallës multimediale nga përdoruesit e bibliotekës për nevojat e tyre mësimore dhe artistike është afërsisht nga 90 deri 100 përdorues në ditë. Kjo sallë përveç arkivës digjitale, disponon edhe materiale të tjera audiovizuale në shirita, bobina, pllaka gramafoni, kasete, CD e DVD. Arkiva digjitale e aksesueshme e kësaj salle është krijuar nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve me bazë "kod me burim të hapur". Qëllimi i kësaj arkive është që të ofrojë akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar për të gjithë audiencën e Bibliotekës së UART ku sigurisht në fokus është studenti. Dokumentacioni <i>Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale"</i></p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UART është në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library" , të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve. Në ambientet e bibliotekës ndodhet "Salla Multimediale" e cila është e pajisur me 20 kompjuterë me qasje në internet të pajisur me softëare specifik në mbështetje të punës studimore. Programet kompjuterike janë në ndihmë për studentët e të gjithë programeve.</p> <p>Gjithashtu në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së UART, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.10 Lista e literaturës RRFTV në Bibliotekën e UART</i></p> <p><i>Evidenca 4.11 Linku për akses në leksionet e Teknikave të Produksionit Skenik.</i></p> <p><i>Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale</i></p> <p><i>Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në Biblioteka GVJ u njoh me organizimin e punës së bibliotekës. Biblioteka e ndërton punën sipas rregullores bazuar në përcaktimet e Statutit të UART Neni 21 dhe është në shërbim të studentëve çdo ditë. Orari i punës në bibliotekë është i shpallur në ambientet e bibliotekës, e cila është e hapur nga ora 08:00 deri në orën 19. Biblioteka funksionon dhe ditët e shtuna. Në mënyrë të veçantë, përgjatë sezoneve të provimeve, biblioteka e UART punon me orar të zgjatur, bazuar në kërkesat e Fakulteteve të UAR , për plotësimin e kërkesave të studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë</p>	<p>Referuar RVB Biblioteka e UART informon rregullisht Njësitë Bazë për mundësitë dhe fondet e vëna në dispozicion të pasurimit të literaturës. Bazuar në njoftimin e bibliotekës, Departamenti RRFTV paraqet kërkesat e tij për literaturën e nevojshme dhe pasurimin e fondit të bibliotekës në funksion të Programit të Studimit Bachelor në "Regji Filmi &TV". Gjithashtu, biblioteka raporton për fondin fizik në dispozicion (tituj, tekste, drama, revista, buletine, etj) dhe frekuentimin e ambienteve të bibliotekës apo frekuentimin online.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.10 "Lista e literaturës Departamenti RRFTV në Bibliotekën e UART"</i></p> <p><i>Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale"</i></p> <p><i>Evidenca 4.15 "Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART"</i></p>




përprojekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<p><i>Programi Bachelor në "Regji Filmi &TV", në çdo lëndë të tij parashikon literaturën bazë dhe ndihmëse në përputhje me Rregulloren e FAS. Studentëve u mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara: fizikisht në Bibliotekën e UART; Të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), ose online. Në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i programeve të lëndëve (syllabuset). Nga takimet me stafin akademik rezultojnë se ky rishikim bëhet kryesisht për literaturën.</i></p> <p><i>UART ka në dispozicion bibliotekën si njësi kryesore e ofrimit të literaturës shkencore dhe artistike dhe që krijon mundësi të barabarta për të gjithë studentët e të gjithë programeve. GVJ u njoh me punën në bibliotekë dhe shërbimet që ajo ofron për studentët. Ka dy salla, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library", të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve.</i></p> <p><i>Biblioteka Shkencore e UART krijon mundësi të barabarta për të gjithë studentët e institucionit. Salla multimediale e Bibliotekës të UART, e pajisur me teknologji të re, ofron kushte komode, është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, dhe studiuesve të artit, terësisht pa pagesë.</i></p> <p><i>Vlen të theksohet se FAS/UART, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet depozitimit në Bibliotekën e UART të materialeve të krijuara ndër vite.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në	UART siguron menaxhimin e informacionit dhe të dhënave për studentët dhe stafin akademik nëpërmjet -Web-it të UART http://uart.edu.al/ - Komunikimit nëpërmjet postës elektronike; -Sistemit të brendshëm PITAGORA (të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe student janë të aksesuar në sistemin e sipërpermendur);

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëëb site: eëe.ascal.al




<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Për t'u regjistruar në Programin e Studimit Bachelor në Regji Filmi & TV, student dorëzon dosjen me të dhënat personale dhe CV. Të dhënat e studentit në Dep. RRFTV regjistrohen në regjistrin themeltar (të Amzës) nga sekretaria e FAS bazuar në rregulloren e kësaj të fundit dhe Rregulloren e FAS. Po ashtu, edhe arritjet e tij regjistrohen në regjistrin e arritjeve akademike në bazë të listës së notave të dale nga sekretaria si dhe në librezën elektronike të sistemit PITAGORA. Gjithashtu, aktivitetet e realizuara nga studentët publikohen në faqen ueb dhe rrjetet sociale të UART.</p>
	<p>Dokumentacioni <i>Evidenca 4.16 "Rregullorja e funksionimitte Sekretarisë Mësimore FAS"</i> <i>Evidenca 1. 16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS"</i> <i>Evidenca 4.17 "Screenshot nga regjistri i FAS"</i> <i>Evidenca 3.13 "Screenshot-e nga sistemi Pitagora"</i> <i>Evidenca 4.18 "Screenshot nga komunikimi me e-mail me studentët dhe pedagogët e FAS"</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstaton se Drejtoria e burimeve njerëzore ka dosje të plotësuar për personelin akademik dhe personeli ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar për këtë program, bazuar në Statutin e UART Neni 61. Në përfundim të çdo viti akademik secili pedagog përditëson e dosjen e tij me aktivitetin akademik dhe artistik. Departamenti RRFTV përveç plotësimit të dokumentacionit për realizimin e ngarkesës mësimore dhe veprimtarive të tjera të stafit akademik, sipas Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018; VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, kërkon edhe realizimin e aktiviteteve artistike shkencore në përputhje me akt marrëveshjen . Të gjitha këto bëhen pjesë e sistemit të menaxhimit të brendshëm të dokumentacionit pranë Drejtorisë së Burimeve njerëzore.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i> <i>Evidenca 1.6 "Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018"</i> <i>Evidenca 4.7 "VKM Nr. 329, date 12.04.2017"</i> <i>Evidenca 4.6 "Realizimi i Marrëveshjeve vjetore RRFTV"</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve, të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohehet privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjisllacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që</p>




	<p>përdoruesit zhvillojnë në UART duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtari të personelit të FAS.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 4.16 "Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS"</i> <i>Evidenca 4.19 "Manuali Pitagora"</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i integruar PITAGORA është një platformë e cila siguron këmbimin e informacionit mes studentëve, sekretarisë FAS dhe pedagogëve. Nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi i pedagogut për studentin në një lëndë specifike, pasqyrohet në kohë reale në adresën personale të studentit brenda të njëjtit sistem.</p> <p>Ky sistem siguron shumë mundësi si: Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimin të marre dhe librezën e notave; Vetë regjistrimin e studentëve në provim; Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët; Njoftimin në kohë reale të notave apo mënyrave të tjera të vlerësimin të studentëve; Përgatitjen e listave të provimeve për secilën lëndë; Hedhjen e notave në sistem nga pedagogët; Informimin mbi lëndët kaluese/jokaluese dhe kreditet e akumuluar nga studenti;</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 4.19 "Manuali Pitagora"</i> <i>Evidenca 3.13 "Screenshot-e nga sistemi Pitagora"</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Realizimi i veprimtarisë akademike të personelit akademik, sidomos veprimtaritë e kryera në territorin e UART, verifikohet nëpërmjet: Monitorimit në kohë reale të procesit mësimor në përputhje me Rregulloren e FAS; Monitorimit të veprimtarisë artistike/shkencore në përputhje me Rregulloren e FAS;</p> <p>Gjithashtu, në rastet e realizimit të veprimtarive të tjera për të cilat stafi akademik ka nevojë për leje të veçantë, para fillimit të aktivitetit depozitohet në departament një kërkesë për leje, e cila nëse miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë, i përcillet Dekanit në përputhje me Rregulloren e FAS. Në varësi të kohëzgjatjes së lejes së kërkuar, kërkesa mund të përcillet edhe tek Rektori i UART për vlerësim të mëtejshëm, bazuar në "Rregulloren Për procedurën e përfitimit të lejeve nga personeli akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në UART", miratuar me VSA Nr. 07, dt. 09/10/2024. Në përfundim të aktivitetit, stafi akademik ka detyrimin e dorëzimit të dokumentacionit justifikues dhe të një raporti narrativ.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 4.20 "Fletë-prezenca e pedagogëve në orën e mësimin"</i> <i>Evidenca 4.21 "Kërkesa të pedagogëve për leje për krijimtari apo aktivitet"</i> <i>Evidenca 4.22 "Rregullore e procedurës së përfitimit të lejeve në UART"</i></p>

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Universiteti i Arteve Tiranë publikon në faqen eeb një sërë të dhënash që lidhen drejtpërdrejt me programet e studimit. Në faqen ueb të UART publikohen: planet mësimore të miratuara nga Senati Akademik; vendime të ndryshme të senatit dhe organeve e autoriteteve drejtuese; kriteret e konkurseve të pranimit; Rregullore dhe baza ligjore; njoftime; informacione mbi fakultetet, departamentet dhe programet e studimeve, informacion mbi autoritetet drejtuese; informacion mbi sekretaritet dhe administratën e UART.</p> <p>Përdoren dhe rrjete sociale për publikimin e një pjese të mirë të aktiviteteve të ofruara për studentët</p> <p><i>Shënim: GVJ vëren se një pjesë e informacionit nuk është i aksesueshëm lehtë në faqen zyrtare. Sugjerojmë të vihet adresa elektronike e drejtuesve të FAS, sepse nuk hapet, si dhe të bashkëngjitet një bio e shkurtër e stafit akademik, përveç thjesht emrit të tyre.</i></p> <p>Në RVB shënohet se “Për rastet e aktiviteteve të cilat kanë përmbajtje në më shumë se një gjuhë, publikimi bëhet në gjuhën shqipe dhe bashkëngjitet linku Për gjuhën tjetër”, ndërsa GVJ nuk mund ta aksesonte këtë link.</p> <p>Rregullimi i këtyre sugjerimeve të vogla do ndikojë në rritjen e vizualitetit të Institucionit, i cili në fakt zhvillon një punë cilësore akademike dhe artistike.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UART disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p> <p><i>Institucioni ka një sistem menaxhimi efektiv për administrimin e informacionit për studentët. Nëpërmjet sistemit Pitagora administrohen të dhënat e studentëve.</i></p> <p><i>Sistemi i menaxhimit mundëson akses në informacione e dokumente të dedikuara për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të informacionit që lidhen më procesin mësimor dhe zbatimin e programit nga ana e personelit akademik.</i></p> <p><i>Personeli akademik zhvillon një veprimtari të gjerë akademike dhe artistike që monitorohet nga Departamenti dhe FAS në kohë reale si dhe nëpërmjet përditësimit të dokumentacionit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.</i></p> <p><i>Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e UART.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="624 1883 794 1921">Nuk</td> <td data-bbox="794 1883 997 1921">Përmbushet</td> <td data-bbox="997 1883 1200 1921">Përmbushet</td> <td data-bbox="1200 1883 1457 1921">Përmbushet</td> </tr> </table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet		




standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Administratori i UART, nëpërmjet drejtorisë ekonomike harton projekt buxhetin afatmesëm (PBA) tre vjeçar dhe atë të përvitshëm për financimin e Departamentit RRFTV dhe të gjitha programeve të tjera të studimit pranë kësaj njësie. Departamenti RRFTV dhe FAS për hartimin e projekt buxhetit bashkëpunon me drejtorinë ekonomike në nivel universiteti. Burimet e financimit të Departamentit vijnë i nga buxheti i shtetit, të ardhurat e krijuara nga institucioni dhe burime të tjera me destinacion. Hartimi i PBA dhe buxhetit të përvitshëm, përpos planifikimit të fondit të pagave për stafin akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, bazohet në kërkesat e Njësisë Bazë RRFTV. Në kërkesat e paraqitura në funksion të mbështetjes financiare të programeve të studimit në varësi të saj, Departamenti RRFTV përqëndrohet në: Parashikimin e stafit akademik me kohë të plotë; Sigurimin e bazës materiale; Parashikimin e mbështetjes së veprimtarisë artistike dhe kërkimit shkencor; Parashikimin e shpenzimeve logjistike për aktivitete të ndryshme; Projekt buxheti, parashikon të gjitha kostot e mbulimit financiar të programit të studimit dhe pasi miratohet në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, i përcillet për miratim përfundimtar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.24 "Paraqitja e buxhetit nga administratori i FAS</i> <i>Evidenca 4.25 "VSA Miratimi i Buxhetit Afatmesëm 2020 - 2022 "</i> <i>Evidenca 4.26 "VSA Miratimi i Buxhetit Afatmesëm 2023 - 2025"</i> <i>Evidenca 4.27 "VSA Miratimi i Buxhetit Afatmesëm 2024 - 2026"</i> <i>Evidenca 4.28 "VBA 28 dt 29 07 2020 Miratimi i Buxhetit afat mesëm 2021-2023 Evidenca 4.29 "VBA 19 dt 25 07 2023 Miratimi i Buxhetit afat mesëm 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për</p>	<p>Në hartimin e projekt-buxhetit dhe mbështetjen efektive financiare të programit të studimit merren parasysh kërkesat e paraqitura nga Departamenti RRFTV përgjegjëse për Programin e Studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV". Sipas detajimit të kërkesave për Projekt Buxhetin Afatmesëm, përpara fillimit të vitit akademik, Departamenti paraqet kërkesën për stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme. Financimi i stafit akademik me kohë të plotë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: eëe.ascal.al

<p>mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>sigurohet nga buxheti i shtetit ndërkohë që stafi akademik me kohë të pjesshme mbulohet financiarisht nga të ardhurat e vetë institucionit. Gjithashtu institucioni, bazuar në planifikimin financiar, siguron mbështetjen financiare për të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me programin e studimit.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.24 "Paraqitja e buxhetit nga administratori i FAS"</i></p> <p><i>Evidenca 4.30 "Kërkesat e FAS për staf akademik sipas kategorive për vitin pasardhës "</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar RVB, bazuar në ligj, UART, për periudhën në të cilën shtrihet edhe vlerësimi i institucionit në kuadër të akreditimit, nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar.</p> <p>UART raporton në mënyrë periodike në MAS pasqyrat vjetore financiare. Auditimi financiar i UART mund të realizohet në një periudhë të mëvonshme.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.31 "Pasqyrimi financiar vjetor për vitet 2021 - 2024"</i></p> <p><i>Evidenca 4.32 "VKM Nr. 83, date 03.02.2016"</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin në fuqi Drejtoria Ekonomike e UART paraqet çdo vit analizën për veprimtarinë ekonomike të institucionit dhe raporton mbi realizimet e zërave sipas parashikimeve të bëra në project buxhet dhe realizimeve konkrete të tyre.</p> <p>Zërat në raport përfshijnë: investimet, fondin e pagave, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, mallrat dhe shërbimet e tjera, transferimet korrente për jashtë, ndihmë për individët dhe bursa. Po e njëjta procedure ndiqet edhe për realizimin e buxhetit për vitin në fjalë. Më pas vijon paraqitja e realizimit të buxhetit sipas zërave dhe bazuar në burimet e financimit për çdo zë. Ky raport kalon më pas për miratim në Senatën Akademik të UART sipas parashikimeve të ligjit.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 4.33 "Dokumente nga drejtoria ekonomike mbi raportimin për realizimin e buxhetit"</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës</p>	<p>Deri më tani institucioni nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë në përmirësimin e situatës financiare. Gjithsesi Departamenti i RRFTV/FAS në përmbushje të misionit për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore si në kushte e me mjete modern të teknologjisë parashikon projekte të cilat do ishin një burim shtesë të ardhurash.</p>




financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<p><i>UART si institucion publik i arsimit të lartë garanton financim dhe mbështetje financiare nga buxheti i shtetit dhe mbështetje alternative nga burime të tjera. Të ardhurat financiare në tërësi kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit.</i></p> <p><i>GVJ vëren se UART ndjek dhe analizon plan-buxhetit, realizimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare. UART mbështet departamentin në zhvillimin e veprimtarive artistike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>UART ka hartuar dhe zbaton procedura për ciklin e plotë të programit të studimit. Këto procedura zbatohen edhe për studentët e Programit të studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV".</p> <p>Dokumenta që rregullojnë këtë process janë: Statuti, Rregullorja e UART, Rregullorja e ciklit të parë të studimeve; Rregullorja e Departamentit RRFTV; Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV"; Rregullorja e Sekretarisë mësimore FAS, si dhe një sere rregulloresh të tjera të strukturave vendihmëse.</p> <p>Të gjitha aktet rregullative janë të miratuara me Vendime të Senatit Akademik dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e UART.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.4 "VKM Nr. 145, date 10.03.2021, "Për dhënien e Statusitte UART"</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i></p>

	<p><i>Evidenca 5.1 "Rregullorja e UART"</i> <i>Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit"</i> <i>Evidenca 1.17 " Rregullorja e Departamentit RRFTV"</i> <i>Evidenca 4.16 "Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS"</i> www.uart.edu.al.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UART në vizionin e vet ka përcaktuar se është i vendosur që: Të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik-shkencor. Realizimin e objektivave Institucioni e bazon në ofrimin e mundësive të barabarta për të përfituar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Institucioni mundohet që të jetë transparent me studentët, i paanshëm, dhe të përdorë parime e kritere si barazia, ndershmëria, informimi zyrtar dhe publik, njoftimet, etj., prej të cilave ruhet baraspesha mes aktorëve kryesorë brenda e jashtë institucionit. Kriteret, procedurat, kërkesa për transferim dhe të gjitha rregulloret e aktet rregullative janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Kjo transparencë dhe lehtësi aksesi në informacion përbën një nga parimet kryesore të funksionimit të UART, përshkruar në të gjitha rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit . Nga ana tjetër, UART/FAS një politikë pranimi krejt të ndryshme nga universitetet e tjera në vend. Studentit nuk i mjafton vetëm mesatarja e ponderuar, por duhet të konkurrojë para komisionit të pranimit për të prezantuar aftësi shtesë, të përcaktuara në rregulloret dhe kriteret e pranimit të aprovuara për secilin vit akademik. I gjithë procesi i konkurrimit është i dokumentuar si shkresërisht (për anën teorike dhe vizionin) ashtu edhe në format video (për anën praktike/artistike). Gjatë vizitës në Institucion nuk konstatuam raste të mosbarazisë gjatë gjithë zhvillimit të programit. Në takimet me studentë u vu re se në Institucion krijohet një ambient gjithëpërfshirës , mbështetës dhe respektues për studentët dhe pedagogët.</p> <p>Dokumentacioni <i>Akses në EEB dhe rregulloret online (Transparenca)</i> <i>"Kriteret e Konkurrimit FAS 2021-2022"</i> <i>"Kriteret e Konkurrimit FAS 2022-2023"</i> <i>"Kriteret e Konkurrimit FAS 2023-2024"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës</p>	<p>Rregullores së programit të studimit, kriteret për regjistrimin e studentëve në programin Bachelor në "Regji Filmi &TV" janë: Në UART kandidatët i nënshtrohen konkurseve të pranimit. Fakulteti i Artit Skenik harton Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit. Kjo rregullore miratohet me Vendim të Senatit Akademik dhe publikohet në faqen Eeb të UART; Konkursi organizohet në zbatim të rregullores; Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të</p>




<p>shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>mesëm ka të drejtë të konkurrojë Përt' u pranuar (të ndjekë) studimet në këtë program studimi.</p> <p>Kandidati duhet të plotësojë më parë gjithë kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga udhëzimet dhe aktet nënligjore në fuqi për atë vit akademik;</p> <p>Çdo kandidati, në konkursin e pranimit, i kërkohet nga Komisioni i pranimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Hartimi i një skice platforme regjisoriale mbi bazën e një pjese dramatike që caktohet nga komisioni (tema, konflikti, personazhet, dekori, imazhi regjisorial etj.); -Bashkëbisedimi mbi formimin e përgjithshëm kulturor në fushën e teatrit, dramaturgjisë, filmit, letërsisë në përgjithësi, arteve figurative, etj.; - Interpretimi i materialeve si: monolog; tregim; poezi; -Realizimin e një etydi regjisorial mbi bazën e një teme të caktuar dhe objekteve të përcaktuara që sugjerohen nga komisioni; <p>Studentë në këtë program studimi mund të pranohen nga Shqipëria, Kosova, Presheva, Bujanovci, Medvegja, Maqedonia e Veriut, nga Mali i Zi si edhe nga vende të tjera nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe të certifikuar nga institucionet përgjegjëse;</p> <p>Kriteret, procedurat si dhe perqindja e pikezimit të konkurseve të pranimit bëhen publike në: faqen ueb të Fakultetit; në ambientet e përcaktuara të njoftimeve per secilin Fakultet</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Regji Filmi & TV</i></p> <p><i>Evidenca 5.2 "FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve Bachelor 2021 2022"</i></p> <p><i>Evidenca 5.3 "FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve Bachelor 2022 2023"</i></p> <p><i>Evidenca 5.4 "FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve Bachelor 2023-24"</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FAS u vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat pranimit, të përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Për sa i përket kriterëve dhe procedurave të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, ato janë të shprehura në Rregulloren e IAL dhe Rregulloren e njësisë kryesore.</p> <p>Kuotat dhe kriteret e pranimit të propozuara nga Njësia Bazë, pasi kanë marrë miratimin e Dekanatit të Fakultetit dhe Senatit Akademik, publikohen online në faqen zyrtare të Institucionit përpara fillimit të vitit akademik. Informacioni është i aksesueshme, pasi janë të publikuara online.</p>

	<p>Departamenti i RRFTV ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fusha të përafërta, brenda programeve që ofron UART apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në FAS, i takon komisionit të ngritur për këtë procedurë të departamentit ku studenti kërkon të transferohet. Vendimin përfundimtar mbi vlerësimin e kandidatit nga Komisioni i ngritur për këtë procedurë e merr Dekani i FAS.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FAS vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat pranimit, të përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Për sa i përket kriterëve dhe procedurave të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, ato janë të shprehura në Rregulloren e IAL dhe Rregulloren e njësisë kryesore.</p> <p>Kuotat dhe kriteret e pranimit të propozuara nga Njësia Bazë, pasi kanë marrë miratimin e Dekanatit të Fakultetit dhe Senatit Akademik, publikohen online në faqen zyrtare të Institucionit përpara fillimit të vitit akademik. Informacioni është i aksesueshëm, pasi janë të publikuara online.</p> <p>Departamenti RRFTV ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fusha të përafërta, brenda programeve që ofron UART apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në FAS, i takon komisionit të ngritur për këtë procedurë të departamentit ku studenti kërkon të transferohet. Vendimin përfundimtar mbi vlerësimin e kandidatit nga Komisioni i ngritur për këtë procedurë e merr Dekani i FAS.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1. 15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit; nenet 24-25</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UART, duke respektuar së pari parimin e meritave dhe të të dhënave natyrore (talentit) si dhe për të ruajtur parimin e barazisë, nuk harton kriteret të posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta apo të pakicave dhe shtresave të marginalizuara por, përcakton kuota pranimi të veçanta për këto shtresa. Në RRFTV/FAS nuk parashikohen kuota për studentët me aftësi ndryshe. Kjo vjen edhe si pasojë e specifikës së programit. Kurrikulat e lëndëve speciale kërkojnë fizikalitet të lartë brenda dhe jashtë skenës, aktiviteti skenik parashikon një koordinim superior të shqisave nga të cilat vjen së pari mjeshhtëria realizuese artistike por, shpesh herë varen edhe vendime me karakter sigurie në fraksion të sekondës. Mungesa e këtij</p>




	<p>fizikaliteti dhe aftësisë së koordinimit shqisor do të krijonte në, dhe prapa skene një rrezik real për vetë individin me aftësi të kufizuara dhe njëherazi një rrezik potencial për studentët e tjerë apo trupën ndihmëse teatrore.</p> <p>Për studentët që vijnë nga shtresa sociale "Romë/Ballkano Egjiptianë", FAS/UART ndjek politikë mbështetëse, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 2.4 "VKM Nr 251, datë 27/03/2020 "Për përjashtimin nga pagesa të studentëve; Romë/Ballkano- Egjiptianë"</i> <i>Evidenca 5.8 "Kapacitetet pritëse Bachelor të RRFTV/FAS 2022-2023"</i> <i>Evidenca 5.9 "Kapacitetet pritëse Bachelor të RRFTV 2023-2024"</i> <i>Evidenca 5.10 "Kapacitetet pritëse Bachelor të RRFTV/FAS 2024-2025 "</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Universiteti i Arteve, si institucioni i vetëm që ofron studime të larta në fushën e artit, duke respektuar së pari parimin e meritave dhe të dhënave natyrale (talentit), si dhe për të ruajtur parimin e barazisë, nuk harton kriteret të posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studimet në UART mund t'i ndjekin edhe shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi. Në të gjitha rastet, meqenëse programi i studimit ofrohet nëgjuhën shqipe, studentët e huaj duhet të tregojnë se e zotërojnë atë nëpërmjet certifikatave të aprovuara nga organet kompetente.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1. 15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit"</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UART zbaton të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për kategoritë të cilat përfitojnë bursa në ndjekjen e studimeve të larta. Po ashtu për studentët që vijnë nga shtresa sociale "Romë/Ballkano Egjiptianë", UART ndjek politikë mbështetëse, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. Universiteti i Arteve zbaton anën ligjore dhe nënligjore, procedurën për pranimin e dokumentacionit për secilin aplikues sipas kategorive dhe miraton përfituesit.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.11 "VKM 780 dt.26/12/2018 KriteretPër ulje te tarifës vjetore të studimit "</i> <i>Evidenca 2.4 "VKM 251 27/03/2020 per përjashtimin e nga pagesa të studentëve; Romë/Ballkano - Egjiptianë"</i> <i>Evidenca 5.12 "VBA nr. 4 dt.16/02/2023 Reduktimi i tarifave të"</i></p>

	<i>shkollimit"</i>			
Konkluzione	<p><i>UART harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale.</i></p> <p><i>Fakulteti i Artit Skenik, me të gjitha strukturat e tij, angazhohet maksimalisht në informimin e publikut dhe të të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm.</i></p> <p><i>Unifikimi i procedurave në rang Universiteti garanton ecurinë e programit të studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV".</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FAS vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi shërbejnë aktet normative në fuqi. Kështu, respektohet tërësia e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, si dhe në Rregulloren e Programit. Faqja e web-it të UART dhe sistemit PITAGORA është një burim i pasur informacioni, lehtësisht i aksesueshëm, nga i cili studentët janë në gjendje të informohen për hapat që merren në drejtim të përparimit të tyre. Gjithashtu të dhënat për kriteret dhe procedurat u bëhen të njohura studentëve gjatë takimeve të tyre me Drejtuesin e Njesisë Bazë.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS"</i></p> <p><i>Evidenca 1. 18 Rregullorja e Programit të Studimit RegjiFilmi e Televizioni</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	FAS, me anën e rregulloreve të miratuara vë në dispozicion kurrikulën e studimeve, planin mësimor, modulet dhe programin lëndor (syllabusin), ku përcaktohen objektivat e lëndëve, literatura e detyrueshme dhe ajo e sugjeruar, temat, orët e leksioneve/seminareve, organizimin në semestra si dhe kohëzgjatjen e kursit. Nga këto rregullore studentët marrin informacion të detajuar mbi




	<p>dokumentacionin e nevojshëm për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit, pjesë e pandarë e kriterëve është konkursi apo testimi i talentit të kandidatit. Çdo person që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve "Bachelor" dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në Statutin e UART si dhe në rregulloret dhe kriteret e miratuara në Senatin Akademik të UART, ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar në programet e mëpasme të studimi.</p> <p>Gjithashtu institucioni kryen transferime dhe njohje të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme duke u mbështetur në përcaktimet e rregullores së programit të studimit Bachelor në "Regji Filmi dhe TV" dhe në Manualin e transferimit të studimeve në UART.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1. 18 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi e Televizioni</i></p> <p><i>Evidenca 2. 8 Manual i transferimit të studimeve në UART</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer, GVJ konstatoi që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij.</p> <p>Gjatë javës së orientimit (në fillim të vitit akademik) studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga drejtuesit e departamenteve dhe koordinatoret e programeve të studimit të cilët sqarojnë paqartësitë që studentët mund të kenë dhe mbajnë kontakte të vazhdueshme përgjatë vitit akademik me studentët.</p> <p>Në të njëjtën kohë në secilin program, pedagogët e lëndës kanë përfshirë vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimi sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit, duke qenë se në FAS, mësimdhënia është e organizuar në mënyrë individuale për lëndët speciale dhe në grupe të vogla (ose të mëdha) Për lëndët artistike/lëndë të formimit bazë, pedagogët në mënyrë individuale kryejnë informimin e studentëve lidhur me procesin mësimor, programin lëndor, sezonin e provimeve, sistemin e vlerësimit dhe detyrimet vjetore të studentit në lidhje me programin/fushën specifike ku ai studion.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Regji Filmi dhe TV</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e</p>	<p>GVJ në takimin me studentët konstatoi se ata ishin të informuar mbi procedurat e punimit të temës së diplomës dhe të diplomimit.</p> <p>Departamenti nëpërmjet personelit akademik jep në mënyrë të vazhdueshme informacione të detajuara lidhur me përgatitjen e diplomës dhe procesin e diplomimit. Atyre u shpërndahen tematikat e</p>




studimit.	<p>sugjeruara per t'u zgjedhur prej tyre per diplomim, si dhe u shpjegohen procedurat e punimit të temës së diplomës dhe rregullorja përkatëse. Për sa u përket punimeve teorike studentëve u jepet informacion për përmbushjen e kriterëve për diplomim si dhe për politikën mbi plagjiaturën, pronësisë intelektuale dhe mënyrat e citimit e referimit dhe caktimin e pedagogut udhëheqës. Po ashtu studentët përpara dorëzimit të temës teorike plotësojnë paraprakisht vetë-deklarimin për mungesën e plagjiaturës në punimet e tyre.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Regji Filmi dhe TV"</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimi me studentët evidentoi se ata kanë mundësi për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UART. Institucioni ndjek një sërë politikash për të informuar studentët e interesuar mbi programin e studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV". Kjo bëhet e mundur si në fillim të vitit akademik ashtu edhe në mënyrë periodike.</p> <p>UART është një institucion i hapur për publikun. Ai vizitohet në mënyrë të vazhdueshme nga të interesuar të cilët duan të shohin në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivitetin mësimor të institucionit, infrastrukturën, të njohin anëtarë të stafit akademik, etj. Sidomos gjatë periudhës së provimeve janë të shumtë nxënës të sistemit parauniversitar që aspirojnë të konkurrojnë në programe studimi të ndryshme brenda UART mbushin sallat e shfaqjeve. Nga UART synohet informimi i nxënësve kur janë në shkollë të mesme për t'i nxitur që të mund të zhvillojnë talentin e tyre në fushën e përzgjedhur. Risia që solli Dhjetori 2024 ishte aktiviteti Open Day. Universiteti dhe gjithë programet e studimit i patën dyert e hapura nga mëngjesi deri në mbrëmje për t'u dhënë mundësi të gjithë të interesuarve të ndiqnin nga afër punën dhe aktivitetet e përditshme të stafit akademik dhe studentëve të UART. Përveç orëve të hapura të mësimin që mund të vizitoheshin lirisht nga gjithkush, kishte plot materiale informuese që të interesuarit mund t'i merrnin me vete. Data e zhvillimit të aktivitetit Open Day u bë publike që më parë me të gjitha format e mundshme (ftesa, media, fushata online).</p> <p>UART ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Gjithashtu për një shpërndarje më të shpejtë të informacionit përdoren edhe rrjetet sociale Facebook, LinkedIn, Google+, Youtube, Instagram.</p> <p>Për kandidatët e huaj të cilët dëshirojnë të konkurrojnë në njërin nga programet e studimit të ofruar në UART, ndiqet një politikë mikpritjeje dhe dashamirëse, për t'ju krijuar një klimë sa më mikpritëse dhe bindëse në prezantimin e UART dhe akomodimin e tyre.</p> <p>Dokumentacioni</p>




	<i>Evidenca 5.13 "Agjenda Open Day"</i>			
Konkluzione	<p><i>FAS sipas rregulloreve të tij dhe rregulloreve institucionale ka informacion të plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve. Institucioni jep informacion të nevojshëm për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve.</i></p> <p><i>Rregulloret e miratuara, procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve dhe faqja e Eëb-it janë një burim i pasur informacioni, lehtësisht i aksesueshëm.</i></p> <p><i>Drejtuesit e departamenteve dhe koordinatorët e programeve të studimit kryejnë takime informuese me studentët gjatë javës së orientimit dhe më pas mbajnë kontakte dhe kryejnë takime periodike me studentët përgjatë vitit akademik.</i></p> <p><i>FAS përdor metoda alternative dhe efikase të komunikimit me studentët, përfshirë edhe rrjetet sociale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik. Institucioni ofron informacion të plotë në lidhje me organizimin dhe strukturën e programit të studimit, numrin e krediteve, kohëzgjatjen e studimeve si dhe llojin e diplomës që lëshohet. Ky informacion mund të merret në Rregulloren e UART, Rregulloren e Fakultetit të Artit Skenik, në Rregulloren e Departamentit RRFTV, Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Regji Filmi dhe Tv" si dhe në faqen zyrtare të UART. Tërësia e këtyre akteve janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. Informacion jepet edhe nëpërmjet Sekretarisë mësimore si dhe takimeve që zhvillohen në Njësinë Bazë. Gjatë periudhës së rregjistrimit dhe gjatë javës së parë të viti akademik në Departamentin RRFTV / FAS, Dekani i Fakultetit apo përgjegjësi i Departamentit dhe personeli akademik bëjnë prezantimin e programit të studimit; gjatë studimeve pedagogu koordinator i departamentit bën orientime në lidhje me organizimin e programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Faqja Eëb e programit të studimit Bachelor në Regji Filmi & TV</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrën e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës gjatë së cilës prezantohet edhe plan programi i lëndës. Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij private të manaxhimit të ciklit akademik [Sistemi Pitagora] që nga regjistrimi në kurse, syllabusi i lëndëve, vlerësimet në secilin kurs deri në diplomim. FAS, me anën e rregulloreve të miratuara, vë në dispozicion kurrikulën e studimeve, planin mësimor, modulet dhe programin lëndor (syllabusin), ku përcaktohen objektivat e lëndëve, literatura e detyrueshme dhe ajo e sugjeruar, temat, orët e leksioneve/seminareve, organizimin në semestra si dhe kohëzgjatjen e kursit. Nga këto rregullore studentët marrin informacion të detajuar mbi dokumentacionin e nevojshëm për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në Rregulloren e FAS, Rregulloren e Departamentit RRFTV. I gjithë dokumentacioni dhe informacioni lidhur me programin e studimit është i publikuar online në faqen zyrtare të UART.</p> <p>Dokumentacioni <i>Faqja web e Departamentit RRFTV</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Qëllimi i UART është të sigurojë të gjithë studentët të përfitojnë nga cilësia e lartë në mësimdhënie përmes plotësimit të nevojave të tyre, për fitimin e kompetencave të rëndësishme për kërkesat e shoqërisë dhe tregut. Institucioni mbështet studentët për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Këtij qëllimi i shërbejnë marrëveshjet e rakorduara me institucione artistike dhe kulturore si dhe marrëveshjeve që UART ka realizuar me institucionet kulturore artistike në kuadër të nismës "Paktit Për Universitetin".</p> <p>Që gjatë periudhës së studimeve, studentët e FAS/ departamenti RRFTV janë përfshirë në jetën artistike kulturore të vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në shfaqje dhe aktivitete të tjera teatrore në tri institucionet kryesore të Tiranës (Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" dhe Teatri i Metropolit) apo teatro të rretheve dhe nismave të tjera private.</p> <p>Në ndihmë të këtij procesi një rol të madh kryejnë informacioni i marrë nga faqet e portalet e aksesueshme nga të gjithë studentët e UART, si dhe informacioni i afishuar pranë sekretarive mësimore.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.21 "Marrëveshjet me partnerët UART"</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve u ofrohet informacion i përditësuar për të gjithë mbarëvajtjen e procesit mësimor nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore mban kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programin e studimit.</p> <p>Përdorimi i sistemit Pitagora u mundëson studentëve të njoftohen në lidhje me afatet e regjistrimit, rregullat e regjistrimit, kurset e</p>




<p>në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>semestrit paraardhës si dhe detyrimet dhe penalitetet që rrjedhin nga mospagimi i detyrimeve. Gjithashtu, në sistem gjendet informacion në lidhje me oraret e regjistrimit të studentëve në fillim të çdo semestri dhe vlerësimi i studentëve për çdo kurs në përfundim të tij.</p> <p>Informacione të përditësuara, ose të reja u njoftohen studentëve nëpërmjet email-it zyrtar nga sekretaria mësimore.</p> <p>Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UART, u njoftohet studentëve nëpërmjet faqes zyrtare të ëeb-it të institucionit.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 2.1 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në RRFTV Faqa Eëb e Fakultetit të Artit Skenik Faqa Eëb e Departamentit RRFTV Faqa Eëb e njoftimeve të UART Faqa Eëb e Programit Bachelor në RRFTV</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstaton se informacioni në lidhje me programin e studimit është publik dhe mund të aksesohet prej kujtdo në çdo moment në faqen e internetit, nga çdo pajisje jo vetëm kur studentët janë fizikisht të pranishëm por edhe në distancë. Nga ana tjetër studentët e Programit të Studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV", aksesojnë sistemin Pitagora përmes aksesit që ata kanë në emalin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Për këtë shërbejnë jo vetëm sistemet e menaxhimit të procesit mësimor si PITAGORA, faqa zyrtare e Institucionit por edhe faqa në Facebook dhe Instagram e FAS dhe rrjetet sociale duke qenë se janë të aksesueshme nga shumica e studentëve. Qasja e studentëve në mësim mund të realizohet edhe nëpërmjet sistemit Microsoft Teams. Të gjithë studentët dhe pedagogët janë të pajisur me qasje në sistem online nga sektori TI i UART.</p> <p>Dokumentacioni <i>Faqja Eëb e Programit Bachelor në RRFTV Evidenca 3.13_ Screenshot nga Sistemi Pitagora Evidenca 4.19_ Manuali Pitagora</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Faqja zyrtare e UART, sistemi i menaxhimit që përdor IAL dhe stafi akademik ofrojnë për studentët informacion të plotë e të hollësishëm në lidhje me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i></p> <p><i>Informacioni gjendet në rregulloret e miratuara, është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit, ose jepet nëpërmjet Sekretarisë mësimore si dhe takimeve që zhvillohen në Njësinë Bazë.</i></p> <p><i>Po kështu, studentët informohen për kurrikulën e studimeve në detaje. Pjesë e rëndësishme e informimit është njohja e studentëve me</i></p>




	<p><i>kërkesat që ka tregu i punës. Institucioni mbështet studentët për orientimin në tregun e punës. Këtij qëllimi i shërbejnë marrëveshjet e rakorduara me institucione artistike dhe kulturore si dhe marrëveshjeve që UART ka realizuar me institucionet kulturore artistike në kuadër të nismës "Paktit Për Universitetin".</i></p> <p><i>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet nëpërmjet sistemit Pitagora, si dhe manuali i përdorimit të sistemit. Ky sistem dhe rrjete sociale përdoren për ofrim në mënyrë të vazhdueshme të informacionit të përditësuar edhe kur studentët janë në distancë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Sektori i Statistikës dhe të Informacionit, në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe SJIP-A mban në mënyrë të detajuar të dhëna statistikore mbi veprimtarinë vjetore në UART në tërësi dhe për secilin fakultet. Mënyra e mbajtjes, ruajtjes dhe përcjelljes së këtyre statistikave bëhet sipas rregullave dhe udhëzimeve në fuqi. Për arsye të brendshme të sigurimit të cilësisë dhe për nevoja të analizave vjetore edhe fakultetet mbajnë në mënyrë më të thjeshtuar në sekretaritë e tyre mësimore statistika në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Mbajtja e këtyre statistikave nga fakultetet bëhet për periudha më afatshkurtra në shërbim të programeve dhe cikleve të ndryshme të studimit. Për arsye të natyrës sensitive dhe ruajtjes së konfidencialitetit këto të dhëna jo gjithmonë bëhen publike.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.14 "Statistika FAS Për numrin e studentëve dhe të diplomuarve 2022-2025"</i> <i>"Faqja ueb e Drejtorisë së Menaxhimittë Burimeve Njerëzore dhe SJIP-A.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e	Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në Sekretarinë Mësimore. GVJ ndërmori një vizitë në Sekretarinë Mësimore që administron të dhënat e studentëve nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në

<p>tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Programi ka të rregjistruar për vitin 2022-2023 - 8 studentë, 2023-2024 - 8 studentë, 2024-2025 - 8 studentë. Nuk ka studentë të larguar, vetëm një student është transferuar në vitin e tretë. Programi ka gjithsej 24 studentë. Të dhënat janë marrë nga tabela 21 te aneks tabelat por u konfirmuan edhe kur ishin në vizitën në sekretarinë mësimore.</p> <p>GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studentëve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe tërheqja e saj me suplementin e diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar. Këto të dhëna ruhen në hard copy dhe formë elektronike.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.14 "Statistika FAS për numrin e studentëve dhe tëdiplomuarve 2022-2025"</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve mbahen në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin "Për Arkivat" dhe janë objekt kontrolli. Ky proces realizohet nga personat e autorizuar, të cilët në përfundim të sezoneve të provimeve dhe riprovimeve mbledhin procesverbalet ku studenti është vlerësuar me notë dhe i hedhin në bazën elektronike të të dhënave. Të dhënat ruhen edhe në sistemin e menaxhimit të universitetit Pitagora që ofrohet nga RASH dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe vërtetësinë e të dhënave. Informatizimi i shërbimeve për administrimin e Studimeve dhe Kurrikulës, ka filluar zbatimin që nga viti 2013. UART ishte një ndër Institucionet e para të Arsimit të Lartë publik i cili implementoi sistemin online të hedhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave. Digjitalizimi i sekretarive mësimore ka sjellë saktësim të të dhënave, shpejtësi në komunikim dhe krijimin e arkivës digjitale.</p> <p>Disa nga funksionalitetet për studentët që mundëson sistemi Pitagora janë: regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. Në përfundim të vitit akademik, strukturat përgjegjëse prodhojnë raporte lidhur me cilësinë në hyrje të studentëve dhe atë në dalje, si dhe punësimin e tyre në profil apo jashtë profili.</p> <p>Bazuar në politikat e sigurisë dhe të ruajtjes së informacionit këto të dhëna janë konfidenciale, por njëkohësisht edhe të verifikueshme nga</p>




	<p>personat e autorizuar. Dokumentacioni <i>Evidenca 3.13 Screenshot nga Sistemi Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Senati Akademik në Universitetin e Arteve, ka miratuar Rregulloren e Sektorit Mësimor, e cila përcakton se është ky sektor kryen kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Ky sektor kryen here pas here kontrole në përfundim të vitit akademik, në sekretaritë mësimore duke vëzhguar nga afër aktrimstrat e arritjeve akademike (regjistri i notave) duke krahasuar me një sistem të rastësishëm se si janë hedhur notat në këtë aktrimstër nga stafi i sekretarisë. Deri më tani nuk është vërejtur asnjë problem serioz në keq hedhjen e notave apo edhe të ndryshimit të tyre. Dokumentacioni <i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit si edhe pas takimeve me GVB dhe Stafin akademik, GVJ konstaton se Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti RRFTV në mënyrë periodike merr në shqyrtim dhe analizon ecurinë e procesit mësimor kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Raporti paraqet dhe pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike në Departamentin RRFTV, procesin e mësimdhënies dhe të nxënies; përqindjen e të diplomuarve; numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit; numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron FAS/ RRFTV; pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre; cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre. Eksperienca e Alumni është një vlerë për të vlerësuar dijet dhe aftësitë që ata kanë marrë gjatë periudhës së studimeve në Programin përkatës. Për këtë arsye propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të mirëpritura. Dokumentacioni <i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Spektori i Statistikës dhe të Informacionit, në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe SJIP-A mban në mënyrë të detajuar të dhëna statistikore mbi veprimtarinë vjetore në UART në tërësi dhe për secilin fakultet. Mënyra e mbajtjes, ruajtjes dhe përcjelljes së këtyre statistikave bëhet sipas rregullave dhe udhëzimeve në fuqi. Bazuar në Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e brendshme të</i></p>

	<p>FAS, është krijuar baza e të dhënave mbi numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimi dhe numrin e studentëve, të cilët tërhiqen, transferohen apo nuk e përfundojnë ciklin e studimeve.</p> <p>Të dhënat e studentëve mbahen në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin "Për Arkivat" dhe janë objekt kontrolli. Të dhënat statistikore në lidhje me ecurinë e studentëve ruhen si në formën elektronike dhe fizike.</p> <p>Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti RRFTV në mënyrë periodike merr në shqyrtim dhe analizon ecurinë e procesit mësimor kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Rregullorja e UART parashikon përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të tij në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat u japin këshillave të studentëve të drejtën të promovojnë dhe koordinojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet e UART-së dhe njësisve kryesore si dhe të shprehin mendimet e tyre në lidhje me rregulloret, veprimtaritë mësimore, programet e studimit apo dhe tema të cilat prekin jetën e tyre studentore. Gjithashtu, studentët kanë të drejtën të marrin pjesë në zgjedhjen e Drejtuesit të njësisë kryesore dhe Rektorit të Universitetit</p> <p>Që në miratimin e Statutit të ri më 30.08.2021, studentët përfaqësohen në të gjitha nivelet në UART, duke filluar që nga Senati Akademik (2 studente), Këshilli i Etikës (1 student), Këshilli Studentor, etj. Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.1 "Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015-Kreu IX"</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART-Kreu IX"</i></p> <p><i>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin</p>	<p>UART garanton që pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik është reale. Mënyra e zhvillimit të mësimin, numrat e ulët të studentëve në klasa apo grupe mësimore, përfshirja e studentëve në aktivitete të përbashkëta me pedagogët, krijon raporte të afërta dhe lejon shkëmbim më të lirshëm të ideve dhe rrahje të mendimeve.</p>

<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët kanë organizmin e tyre, Këshillin Studentor. Me VSA Nr.22, datë 07.10.2021, është miratuar Rregullorja e Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët që garanton dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UART dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë.</p> <p>Gjithashtu, studentët kanë të drejtë të japin vlerësimin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të programit. Kjo realizohet përmes pyetësorëve që u shpërndahen nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë. Në këta pyetësorë studentët japin mendimin e tyre të pavarur duke qenë se pedagogu nuk është i pranishëm në sallë. Pyetësorët përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë e cila nxjerr përfundimet në lidhje me këtë vlerësim.</p> <p>Nje tjetër formë është dhe ajo e përfaqësimit me një anëtar grupi pune në grupet e punës të vlerësimit të brendshëm të akreditimeve të programeve apo akreditimit institucional.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor "</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS nga Sektori Mësimor"</i> <i>Evidenca 1.9. 1 "Urdhri i Dekanit Nr. 255 Prot. dt. 03/02/2025 për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm "</i> <i>Evidenca 5.17 "VSA Nr 22, datë 07.10.2021 "Mbi miratimin e Rregullores të funksionimit të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentë në UART</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik të FAS, GVJ konstatoi se përditësimi i kurrikulës së programeve të studimit në FAS realizohet në mënyrë periodike. Njësia përgjegjëse është Sektori Mësimor i cili garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Opinioni i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nga stafi akademik, titullarët e lëndëve, koordinatorët e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj. Ndyshimet afatshkurtër në programin e studimit reflektohen nga titullari i lëndës në syllabuset e lëndëve. Sektori Mësimor organizon sondazhe nëpërmjet pyetësorëve për të mbledhur të dhëna lidhur me mësimdhënien, programet e studimit, facilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera. Gjetjet e këtij raporti i bëhen të ditura nëpërmjet një raporti Rektorit UART.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor"</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS nga Sektori Mësimor"</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u</p>	<p>Bazuar në takimin që GVJ pati me studentët, konstatohet që FAS</p>

<p>mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>garanton transparencë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Rregullorja e UART u garanton studentëve të drejtën e shprehjes së mendimit mbi ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimimit të rezultatit.</p> <p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve shprehet në rregulloret e UART, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë. Vlerësimi i studenteve kryhet nëpërmjet: provimit, nivelit të aktivizimit në seminare/leksione (tek lëndët teorike), provimeve të prapambetura (tek lëndët teorike), etj. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni i provimit të lëndës, jo më vonë se tre dite pune nga data e dhënies së provimit.</p> <p>Studenti ballafaqohet me rezultatin dhe sigurohet për transparencën e vlerësimit duke marrë sqarimet e duhura. Gjithashtu, Rregullorja e programit u njeh të drejtën të ankimojnë rezultatet sipas një procedure të caktuar. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit. Në rast se pretendohen shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit apo vlerësimit, studenti ia drejton ankesën Drejtuesit të Njësisë Kryesore.</p> <p>Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar regjistrimet (në lëndët profesionale) apo përgjigjet e dokumentuara (në lëndët teorike).</p> <p>Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i njësisë bazë, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS"</i> <i>Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka procedurë dhe njësi të posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve. Studentët janë të informuar mirë dhe të angazhuar si në rand universiteti ashtu edhe në Fakultet. Drejtoria mësimore është përgjegjëse për komunikimin e vazhdueshëm me studentët duke i informuar lidhur me programin e studimit. Përgjegjësi i Departamentit dhe stafi akademik i Departamentit ndihmojnë studentët përmes informimit dhe shërbimit të nevojshëm për mbarëvajtjen e studimeve dhe procesit mësimor.</i></p> <p><i>Opinionet e studentëve vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nga stafi akademik. Aja janë pjestarë aktivë në organet kolegjiale të institucionit.</i></p> <p><i>UART/ FAS garanton transparencë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, e shprehur në rregulloret dhe e zbatuar në praktikë. Rregullorja e UART u garanton studentëve të drejtën e shprehjes së mendimit mbi ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimimit të rezultatit.</i></p>

	<i>Duke qënë se Fakulteti ka numur të vogël studentësh është krijuar një komunitet gjithëpërfshirës ku komunikimi midis të gjithë aktorëve është i lehtë dhe efektiv.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Universiteti i Arteve ka ngritur njësi që informojnë dhe u shërbejnë studentëve si: Sekretaria Mësimore dhe Sektori Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe strukturën e Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Koordinatorin Institucional. Këto zyra ndjekin ecurinë e studentit, që nga moment i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike, në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore. Sipas rregullores së sektorit mësimor, ky sektor ka si detyrë: Ndjekjen, gjurmimin dhe rritjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar.</p> <p>Gjithashtu Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Artit Skenik është në lidhje të vazhdueshme me studentët, i asiston me procedurat e regjistrimit në fillim të semestrit, me procesin mësimor dhe administron dokumentat përkatëse.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i> <i>Evidenca 5.17 "VSA Nr 22, date 07.10.2021 "Mbi miratimin e Rregullores të funksionimit të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentë në UART"</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Studentët e FAS janë të informuar mirë dhe të kënaqur me mënyrën informimit dhe ndihmës që ju jepet në këtë drejtim. FAS/UART ka ngritur një sistem funksional për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit sipas specifikave ai ka. Përveç Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe njësinë e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatorin Institucional, përdoret me efikasitet të plotë faqja e web-it të UART si dhe së fundmi sistemi "PITAGORA" në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqiptar. Në lidhje të ngushtë me të gjitha njësitë përbërëse të UART, ky Sektor zbaton nder të tjera edhe detyrat më poshtë:</p>

	<p>Ndjekjen e të gjitha problemeve që lidhen me procesin mësimor dhe fushën akademike në Universitetin e Arteve në bashkëpunim të ngushtë me Zëvendës Rektorin për anën mësimore; Ndjekjen dhe koordinimin e të gjitha problemeve që lidhen Kurrikulën sipas përcaktimit ligjor dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Njësia e Informimitte Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatori Institucional mbështet studentët në menyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me përfundimin e procesit mësimor dhe orientimin në tregun e punës. Sektori Mësimor ka si detyrë të vet mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë; drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve; mbajtjen e komunikimit me tregun e punës, si dhe ofrimin e asistencës në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e artit dhe kulturës. Studentëve u jepet informacion i plotë mbi çdo që ka të bëjë me licensimin e programeve; mundësitë e karrierës dhe punësimit; akreditimin e institucionit dhe procesin për herë të parë të akreditimit të programeve të studimit; marrëveshjet e bashkëpunimit; njohjen e krediteve; etj. Po ashtu zyra ruan lidhje të ngushta me Këshillin Studentor dhe bashkëpunon me atë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu Sektori Mësimor bashkëbisedon me studentët e viteve të para për t'u prezantuar atyre: institucionin, programet, mundësitë e punësimit etj. Në bashkëpunim me struktura të tjera institucionale ndjek aktivitetet e zhvilluara prej studentëve dhe njëkohësisht pas përfundimit të studimeve, ndjek dhe ecurinë e punësimit dhe zhvillimit të tyre të karrierës.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i> <i>Evidenca 1. 15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit"</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron nga komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj.</p> <p>Çdo vit, struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, harton plane pune dhe raporte vjetore, të cilat përfshijnë analiza të detajuara mbi procesin e gjurmimit të studentëve të diplomuar. Këto dokumente përfaqësojnë një burim të rëndësishëm informacioni për të kuptuar më mirë zhvillimin profesional dhe akademik të ish studentëve pas përfundimit të studimeve. Evidentohet niveli i punësimit të tyre të</p>




	<p>diplomuarve, sektori i punësimit (publik, privat, vetëpunësim) si dhe përputhshmëria midis programit të studimit dhe vendit të punës. Të dhënat e përfituara ndihmojnë gjithashtu në identifikimin e sfidave me të cilat studentët përballen në tregun e punës, duke i krijuar institucionit mundësinë e përshtatjes dhe përmirësimit të programeve të studimit. Raportet vjetore shërbejnë si një mjet strategjik për rritjen e cilësisë dhe zhvillimin e institucionit. Ato mund t'u vihen në dispozicion edhe organeve përkatëse si Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Akreditimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë apo partner të tjerë duke dëshmuar angazhimin e herëpashershëm të UART në mbështetjen e vazhdueshme të studentëve edhe pas diplomimit të tyre.</p> <p>Studentët e diplomuar të Universitetit të Arteve janë të gjithë artistë të mirëfilltë si dhe specialistë të lartë të fushës së mësuesisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. Gjithashtu UART është pjesë e rëndësishme e projektit GRADUA, projekt i cili do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet: Grumbullimit dhe analizimit të të dhënave për performancën e të diplomuarve dhe universiteteve, duke mundësuar lëshimin e dokumentacionit të besueshëm, të vazhdueshëm dhe të përditësuar për vlerësimin e sistemit të arsimit të lartë në mbështetje të procesit të reformave në vazhdim; Lehtësimin të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe botës së biznesit; Lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës. Mbështetur në këtë projekt, kjo ndjekje/gjurmim do të ndihmojë në: Organizimin e informacionit, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm dhe efektiv të sistemit të trajnimit dhe tregut të punës; Ndërlidhjen dhe parashikimin e aftësive të nevojshme në të ardhmen për të përshtatur të diplomuarit në më të mirën e mundshme me tregun e punës; Mbështetjen duke krijuar një model të përputhshmërisë së kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UART ka ngritur struktura të nevojshme funksionale për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Sekretaria mësimore së bashku me departamentin në vazhdimësi ofrojnë mbështetje për studentët. Përgjegjësi i Departmentit dhe pedagogët janë disa nga mjetet për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Në takimet me studentët dhe pedagogët u theksua fakti se komunikim dhe mbështetja e studentëve në këtë program studimi është i arritshëm lehtë</i></p>




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se Statuti i UART (neni 68, Kreu X) parashikon dispozita të veçanta për sa i përket zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. Gjithashtu gjithë rregulloret e miratuara dhe funksionale përcaktojnë se, nisur dhe nga specifika e programeve të këtij uviversiteti , personeli akademik “ka të drejtë të përcaktojë lirisht metodat e procesit mësimor” (Statuti, neni 68, pika 2, 3)</p> <p>Universiteti zbaton një filozofi mësimore novatore, duke integruar qasje bashkëkohore dhe teknologji të avancuara për të përgatitur studentët në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e artit dhe skenës. Në lidhje me mësimdhënien UART mbështet dhe nxit përdorimin e metodave aktive, që nxisin dhe zhvillojnë talentin e studentit.</p> <p>Duke qenë se çdo lëndë ka specifikat e saj, pedagogu zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, duke kombinuar aspektin teorik më atë praktik.</p> <p>FAS/Departamenti i RRFTV operon mbi një strukturë akademike, e cila përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e shoqërisë dhe evolucionin e formave të reja të shprehjes artistike.</p> <p>Stafi akademik, i përbërë nga profesionistë me përvojë në fushën e regjisë skenike dhe filmit, zbaton metoda të shumëllojshme psikopedagogjike për të nxitur zhvillimin e aftësive teknike dhe krijuese të studentëve.</p> <p>Programi mësimor, syllabuset, përvoja praktike ndërtohen mbi përdorimin e metodave inovative.</p> <p>Gjithashtu një kërkesë e domosdoshme për zhvillimin profesional dhe artistik të personelit akademik është pjesmarrja aktive dhe bashkëpunimi në aktivitete artistiko shkencore të departamentit dhe Fakultetit.</p>

Leone!

[Signature]

	<p>Nuk ka “udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme” por mendojmë se filozofia e punës, drejtimit dhe organizimit në Institucion, bazuar në specifikën e tij, është nxitja dhe mbështetja e metodave gjithëpërfshirëse që mbështesin mësimin me qender studentin me synim përgatitjen e regjizorëve të aftë (Programi në fjalë)</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.15 Rregullore mesimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART</i></p> <p><i>Evidenca 1.16 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. RRFTV</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 “Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Regji Filmi & TV Evidenca 1.19-Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.9 Manuali i Programit Online Microsoft Teams.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies dhe performanca e stafit akademik vlerësohet në mënyrë periodike të vazhdueshme nga strukturat dhe mekanizma që bazohen në Statutin e UART.</p> <p>Për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e procesit mësimor, strukturat përgjegjëse zbatojnë mekanizma të vazhdueshëm vlerësimi, duke përmirësuar metodologjinë pedagogjike në përputhje me kërkesat e zhvillimeve më të fundit në skenën është realizimi i sondazheve periodike, në të cilat pedagogëve, struktura të lëndëve dhe ndikimin e tyre në zhvillimin profesional të studenteve.</p> <p>Ky vlerësim kryhet përmes plotësimit nga ana e stafit akademik të formularit të vetëvlerësimit ku raportohet mbi arritjet akademike e artistike të tyre gjatë vitit të fundit, pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, si dhe analizat e departamentit.</p> <p>Ndërveprimi i drejtpërdrejtë me pedagogët dhe puna në grup u japin studentëve besimin dhe kompetencat e nevojshme për të ndërtuar një qasje të personalizuar ndaj regjizurës teatrore dhe për të vlerësuar më objektivist personelin akademik dhe ndihmësakademik</p> <p>Përmes këtyre mekanizmave dhe nismave, FAS dhe Departamenti RRFTV siguron që mësimdhënia të jetë në nivel të lartë akademik, duke pasqyruar tendencat më të reja në artin skenik dhe në formimin e regjizorëve të aftë.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve/teatrale të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve</i></p>




	<p><i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"</i> <i>Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësorët e stafit akademik në FAS"</i> <i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performances vjetore"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> <p>Në programin Bachelor në "Regji Filmi dhe Televizioni" studentët përfshihen aktivisht në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe të ankimimeve të cilat janë përcaktuar në Rregulloren e institucionit dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë. Studentët luajnë një rol kyç në vlerësimin e cilësisë akademike, duke dhënë opinione mbi metodologji të pedagogjike, qasjen e stafit akademik dhe efektivitetin e kurrikulës përmes anketave dhe sondazheve të organizuara nga Sektori Mësimor. Këto mekanizma sigurojnë një mjedis të hapur dhe transparent. Universiteti i Arteve garanton përfshirjen aktive të studentëve në të gjitha aspektet e zhvillimit të programit Bsc në "Regji Filmi dhe Tv" duke siguruar që metodat e mësimdhënies të jenë dinamike dhe të përditësuara me kërkesat bashkëkohore të teatrit në fushën e interpretimit.</p> <p>Studentët janë të përfshirë në të gjithë strukturat vendimarrëse kolegjiale të UART-së. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve.</p> <p>Përmes këtij sistemi të zhvilluar të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, UART siguron një proces të vazhdueshëm për përshtatjen e metodave akademike me kërkesat dhe standardet bashkëkohore të arsimit të lartë, duke u mbështetur në profesionalizmin e strukturave të specializuara dhe duke ruajtur një kulturë të përkushtuar ndaj ekselencës akademike.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 6.4 'Foto nga takimet informuese me Sektorin Mësimor</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"</i> <i>Evidences 1.25 'Raportet e vlerësimit të performancës vjetore</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve, si dhe Dekanëve përkatës nga Drejtoria e Kurrikulës.</p> <p>Një komponent esencial i monitorimit të cilësisë është raporti vjetor i analizës së departamenteve, i cili është një proces i rregullt dhe i institucionalizuar. Ky raport hartohet nga njësitë bazë të universitetit për çdo vit akademik dhe, pas shqyrtimit të hollësishëm, kalon për vlerësim në Senatin Akademik. Analiza përfshin vlerësimin e aspekteve kyçe të programeve të studimit. Në kuadër të transparencës raportet vjetore publikohen në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.</p>




	<p>Ky proces është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së llogaridhënies institucionale dhe ofron një pamje të qartë për performancën akademike për të gjithë palët e interesuara.</p> <p>Përmes këtij sistemi të zhvilluar të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, UART siguron një proces të vazhdueshëm për përshtatjen e metodave me kërkesat dhe standardet bashkëkohore të arsimit të lartë, duke u mbështetur në profesionalizmin e strukturave të specializuara dhe duke ruajtur një kulturë të përkushtuar ndaj ekselencës akademike.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 6.4 'Foto nga takimet informuese me Sektorin Mesimor</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"</i> <i>Evidences 1.25 'Raportet e vlerësimit të performancës vjetore</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Përdorimi i instrumenteve të strukturuar, si pyetësoret dhe analizat e performancës akademike, mundëson realizimin e monitorimit të cilësisë në programet e studimit dhe metodologjite e mësimdhënies. Ky proces është esencial për identifikimin e praktikave më të suksesshme e aspekteve që kërkojnë përmirësim, duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të metodave pedagogjike. Promovimi i përvojave më të mira ndikon në nxitjen e personelit akademik dhe ndihmës akademik në rritjen e cilësisë së shërbimit.</p> <p>Departamenti ka një rol të rëndësishëm në ndihmë të stafit akademik për të përmirësuar qasjet didaktike, për përditësimin e përmbajtjes së programeve dhe adaptimin e praktikave më të mira.</p> <p>Programet akademike sigurojnë që të jenë gjithmonë të përditesuara dhe të përshtatura me nevojat e ndryshueshme të tregut, falë kesaj strategjie, që ofron një balance të qëndrueshme ndërmjet teorisë dhe zhvillimit të aftësive praktike të domosdoshme për suksesin profesional të studentëve.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore "</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pasi u njoh me dokumentacionin arrin në përfundimin se nga institucioni ka në vazhdimësi përpjekje për një mësimdhënie sa më cilësore. Madje rëndësia shprehet dukshëm në faktin që në statutin e UART neni 68 i kushtohet rëndësi e veçantë mësimdhënies dhe metodave që përdoren me qëllim rritjen e cilësisë së programit. Për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies njëherazi janë ngritur edhe struktura të posaçme që monitorojnë procesin e mësimdhënies. Nga personeli akademik ka përpjekje që metodat e përdorura të jenë sa më innovative. Pjesë e provesit të vlerësimit janë edhe studentët të cilët nëpërmjet pyetësorëve shprehin mendimet e tyre. Departamenti luan rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit të mësimdhënies dhe në ndihmë të stafit akademik nëpërmjet trajnimeve për të përsosur metodat e mësimdhënies. Gjithashtu në praktikën e tyre është edhe promovimi i përvojave positive.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UART, në përputhje me kuadrin ligjor dhe udhëzimet në fuqi, ka zbatuar një sistem të brendshëm të strukturuar për sigurimin e cilësisë. Sistemi i ngritur ka për qëllim garantimin e standardeve të larta akademike, artistike dhe shkencore, duke e përshtatur aktivitetin e tij me kërkesat dhe objektivat që përcakton institucioni.</p> <p>Në këtë kuadër, Sektori Mësimor, Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) bashkëpunojnë ngushtë me departamentet dhe fakultetet për siguruar një menaxhim të efektshëm të cilësisë. Ky bashkëpunim është thelbësor për zbatimin e politikave dhe procedurave të përcaktuara. UART përzgjedh përfaqësues nga këto struktura për të qenë pjesë e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPSBC).</p> <p>Si një proces gjithëpërfshirës, sigurimi i cilësisë në UART zbatohet në përputhje me Kodin e Cilësisë.</p> <p>Angazhimi i Universitetit të Arteve për sigurimin e cilësisë brenda institucionit, i përshtatur me kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë, vërtetohet nëpërmjet kësaj strukture të mirëorganizuar dhe funksionale, e cila siguron politika, sisteme dhe procedura te qarta.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i></p> <p><i>Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësies së Sigurimit te Brendshëm të Cilësisë"</i></p> <p><i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i></p> <p><i>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësies Kryesore FAS"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. UART ka ngritur një sistem funksional për menaxhimin e cilësisë në procesin mësimor, ku secili element, si njesitë administrative, stafin akademik, studentët ka përgjegjësitë e tij të qarta. Përbërëse të këtij procesi janë Departamentet, të cilat nderveprojnë ngushtë me Sektorin Mësimor, Kurrikulave dhe Infomimit për Studentet, Alumni-n, Njësine Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Sekretarinë Mësimore të Fakultetit</p>

	<p>dhe Komisionin Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPSBC). Të gjitha këto struktura kanë role të qarta të përcaktuara në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike, në përputhje me rregullat dhe ligjet e brendshme të institucionit.</p> <p>Departamentet realizojnë analizat e ecurisë mësimore me qëllim përditësimin e programeve, ku stafi pedagogjik ofron reflektime mbi sfidat dhe propozime. Pedagogët e ftuar, profesionistë të njohur në fushën e artit, kontribuojnë në përditësimin dhe përshtatjen e programeve të lëndëve për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e regjisë së filmit dhe televizionit. Po kështu merren parasysh dhe reflektohen sugjerimet dhe komentet e studentëve për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor .</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i> <i>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS"</i> <i>Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i> <i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Strategjia e zhvillimit të UART, Statuti dhe rregulloret bazuar në to trajtojnë në mënyrë të veçantë sigurimin e cilësisë së Institucionit. Në lidhje me sigurimin e jashtëm të cilësisë , UART ndjek të gjitha udhëzimet për të realizuar Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet nga ASCAL, afatet, procedurat, llojet e akreditimit janë të përcaktuara në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.17, datë 24.03.2022 “Për akreditimin periodik Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve” Tiranë, është vendosur Akreditimi Institucional i UART, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit Institucional është 23/03/2028.</p> <p>Ky rezultat tregon për një performancë të qëndrueshme të institucionit. Për të ruajtur cilësinë, universiteti realizon analizat dhe vlerësimet periodike të efektivitetit të programeve të studimit, me qëllimin për të ofruar një zhvillim të vazhdueshëm dhe të përmirësim në fushën akademike.</p> <p>Puna e bërë për hartimin e RVB dhe DVV, ku janë përfshirë pedagogë, punonjës ndihmës akademik dhe studentë, është tregues i veprimtarisë së vazhdueshme për të siguruar cilësinë.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i> <i>Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit"</i> <i>Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i></p>




	<p><i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor"</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"</i> <i>Evidenca 2.7 Vendim i BA te ASCAL per Akreditimin Institucional te UART"</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me përfaqësues nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ gjykon që UART ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe veprimtari artistike për monitorimin e standarteve të cilësisë.</p> <p>Disa nga metodat që UART aplikon për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, -vlerësimi i kurrikulës, syllabuseve, leksioneve, literaturës së përdorur -vlerësimi i përvetësimit e të mësuarit, - vëzhgime në skenë gjatë kryerjes së performancave të ndryshme, -vet raportimi i pedagogëve për veprimtarinë akademike, shkencore dhe artistryke të zhvilluar <p>UART për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta si psh.sondazhe të studentëve që ndjekin programin e studimit, takimet me Alumni.</p> <p>Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit është një proces që kryhet rregullisht, për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e tyre. Në kuadër të departamenteve, procesi përmirësimit të programeve bazohet në analiza të hollësishme dhe diskutime që pasqyrojnë ndryshimet në fushën e artit, duke marreparasysh përvojat dhe vlerësimet e viteve te kaluara.</p> <p>Këto kritere garantojnë që çdo ndryshim në kurrikulë të realizohet me qëllimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe zhvillimit te aftësive profesionale te studentëve.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i> <i>Evidenca 5.18 "Raporti vjetor Alumni"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UART ka ngritur struktura institucionale funksionale si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe Koordinatorët e Programeve të Studimit, të cilat funksionojnë sipas rregulloreve të</i></p>




	<p><i>brendshme institucionale.</i></p> <p><i>NjBSC-ja ka si mision parësor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në UAMD duke përfshirë të gjithë aktorët e angazhuar në këtë proces të vazhdueshëm siç janë: studentët, pedagogët, alumni dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm.</i></p> <p><i>UART i është nënshtruar procesit të Akreditimit Institucional në vitin 2022 dhe ka dalë e suksesshme duke u akredituar për 6 vite akademike në përfundim të procesit të akreditimit. Programi Bachelor në "Regji Filmi dhe Tv" nuk i është nënshtruar asnjë akreditimi të mëparshëm.</i></p> <p><i>Në mënyrë të përvitshme, institucioni harton raportet e veprimtarisë institucionale ku përfshihen analiza e procesit mësimor dhe shkencor dhe artistik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UART, nëpërmjet strukturave funksionale të sigurimit të cilësisë të programeve të studimit, ndjek në vazhdimësi përditësimin dhe zbatimin cilësor të tyre për të siguruar përputhshmërinë me standardet akademike, kërkesat e tregut si dhe kërkesat për akreditim.</p> <p>Mekanizmat e procesit të monitorimit përfshijnë anketat e studentëve dhe stafit akademik, analizat vjetore të performancës në mësim dhe raportet e detajuara të departamenteve akademike.</p> <p>Departamentet i zbardhin dhe i përmbledhin keto informacione në një raport final. Senati Akademik shqyrton dhe miraton këtë raport, duke siguruar që çdo vendim për përmirësimin e programeve të studimit të jetë i bazuar në një proces të strukturuar dhe me të dhëna të besueshme.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART</i></p> <p><i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS</i></p> <p><i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore"</i></p>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit	Ruajtja e standardeve akademike në Universitetin e Arteve mbështetet

<p>duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>mbi një sistem të mirëorganizuar vëzhgimi dhe vlerësimi, i cili konsiderohet thelbësor për rritjen dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p>Raportet e vlerësimit të performancës vjetore të Institucionit paraqesin një analizë të hollësishme mbi rezultatet e pritura, duke u fokusuar si në përmirësimin e fushave me nevoja specifike, ashtu edhe në evidentimin e përparësive institucionale. Këto analiza vënë në dukje se punohet në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit të Arteve.</p> <p>Vlerësimi realizohet përmes metodave të qarta dhe objektive, duke përfshirë analiza të ndryshme, si anketat me studentët dhe pedagogët, raportet mbi ecurinë akademike të departamenteve dhe fakulteteve, studimet kërkimore në fushën e artit, si dhe mbledhjen e projekteve artistike të realizuara nga stafi akademik apo si edhe vlerësimi i punëve artistike të studentëve në lidhje me programin e tyre të studimit.</p> <p>Institucioni u mbështet studentët dhe pedagogët për t'u angazhuar në projekte artistike, duke nxitur promovimin dhe shfaqjen e krijimeve. Gjithashtu përditësimin e kurrikulave duke e përafuar nevojat e tregut, zhvillimi profesional akademik dhe artistik i stafit pedagogjik, si dhe përmirësimi i infrastruktures mësimore janë masa që merren për të përmirësuar cilësinë në vazhdim.</p> <p>Ruajtja e standardeve akademike realizohet përmes monitorimit të vazhdueshëm, duke pasqyruar angazhimin e universitetit për rritjen e cilësisë në arsimin elartë artistik.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mesimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara</p>	<p>Referuar DVV si dhe takimeve me studentë dhe pedagogë GVJ konstaton se UART përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në "Regji Filmi & TV". UART duke u bazuar në Rregulloren e miratuar, përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Për të garantuar një vlerësim të plotë, UART përdor: Monitorimi i procesit të mesimdhënies, Vlerësimi i çdo lëndë nga studentët, Analiza e rezultateve të studentëve në provime, Vlerësimi i arritjeve të studentëve bë detyrat e kryera gjatë zhvillimit të programit (të tilla si detyrat kursi, projektet, punet individuale dhe ato në grup), Vëzhgimi i performances gjatë praktikave, Rezultatet nga punimet e diplomës.</p> <p>Për më tepër, Sektori i Mësimor, i Kurrikulës, Informimit organizon vlerësime periodike mbi integritet të diplomuarve në tregun e punës dhe menaxhon një databazë për të punësuarit, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm mbi zhvillimin e tyre profesional. Pedagogët e jashtëm, si profesionistë me përvojë të spikatur në fushën e tyre, ndikojnë dukshëm në ngritjen e cilësisë së programeve akademike, duke sjellë ekspertizen e tyre për të përmirësuar dhe zhvilluar procesin mësimor si dhe për përditësimin e tij.</p>

dhe të tjera.	<p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.25 "Raportet e vleresimit të performancës vjetore"</i></p> <p><i>Evidenca 5.13 "Open Day UART Dhjetor2024"</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve"</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mbështetur nga njësite kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> – organizon pyetësorë drejtuar studentëve për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe vlefshmërine e tij tek ALUMNI – organizon ëorkshope/masterclasses ku mbledh sugjerimet dhe kërkesat në lidhje me programet e studimeve. <p>Gjithashtu, institucioni vlerëson feedback-un dhe sugjerimet që merren gjatë aktiviteteve artistike dhe projekteve në bashkëpunim me institucionet me të cilat janë lidhur marrëveshje nga UART.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor"</i></p> <p><i>Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësorët e stafit akademik në FAS"</i></p> <p><i>Evidenca 1.21 "Marrëveshjet me partnerët UART"</i></p> <p><i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor "</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve"</i></p> <p><i>Evidenca 3.3 "Aktivitete të workshopeve/masterklasave 2022-2024"</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se UART monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p> <p><i>Analiza vjetore mbi ecurinë e programit paraqesin një analizë të hollësishme mbi rezultatet e pritura, duke u fokusuar si në përmirësimin e fushave me nevoja specifike, ashtu edhe në evidentimin e përparësive institucionale. Këto analiza vënë në dukje se punohet në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit të Arteve.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson pozitivisht punën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përgatitjen e raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve të bëra. Gjithashtu tërheqja e mendimit të mjaft aktorëve në këtë proces i shërven përmisimit në vazhdim të tij.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale (Statuti dhe Rregullorja e UART, Kodi i Etikës dhe Rregullores së NJSBC dhe vizitat në institucion konstaton se në institucion funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel Institucional dhe në nivel Fakulteti.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) funksionon pranë Zyrës së Sektorit Mësimor, Kurrikulave dhe Informimit të Studentëve, duke vepruar në bazë të rregullores së saj. Kjo njësi ka për detyrë të sigurojë një mekanizëm të qartë për garantimin e cilësisë, duke përfshirë bashkëpunimin e të gjithë aktorëve, ka përfaqësues të studentëve në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC).</p> <p>Përfaqësimi i studentëve në çdo nivel të vendimmarrjes është i rëndësishëm. Studentët janë të përfaqësuar në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit NJSC e deri te GVB.</p> <p>GVJ konstaton që institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART</i> <i>Evidenca 6.5 " Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga takimet e kryera në institucion, GVJ konstaton se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucion kanë detyra të përcaktuara qartë në aktet rregullatore të brendshme.</p> <p>Universiteti i Arteve ka specifikuar përgjegjësitë e të gjitha strukturave përkatëse, duke përfshirë departamentet, individët, studentët dhe grupet e tjera të interesit.</p> <p>Strukturat e sistemit të sigurimit të cilësisë akademike, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPSBC), Sektori Mësimor i Kurrikulave, Informimit të Studentëve, si dhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), mbajnë përgjegjësi të qarta dhe funksione të përcaktuara të cilat janë parashtruar në statutin dhe rregulloret e brendshme të UART, duke mundur një koordinim efikas dhe një monitorim të vazhdueshëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>

	<p>Gjithashtu, stafi akademik dhe administrativ ka përgjegjësi të qarta në realizimin e objektivave të sigurimit të cilësisë, duke ndjekur procedura të përcaktuara për zbatimin efektiv të këtij procesi. Studentët janë pjesë aktive e këtij procesi dhe nëpërmjet pyetësorëve dhe vlerësimeve periodike ndihmojnë në identifikimin e aspekteve duhen përmirësuar dhe në përditësimin e programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i> <i>Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i> <i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i> <i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor"</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"</i> <i>Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësorët e stafit akademik në FAS"</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Regji Filmi dhe TV" janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentë. Strukturat e institucionit bashkëveprojnë në rritjen e cilësisë. Gjatë takimeve, GVJ konstatoi se personeli akademik dhe stafi administrativ menaxhojnë dhe zbatojnë procedurat e sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Drejtuesi i Fakultetit ka ngritur një grup të vlerësimit të brendshëm për të garantuar cilësinë në çdo proces akreditimi. Struktura e këtij grupi përfshin: tre pedagogët e programit të studimit, një anëtar nga drejtoria e kurrikulave (ndihmës-akademik dhe administrativ) dhe një studente.</p> <p>Metoda e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm ka analizuar dhe paraqitur cdo aspekt të vlerësimit të brendshëm dhe ka siguruar objektivitet dhe përfshirje. Kjo u konstatua dhe më takimin e grupit të grupit të vlerësimit të brendshëm të programit.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.9.1. " Urdhri i Dekani Nr. 255 Prot. dt. 03/02/2025 Për Ngritjen e Grupeve të Punës për Vlerësimin e Brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se në grupet e vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik.</p> <p>Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vetëvlerësimit nga ana e pedagogut, vlerësimit nga drejtuesit dhe nga studentët.</p> <p>Rregullorja e UART-së, Rregullorja e FAS , Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, garantojnë integritetin akademik dhe shmangin diskriminimin apo pabarazitë kundrejt personelit dhe</p>




	<p>studentëve. Ato garantojnë një pjesëmarrje të drejtë të personelit akademik, ndihmës akademik e të studentëve në këtë proces.</p> <p>GVJ nuk konstatoi raste discriminimi, por një ambient bashkëpunues dhe respektues për secilin individ.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.9.1. " Urdhri i Dekani Nr. 255 Prot. dt. 03/02/2025 Për Ngritjen e Grupeve të Punës per Vlerësimin e Brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimeve në institucion se në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshihen edhe ekspertë të jashtëm. UART ka zhvilluar bashkëpunime strategjike me figura kryesore të fushave të studimit, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Falë këtyre bashkëpunimeve, ekspertë të jashtëm kontribuojnë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë akademike, duke ofruar perspektiva të reja dhe përvoja të vlefshme që ndikojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit.</p> <p>Këta bashkëpunëtorë kontribuojnë me mendimet dhe ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së institucionit e cila realizohet nëpërmjet zhvillimit të ëorkshopeve dhe Masterclasses.</p> <p>Bashkëpunimi me Alumni është një mënyrë tjetër për të marrë mendime dhe sugjerime për programin.</p> <p>GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi realizon një vlerësim objektiv të programit të studimit dhe nevojave për përditësim të vazhdueshëm.</p> <p>Programi Bachelor në "Regji Filmi& TV", si pjesë e UART, zhvillon një bashkëpunim të vazhdueshëm akademik dhe profesional me institucione të njohura artistike. Ato kanë pasuruar përmbajtjen akademike dhe kanë ndihmuar në përshtatjen e programit me standardet më të avancuara ndërkombëtare.</p> <p>Përmes projekteve të mbështetura nga zyra e projekteve, si Erasmus+, është mundësuar zgjerimi i bashkëpunimi ndërkombëtar i institucionit dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i stafit dhe studentëve. Fakulteti i Artit Skenik fton ekspertë të jashtëm të japin kontributin e tyre si pedagogë me kohe të pjesshme dhe si mentorë akademikë.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 3.3 "Aktivitete të ëorkshopeve/master klasave 2022-2024</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ se UART garanton që procedurat e sigurimit të cilësisë të demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. Të gjitha strukturat e institucionit bashkëveprojnë dhe sigurojnë një shërbim cilësor në nxitjen dhe rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. Garantohet integriteti akademik dhe shmangjet diskriminimi apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve</i></p> <p><i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë synon evidentimin e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet</i></p>

	<i>vlerësimi periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore , duke përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm dhe specialistë të fushës së artit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>GVJ konstaton se politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit gjenden në faqen web të universitetit. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparent. Rregullorja e UART, Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, Plani Strategjik, kalendari akademik, Raportet e përvitshme vjetore dhe të gjitha vendimet e Senatit afishohen në platformen zyrtare të universitetit, ndërsa vendimet në nivel rektorati apo dekanati shpërndahen përmes postës elektronike .</p> <p>Shpërndarja e informacionit mbi veprimtaritë akademike dhe artistike të programit shpërndahen si në faqen zyrtare te universitetit, ashtu edhe në rrjetet sociale. Programi sezonal i aktiviteteve artistike, i koordinuar nga strukturat akademike, bëhet publik paraprakisht dhe shpërndahet përmes njoftimeve zyrtare të universitetit, për të siguruar një informim dhe pjesmarrje më të gjërë të studentëve.</p> <p>Kjo ka mundësuar që studentët e programit Bachelor në Regji të marrin pjesë në aktivitete të shumta akademike dhe krijuese të realizuara brenda dhe jashtë universitetit.</p> <p>Kjo politikë transparente e ndjekur nga UART siguron ruajtjen dhe rritjen e standardeve të larta akademike, shkencore dhe artistike të institucionit.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php <i>Transparenca</i></p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 3.3 "Aktivitete të ëorkshopeve/masterklasave 2022-2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve'</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	<p>GVJ , bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara, vëren që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike Raporte të vlerësimit të</p>




<p>legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>brendshëm të cilat ruhen në arkivën institucionale në përputhje në përputhje me normat e lirisë akademike dhe etikës profesionale, si dhe në respektim të kuadrit ligjor.</p> <p>Struktura ligjore mbi të cilën mbështetet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është e percaktuar në dokumentet normative të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, si edhe në rregulloren e veçantë të njësisë përkatëse. Nëpërmjet këtyre dokumenteve mundësohet zhvillimi i një procesi të rregullt vlerësimi, transparent dhe përmirësimi të standardeve akademike.</p> <p>Të gjitha të dhënat në UART përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar Kodin e Etikës për konfidencialitetin e të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimeve u vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve përkatës.</p> <p>Programi i transparencës në UART, i cili i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të Universitetit, është përgatitur në përputhje me nenin 7 të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe garanton rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë. Disponueshmëria e certifikatave të akreditimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve lejon një vlerësim real të zhvillimeve institucionale.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 1.5 "Statuti i UART"</i></p> <p><i>Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i></p> <p><i>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</i></p> <p><i>"Certifikatat e Akreditimit UART/FAS")</i></p> <p><i>Kodi i Etikës , Universiteti i Arteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>RVB thekson se në UART sigurimi i cilësisë së programeve të studimit është një mekanizëm i vazhdueshëm dhe i domosdoshëm .</p> <p>Të gjitha raportet vjetore, anketat dhe vlerësimet shoqërohen me analiza të hollësishme, duke nxjerrë në pah si sukseset ashtu edhe aspektet që kërkojnë përmirësim, me qëllim adresimin e tyre në mënyrë strategjike. Në vijim të analizave të kryera, formulohet një strategji e detajuar që jo vetëm adreson që synon përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve akademike dhe shërbimeve arsimore të institucionit.</p> <p>Plani i veprimit është hartuar për të garantuar një rritje të qëndrueshme të cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit.</p> <p>Nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë bëhet analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor dhe artistik, tek e cila paraqiten problematikat e vitit që ka përfunduar dhe objektivat që duhet të arrihen. Si rrjedhim, kjo analizë shoqërohet edhe me një plan masash që adresojnë problematikat e evidentuara dhe që trajtohen përsëri zgjidhje</p>

	<p>në vitin pasardhës. Dokumentacioni <i>Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore"</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në UART, vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas dispozitave të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Sistemi i Sigurimit të Cilësisë është i konsoliduar dhe i ngritur shumë mirë formalisht.</p> <p>Universiteti i Arteve zbaton mekanizma të rregullt mbikqyrjeje dhe vlerësimi, duke siguruar që programet e studimit të jenë në përputhje standarde të lartë akademike dhe kërkesat dinamike të tregut të punës. Procesi i akreditimit përbën një komponent thelbësor të këtij sistemi, duke shërbyer si mjete kryesor për garantimin e standardeve të larta akademike dhe realizohet në disa faza.</p> <p>1. Procesi i vlerësimit të jashtëm, i realizuar nga specialistë të fushës, mundëson identifikimin e fushave që duhen rishikuar dhe përshtatur në përputhje me kërkesat e tregut dhe nivelin akademik të kërkuar.</p> <p>2. Vlerësimi i brendshëm nëpërmjet një analize të detajuar të anëve të forta dhe sfidave të programit mundëson përmirësime afatgjata që forcojnë cilësinë dhe efektivitetin e mësimdhënies.</p> <p>3. Procesi i akreditimit periodik përcakton performancën studentore dhe nevojat akademike me qëllim ruajtjen e cilësisë më të lartë të mundshme në mësimdhënie dhe shërbime edukative.</p> <p>Fakultetet dhe departamentet kryejnë një analizë të hollësishme të të dhënave të mbledhura dhe zbatojnë masa konkrete për përditësimin e programeve mësimore, duke i përshtatur si me standardet akademike ashtu edhe me dinamikat e tregut të punës.</p> <p>GVJ konstaton angazhim maksimal nga ana e UART në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit.</p> <p>Dokumentacioni <i>Evidenca 1.9.2 "Urdhëri Nr 345, datë 19.02.2025 "Për ngritjen e grupeve të punës për rishikimin e Kurrikulave në programet e studimit Bachelor, në Fakultetin të Artit Skenik" Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të e performancës vjetore"</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet e realizuara, GVJ u informua se Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Spektori i Mësimor dhe i Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Alumni dhe NJSBC, zhvillon rregullisht aktivitete me trupën akademike dhe studentët, duke u fokusuar në informimin dhe ofrimin e trajnimeve te domosdoshme për të garantuar një cilësi të lartë dhe te qëndrueshme te programit të studimit. Aktivitetet zhvillohen në formën e takimeve të rregullta, diskutimeve të lira dhe anketave të specializuara, duke u fokusuar në mbledhjen e informacionit te nevojshëm dhe në</p>




	<p>inkurajimin e pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve të përfshirë. Bazuar në rregulloren e brendshme dhe institucionale, FAS ka caktuar një Koordinator për çdo program studimi që ofron, i cili është pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Gjatë takimeve me stafin akademik, na u konfirmua se çdo fillim viti akademik bëhet mbledhja e asamblesë me Rektorin, ku paraqitet raporti vjetor i UART.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p><i>Evidenca 6.4 "Foto nga takimet informuese me Sektorin Mësimor"</i></p> <p><i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studenteve në FAS"</i></p> <p><i>Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësorët e stafit akademik në FAS"</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se Institucioni nje dhe zbaton politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat janë janë të sanksionuara në Rregulloret e Institucionit.</i></p> <p><i>UART publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, dhe gjithë informacioni që disponohet për këtë qëllim, në dokumentacionet përkatëse apo online duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces.</i></p> <p><i>Nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë bëhet analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor, tek e cila paraqiten problematikat e vitit që ka përfunduar dhe objektivat që duhet të arrihen. Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht. FAS dhe Departamenti i RRFTV gjithashtu organizon veprimtari informuese me studentët dhe garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimit Bachelor.</i></p> <p><i>UART ka publikuar të gjithë informacionin që lidhet me procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në faqen zyrtare.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Regji Filmi & Televizioni” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Regji Filmi e Televizioni është në përputhje me strategjinë e institucionit dhe misionin e tij. Njëkohësisht, ky program është në përputhje të plotë me fushën akademike të DRRFTV dhe kërkesat e tregut. Filledat e këtij programi janë thuajse të njëkohshme me historinë e UART. Programi ka në themel të tij historinë dhe traditën, të cilat kombinohen me bashkëkohoren në përmbajtjen e kurrikulës dhe strukturën e organizimit. Kurrikula me përmbajtjen e saj i përgjigjet sfidave të tregut. Mësimdhënia bazohet në strategjinë e të menduarit kritik.
2. Dokumentacioni tregon se ky Program ka një kurrikul të përshtatur mirë me tregun dhe kërkesat e tij. Kjo lidhet me faktin se regjizorët e Filmit e Televizionit të dalë nga ky program, e gjejnë vehten lehtësisht të përfshirë në treg. Televizionet tona, kinematografia kanë emra të spikatur regjizorësh që kanë dalë nga ky program e ky institucion.
3. Një tregues i cilësisë së programit është kualifikimi i stafit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme. Një pjesë e titullarëve të lëndëve në këtë program, janë emra të spikatur në fushinën e regjizurës brenda e jashtë vendit. Dhe kjo, sigurisht, ndikon në përgatitjen cilësore të regjizorëve të filmit e televizionit me kompetenca akademike e praktike.
4. Është institucion që në më shumë se 60 vjet, ka ditur të jetë në rresht të parë të përgatitjes së regjizorëve të filmit e televizionit, të cilët kanë lënë vepra të jashtëzakonshme. Pedagogët e studiuar jashtë ditën me mjeshtëri të japin përvojën më të mirë të tyre dhe njohuritë akademike duke hedhur themelet e këtij programi.
5. Për të vlerësuar është edhe fakti që Institucioni për të pasur një program sa më cilësor ka vendosur lidhje dhe bashkëpunim me institucione arsimore, kulturore, në të cilën kryejnë praktika mësimore studentët. Ky bashkëpunim me këto institucione ndihmon në lidhjen e teorisë me praktikën. Gjithashtu ju krijon studentëve mundësinë të njohin kërkesat e tregut, mundësinë e punësimit etj.
6. Stafi akademik dhe administrativ dallohet për marrëdhënie bashkëpunimi me studentët. Kjo lidhet më së pari me specifikën e programit. Ky bashkëpunim ndikon sidomos në cilësinë e mësimdhënies, por edhe rritjen e vetvlerësimit të studentëve.

Pika të dobëta:

1. UART dhe FAS duke qenë se janë të vetmit institucione në vend, kështu që edhe programi Bsc në “Regji Filmi dhe Televizioni”, që është pjesë e këtij institucioni i tillë. Në këtë kontekst, sfida kryesore është mungesa e konkurrencës me programe të ngjajshme brenda vendit. Kjo lidhet edhe me faktin se, tregu për këtë specialitet është i kufizuar, gjë që nuk mundëson hapjen e programeve të ngjajshme e për pasojë kufizon konkurrencën. Këto vlerësime i gjejmë tek të djënat për programin në proces vlerësimi dhe tek (Standarti II.1, kriteri 6).

2. UART si i vetmi institucion i arteve mbase duhet të kishte mjedise më komode dhe të restauruara për procesin e mësimdhënies.
Problemi i mjediseve u konstatua gjatë vizitës në Institucion të Grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ)

Rekomandime:

1. Të krijohet mundësia në bazë të legjislacionit për përfshirjen e profesionit të regjizorit të Filmit e Televizionit në listën e profesioneve të rregulluara. Ky veprim do të ndikonte në formalizimin e profesionit dhe rritjen e statusit profesional të regjizorëve. Sigurisht, që certifikimi në këtë rast duhet të ketë specifika të veçanta në përputhje me profesionin. Certifikimi do të ndikonte njëherazi edhe në tregun e punës.
2. Është i domosdoshëm rikonstruksioni i godinës edhe së Fakultetit të Artit Skenik, jo vetëm për paraqitjen e jashtme, por edhe për krijimin e hapësirave për mësim të studentëve dhe krijimin e një ambjenti sa më komod, i cili do të ndikonte në cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies.
3. Për të rritur cilësinë e përgatitjes së regjizorëve të Filmit e Televizionit rekomandohet vendosja e marrëdhënieve me sa më shumë institucione artistike brënda e jashtë vendit. Ky bashkëpunim të konsistojë në këmbimet e profesoriatit dhe studentëve për të përfituar nga eksperiencia e njëri-tjetrit. Gjithashtu të kenë projekte artistike të përbashkëta. Kjo iniciativë do të ndikojë në përgatitjen më cilësore të regjizorëve të Filmit e Televizionit. Rekomandojmë gjithashtu që këto lidhje e bashkëpunime të të formalizohen me dokumentacion, i cili të shërbejë për punën kërkimore-shkencore të stafit akademik, pse jo dhe të studentëve.
4. Rekomandohet që lidhjet më rrjetin alumni të jenë sa më efektive dhe të dobishme. Për të arritur këtë duhet të ketë mekanizma të cilat do të menaxhojnë këtë verpimtari, që do të ndikojë njëherazi në forcimin e identitetit të institucionit. Njëkohësisht këta student do të referojnë problemet që lidhen me tregun e punës për këtë profesion, të cilat do të pasqyrohen në kurrikulën e programit të studimit.
5. Pyetësorët që bëhen në përfundim të vitit akademik për të evidentuar problemet duhet të rishikohen. Përmbajtja e tyre duhet të jetë specifiku për studentët e degës së Regjisë së Filmit e Televizionit. Vetëm kështu do të kenë impakt pozitiv në përmirësimin e programeve lëndore, praktikave etj. Studentët do dinë të orientohen për atë që kërkohet dhe do të shprehin mendimet e tyre. Në të kundërt do të jenë të kufizuar dhe formalë.
6. Të dokumentohet dhe ruhet më mirë bashkëpunimi me institucionet brenda e jashtë vendit lidhur me aktivitetin mësimor dhe veprimtaritë artistike si dhe ndikimi në procesin e performancës së programit.
7. Stafit akademik të përfshihet më shumë në punën kërkimore shkencore, jo vetëm projekte artistike. Një periudhë kaq e gjatë e veprimtarisë dhe përvojë të këtij institucioni, ka nevojë të studiohet, dhe të dalë në pah, po ashtu edhe përvoja botërore. Kjo gjë do të ndikojë në rritjen e cilësisë së Programit të Studimit.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "FILM DIRECTING & TELEVISION" offered by the Higher Education Institution "UNIVERSITY OF THE ARTS"

Strengths and affirmations:

1. The Film and Television Directing study program is in line with the institution's strategy and its mission. At the same time, this program is in full compliance with the academic field of the department and market demands. The beginnings of this program are almost simultaneous with the history of University of Arts. The program has history and tradition at its core, which are combined with the contemporary in the content of the curriculum and the organizational structure. The curriculum with its content responds to the challenges of the market. Teaching is based on the strategy of critical thinking.
2. The documentation shows that this Program has a curriculum well adapted to the market and its demands. This is related to the fact that Film and Television directors who graduate from this program find themselves easily hired. Our television and cinema industry have prominent names of directors who have graduated from this program and this institution.
3. An indicator of the quality of the program is the qualification of the academic staff, both full-time and part-time ones. Some of the lecturers in this program are well known in the field of directing at home and abroad. And this, of course, affects the qualitative education of film and television directors with academic and practical competencies.
4. It is an institution that in more than 60 years, has known how to be at the forefront of the preparation of film and television directors, who have created extraordinary works. Teachers who studied abroad skillfully provide their best experience and academic knowledge, laying the foundations of this program.
5. It is also worth highlighting that the Institution, in its effort to ensure a high-quality program, has established partnerships and collaborations with educational and cultural institutions where students carry out their practical training. This cooperation helps bridge theory and practice, while also providing students with the opportunity to better understand market demands and employment prospects.
6. The academic and administrative staff are distinguished by their collaborative relationships with students. This is also related to the specific nature of the program.

Weak points:

1. Since U of Art is the only institution in the country offering studies in this field, the "Film and Television Directing" program remains without national counterparts. In this context, the main challenge is the lack of competition from similar programs within the country. This is also tied to the fact that the labor market for this specialization is limited, which hinders the



development of similar programs and, consequently, limits academic competition and comparative quality benchmarks. (Standard II.1, criterion 6).

2.As the sole higher education institution in the field of arts, UART is expected to offer more modern, comfortable, and renovated facilities to support the teaching and learning process in addition to other elements.

The problem of the premises was identified during the visit to the Institution by the External Evaluation Group (EEG).

Recommendation

1.It is recommended to create the legal basis for including the profession of Film and Television Director in the list of regulated professions. This measure would contribute to the formalization of the profession and elevate the professional status of directors. Naturally, certification in this case should include specific criteria in line with the nature of the profession. Such certification would also have a positive impact on the labor market.

2.The reconstruction of the building of the Faculty of Performing Arts is essential—not only in terms of external appearance, but also to create adequate learning spaces for students and provide a more comfortable environment, which would significantly improve the quality of teaching and learning.

3.To enhance the quality of education for Film and Television Directors, it is recommended to establish partnerships with a greater number of artistic institutions both at home and abroad. These collaborations should include exchanges of academic staff and students in order to benefit from mutual experience. Joint artistic projects should also be encouraged. This initiative would contribute to the higher-quality training of future directors. Furthermore, it is recommended that these partnerships and collaborations be formalized through documentation, which could also serve as a foundation for the academic staff and students research activities.

4. It is recommended that the alumni network be made more effective and useful. To achieve this, there should be mechanisms in place to manage these activities, which would also strengthen the institution's identity. At the same time, alumni can provide feedback on labor market issues related to this profession, which should be reflected in the study program's curriculum.

5. The end-of-year student surveys intended to identify issues should be reviewed. Their content must be tailored specifically for students in the Film and Television Directing program. Only in this way will they have a real impact on improving course content, practical training, etc. Students will then be able to better understand what is being asked and provide meaningful feedback. Otherwise, their responses may remain limited and merely formal.

6. To better document and maintain cooperation with institutions inside and outside the country regarding educational and artistic activities as well as the impact on the program performance process.

7. Academic staff should be more involved in scientific research, not just artistic projects. Such a long period of activity and experience of this institution needs to be studied and highlighted, as well as world experience. This will affect the increase in the quality of the Study Program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

